



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr.21, datë 24.06.2019**

**Për**

**“MIRATIMIN E DOKUMENTIT: “RREGULLIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE  
ROAMING NDËRKOMBËTAR SHQIPËRI – BALLKANI PERËNDIMOR-  
DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

- <b>Znj. Ketrin</b>	<b>Topçiu</b>	<b>Anëtar</b>
- <b>Znj. Edlira</b>	<b>Dvorani</b>	<b>Anëtar</b>
- <b>Znj. Xhoana</b>	<b>Lilaj</b>	<b>Anëtar</b>

dhe sekretare Znj. Hasime Ferhati, në mbledhjen e datës 24.06.2019 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*“Miratimin e dokumentit: "Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor-Dokumenti Përfundimtar”*

**BAZA LIGJORE:**

1. Neni 55 e në vijim i Kreut VI të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*);
2. Udhëzues për Procedurat e Këshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.
3. *“Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”* e nënshkruar nga ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit

Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia) në Beograd më 4 Prill 2019, (Marrëveshja RRA WB6).

4. VKD Nr.14, datë 7.05.2019 për "*Miratimin për këshillim publik të dokumentit "Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor"*.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: "*Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor-Dokumenti Përfundimtar*";
- Relacioni shoqërues i projektaktit miratues (Relacioni)
- Projektakti miratues i dokumentit (projektvendimi);

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. Ministritë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia) në Beograd më 4 Prill 2019 nënshkruan "*Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor*". Marrëveshja u nënshkrua pas një procesi të gjatë bashkëpunimi midis autoriteteve rregullatore dhe ministrive përkatëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve (për Shqipërinë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), dhe me asistencën e Komisionit Evropian dhe RCC (Regional Cooperation Council).
2. Disa nga përcaktimet e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut të Ballkanit Perëndimor (RRA WB6) së nënshkruar më datë 4 Prill 2019 janë:
  - Duke filluar nga 1.07.2021 midis vendeve të WB6 do të filloje të aplikohet modeli RLAH, pra tarifat me pakicë roaming në vendet BP do të jenë sa tarifat përkatëse brenda vendit;
  - Në periudhën tranzitore 1.07.2019-30.06.2021 do të aplikohet modeli RLAH+, ku operatorët celularë mund të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifat brenda vendit. Tarifa shtesë nuk duhet të jetë më e lartë se 0.05 Euro/minutë për thirrje, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB dhe 0.015 Euro/MB 1.07.2020-30.06.2021. Tarifa totale me pakicë roaming (tarifa brenda vendit+surcharge) nuk duhet të jetë më e lartë se 0.19 euro/minutë, 0.06 Euro/SMS dhe 0.18 euro/MB;
  - Niveli maksimal mesatar i tarifave me shumicë që një operator celular në rolin e rrjetit të vizituar do të tarifoë për shërbimet e rregulluara të roamingut do të jenë 0.05 Euro/minutë për thirrje dalëse, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB. Tarifa me shumicë për internetin do reduktohet në 0.015 Euro/MB më 1.07.2020 dhe më pas

- cdo vit do reduktohet gradualisht për të arritur në 0.0025 Euro/MB më 1 Janar 2026. Tarifa maksimale për terminimin e thirrjeve të lidhura me roamingun në vendet e BP do të jetë 0.04 Euro/Minutë më 1 Korrik 2019, 0.025 Euro/minutë më 1 Korrik 2020, dhe 0.016 Euro/minutë nga 1 Korrik 2021 e në vijim.
- Deri me 1.07.2019 palët nënshkruese duhet të miratojnë çdo ndryshim të ligjeve dhe/ose akteve nënligjore për komunikimet elektronike, të nevojshme për arritjen e objektivave të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe harmonizimin e nivelit të politikës relevante të mbrojtjes së konsumatorit me standardet që mbizotërojnë brenda BE-së.
  - ndryshimet në ligjet dhe/ose aktet nënligjore të nevojshme për të siguruar që zbatimimi i rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë, rregullat për zbatimin e mekanizmit të derogimit të qëndrueshmërisë dhe kërkesat e transparencës, të cilat korrespondojnë me të njëjtat rregulla të zbatueshme në Bashkimin Evropian, është uniform në të gjithë nënshkruesit dhe do të miratohen nga palët nënshkruese jo më vonë se 31 Dhjetor 2020.
3. Në lidhje me bazën ligjore për implementimin e marrëveshjes dhe rregullimin e tarifave roaming ndërkombëtar nga AKEP, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,<sup>1</sup>ka miratuar që në nenin 55, pika 2, të shtohet parashikimi që AKEP, përveç tarifave të shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal dhe operatorëve me FNT, ka të drejtë të rregullojë edhe tarifat e shërbimeve roaming ndërkombëtare sipas marrëveshjeve reciproke ndërkombëtare të nënshkruara apo miratuara për zbatim reciprok. Me ndryshimin e miratuar nën 55, pika 2 e ligjit 9918 bëhet si vijon (është shtuar pika “c”):
- AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave e tarifave nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave përveç shërbimeve:*
- a) *shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;*
  - b) *shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës.*
  - c) **shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime.**
4. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin Nr.14, Datë 7.05.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit "Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor- Këshillim publik". Dokumenti u publikua në faqen zyrtare të internetit të AKEP dhe procedura e këshillimit publik përfundoi më datë 7.06.2019, në përfundim të së cilës në adresë të AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:
- Telekom Albania me shkresën Nr.Prot.2795, datë 31.05.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/8 Prot, datë 3.06.2019);
  - Vodafone Albania me shkresën Ref. LEA/042/EK, datë 7.06.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/9 Prot, datë 7.06.2019);

<sup>1</sup> Ligji nr. 107/2018 është miratuar më 20.12.2018, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.197, më datë 15 Janar 2019, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

- Albtelecom me shkresën Nr. 4126 Prot., datë 6.06.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/10 Prot, datë 7.06.2019);
5. Në kuadër të zbatimit të marrëveshjes rajonale të roamingut, AKEP ka bashkëpunuar me autoritetet rregullatore të rajonit nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet e Grupit Koordinues rajonal për roamingun të zhvilluar në Ohër dhe Podgoricë më data 21 dhe 31 maj 2019 respektivisht. AKEP gjithashtu ka bashkëpunuar me MIE dhe operatorët celularë duke zhvilluar takime para dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes së roamingut si dhe procesit të këshillimit publik.
  6. AKEP pas marrjes së komenteve të këshillimit publik si dhe koordinimit të veprimeve me palët e interesuara, përfshirë takimet midis autoriteteve rregullatore të rajonit, ka përgatitur dhe finalizuar procesin e vendim-marrjes për rregullimin e roamigut Shqipëri-Ballkani Perëndimor, përfshirë dokumentin *"Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor- Dokumenti Përfundimtar"*.
  7. Dokumenti *"Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor- Dokumenti Përfundimtar"*:
    - përmban përcaktimet finale të AKEP për detyrimet ndaj tre operatorëve celularë të Shqipërisë për rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të aplikuara nga këta operatorë për shërbimet roaming me vendet e tjera të BP, përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime, si dhe afatet përkatëse për zbatimin e modelit Roam Like At Home (RLAH) gradualisht duke filluar nga 1 Korrik 2021, si dhe fazës tranzitore për modelin RLAH+ në periudhën 1.07.2019-30.06.2021. Tarifat e percaktuara dhe afatet e aplikimit të tyre, përfshirë modelet RLAH+ dhe RLAH, janë sipas marrveshjes RRA WB6 të nënshkruar më 4 Prill 2019.
    - ka marrë në konsideratë Rregulloret e BE-së dhe dokumentet e BEREC për rregullimin e tarifave roaming dhe implementimin e tyre, përfshirë modelin RLAH+ dhe Roam Like At Home (RLAH), nëpërmjet të cilit hiqen tarifat me pakicë të aplikuara për romingun ndërkombëtar në vendet e BE-së.
    - ka marrë në konsideratë kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular dhe tarifat aktuale me shumicë dhe me pakicë të aplikuara për shërbimet roaming me vendet e BP;
    - është përgatitur si dokument përfundimtar pas procesit të këshillimit publik të kryer më 7.05.2019-7.06.2019, në përputhje me nenin 58 të Ligjit 9918 me qëllim tërheqjen e komenteve të palëve të interesuara për rregullimin e propozuar në këshillim publik si dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet në Aneks 1.
  8. Dokumenti *"Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor - Dokumenti Përfundimtar"* është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm për zbatimin e marrëveshjes së roamingut RRA WB6 dhe përfitimet e qytetarëve të Shqipërisë dhe BP nga përdorimi i shërbimeve të rrjeteve celulare nëpërmjet heqjes së tarifave më pakicë të roamingut midis vendeve të BP sipas afateve të marrëveshjes RRA WB6 dhe të përcaktuara nga AKEP në këtë dokument dhe vendimet individuale për tre operatorët celularë të Shqipërisë.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

## **V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentin "*Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor- Dokumenti Përfundimtar*", sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Vendim dhe Dokumenti "*Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri- Ballkani Perëndimor -Dokumentit Përfundimtar*", të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**

**Ketrin Topçiu**

**ANËTAR**

**Edlira Dvorani**

**ANËTAR**

**Xhoana Lilaj**



**Rregullimi i Tarifave të Shërbimeve  
Roaming Ndërkombëtar  
Shqipëri-Balkani Perëndimor**

**Dokumenti Përfundimtar**

**Miraturar me VKD nr.21, datë 24.06.2019**

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	4
2. Rregullimi i tarifave të Roaming në vendet e BE-së .....	7
1. Rregullimi i roaming ndërkombëtar midis vendeve anëtare të BE-së.....	7
2. Rregullimi i roaming ndërkombëtar midis vendeve të rajonit WB6.....	13
3. Roamingu ndërkombëtar Shqipëri-BP 2016-2018 .....	15
1. Volumi i trafikut të roamingut.....	15
2. Të ardhurat dhe kostot e roamingut me BP.....	16
3. Tarifat aktuale të roamingut Shqipëri - BP.....	17
4. Rregullimi i Tarifave të roaming-ut Shqipëri-Ballkani Perëndimor .....	20
1. Baza Ligjore dhe objekti i rregullimit .....	20
2. Elementët kryesorë të rregullimit të roamingut Shqipëri-BP.....	21
3. Detyrimet për MNO-të e Shqipërisë për rregullimin e Roamingut me vendet e BP .....	27
5. Efektet e ndryshimeve të roamingut Shqipëri-BP .....	39
Udhëzime për zbatimin e modelit RLAH+ me BP .....	41
Aneks 1: Komentet e Keshillimit Publik dhe Qëndrimi i AKEP .....	46

## Lista e Tabelave dhe Figurave

HAPESIRA INFORMUESE 2.1: HAPAT KRYESORE TE RREGULLIMIT TE ROAMINGUT NE VENDET E BE-SE (2007-2022).....	8
TABELA 2.1: ECURIA E TARIFAVE ME SHUMICE DHE PAKICE TE ROAMINGUT NE VENDET E BE-SE (2007-2022) .....	9
TABELA 2.2: TARIFAT MAKSIMALE MESATARE ME SHUMICE PER ROAMING (RRA1: 2015-2017) .....	13
TABELA 2.3: TARIFAT MAKSIMALE MESATARE ME PAKICE PER ROAMING (RRA1: 2015-2017) .....	13
TABELA 3.1: TRAFIKU I PAJTIMTARËVE CELULARË TË SHQIPERISË GJATË ROAMINGUT NË VENDET E BP (2017) .....	15
TABELA 3.2: TRAFIKU PAJTIMTARËVE CELULARË TË BP GJATË ROAMINGUT NË SHQIPËRI (2017) .....	15
TABELA 3.3: TRAFIKU NETO ROAMING SHQIPËRI-BP (2017) .....	16
TABELA 3.3: TE ARDHURAT (IN) DHE KOSTOT (OUT) MESATARE PER NJESI TE SHERBIMEVE ME SHUMICE TE ROAMINGUT (2017/2018) .....	17
TABELA 3.4: TARIFAT STANDARDE ME PAKICË TE ROAMINGUT TË MNO-VE NE BP. ....	18
TABELA 3.5: OFERTAT ME PAGESE FIKSE TE ROAMINGUT TË VODAFONE ALBANIA PER ROAMING NE BP. ....	18
TABELA 3.6: OFERTAT ME PAGESE FIKSE TE ROAMINGUT TË TELEKOM ALBANIA PER ROAMING NE BP. ....	18
TABELA 3.7: OFERTAT ME PAGESE FIKSE TE ROAMINGUT TË ALBTELECOM ALBANIA PER ROAMING NE BP. .	19
TABELA 5.1: TAVANET PËR TARIFAT STANDARDE ME PAKICË TE ROAMINGUT ME BP RLAH+ 1.07.2019-30.06.2020 .....	42
TABELA 5.2: NDRYSHIM I TARIFAT STANDARDE TE ROAMINGUT ME BP (RLAH+) .....	42
TABELA 5.3: SHEMBULL I APLIKIMIT TË RLAH+ PËR BUNDLE .....	43



# 1. Hyrje

---

Më datë 4 Prill 2019 në Beograd në kuadër të Samitit Digital të Ballkanit Perëndimor 2019, u nënshkrua Marrëveshja mbi Reduktimin e Çmimeve të Shërbimeve Roaming në Rrjetet Publike të Komunikimit Celular në Rajonin e Ballkanit Perëndimor. Marrëveshja u nënshkrua nga ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, dhe Serbia).

Bashkëpunimi rajonal për roamingun ndërkombëtar është bërë pjesë Inisiativës së Ballkanit Perëndimor duke marrë dhe mbështetjen e Komisionit Europian, i cili po asiston vendet e rajonit në këtë drejtim, nëpërmjet RCC (Regional Cooperation Council), organizëm që ka nxitur bashkëpunimin në këtë kuadër duke kryer një sërë takimesh të përbashkëta rajonale dhe studime për këtë çështje. Gjate vitit 2018 dhe fillimit të vitit 2019 nepermjet RCC dhe me asistencë të KE janë kryer një sërë takimesh me pjesëmarrje të Autoriteteve Rregullatore (NRA) dhe Ministrive të linjës të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) për finalizimin e marrëveshjes roaming sipas modelit RLAH duke përfshirë një periudhë tranzicionale me RLAH+ sipas modelit të BE-së.

Disa nga përcaktimet e Marrëveshjes Rajonale të Roamingut të Ballkanit Perëndimor (RRA WB6) së nënshkruar më datë 4 Prill 2019 janë:

- Duke filluar nga 1.07.2021 midis vendeve të WB6 do të fillojë të aplikohet modeli RLAH, pra tarifat me pakicë roaming në vendet BP do të jenë sa tarifat përkatëse brenda vendit;
- Në periudhën tranzitore 1.07.2019-30.06.2021 do të aplikohet modeli RLAH+, ku operatrotët celularë mund të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën brenda vendit. Tarifa shtesë nuk duhet të jetë më e lartë se 0.05 Euro/minutë për thirrje, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB dhe 0.015 Euro/MB 1.07.2020-30.06.2021. Tarifa totale (brenda vendit+surcharge) nuk duhet të jetë më e lartë se 0.19 euro/minutë, 0.06 Euro/SMS dhe 0.18 euro/MB;
- Niveli maksimal mesatar i tarifave me shumicë që një operator celular në rolin e rrjetit të vizituar do të tarifoë për shërbimet e rregullara të roamingut do të jenë 0.05 Euro/minutë për thirrje dalëse, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB. Tarifa me shumicë për internetin do reduktohet në 0.015 Euro/MB më 1.07.2020 dhe më pas çdo vit do reduktohet gradualisht për të arritur në 0.0025 Euro/MB më 1 Janar 2026. Tarifa maksimale për terminimin e thirrjeve të lidhura me roamingun në vendet e BP do të jetë 0.04 Euro/Minutë më 1 Korrik 2019, 0.025 Euro/minutë më 1 Korrik 2020, dhe 0.016 Euro/minutë nga 1 Korrik 2021 e në vijim.
- Deri më 1.07.2019 palët nënshkruese duhet të miratojnë çdo ndryshim të ligjeve dhe/ose akteve nënligjore për komunikimet elektronike, të nevojshme për arritjen e objektivave të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe harmonizimin e nivelit të politikës relevante të mbrojtjes së konsumatorit me standardet që mbizotërojnë brenda BE-së.
- ndryshimet në ligjet dhe/ose aktet nënligjore të nevojshme për të siguruar që zbatimi i rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë, rregullat për zbatimin e mekanizmit të derogimit të qëndrueshmërisë dhe kërkesat e transparencës, të cilat korrespondojnë me të njëjtat rregulla të zbatueshme në Bashkimin Evropian, është uniform në të gjithë nënshkruesit dhe do të miratohen nga palët nënshkruese jo më vonë se 31 Dhjetor 2020.

Rregullimi do të jetë reciprok në të gjitha vendet e BP, që do të thotë masat rregulluese të AKEP për operatorët celularë në Shqipëri do të jenë të njëjta me masat rregulluese që Autoritete rregullatore homologe do vendosin ndaj operatorëve celularë në vendet respektive të BP. Njerrja e këtyre akteve dhe koordinimi i tyre, si dhe adresimi i problemeve të ngritura nga operatorët celularë të BP ka qenë pjesë e diskutimeve të takimeve midis autoriteteve rregullatore të vendeve të Ballkanit Perëndimor të zhvilluara më 13 Maj në Bruksel, më 21 Maj në Ohër dhe 31 Maj në Podgoricë.

Për sa i përket të bazës ligjore për rregullimin e tarifave të roaming ndërkombëtar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”,<sup>1</sup> ka miratuar që në nenin 55, pika 2, të shtohet parashikimi që AKEP, përvec tarifave të shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal dhe operatorëve me FNT, ka të drejtë të rregullojë edhe tarifat e shërbimeve roaming ndërkombëtar sipas marrveshjeve reciproke ndërkombëtare të nënshkuara apo miratuara për zbatim reciprok. Me ndryshimin e miratuar neni 52, pika 2 e ligjit 9918 bëhet si vijon (është shtuar pika “c”):

*AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave e tarifave nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave përvec shërbimeve:*

- a) *shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;*
- b) *shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës.*
- c) **shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkuara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime..**

AKEP me Vendimin Nr.14, datë 7.05.2019, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor-Këshillim Publik”. Periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 7.06.2019, dhe në adresë të AKEP kanë depozituar komente Telekom Albania, Vodafone Albania dhe Albtelecom. Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP janë përfshirë në Aneks 1 të këtij dokumenti.

AKEP pas marrjes së komenteve të këshillimit publik si dhe bashkëpunimit me rregullatorët e vendeve të BP ka përgatitur dhe finalizuar procesin e vendim-marrjes për rregullimin e roamigut Shqipëri-Ballkani Perëndimor, përfshirë miratimin e këtij dokumenti, që përbën versionin final të dokumentit të nxjerrë në këshillim publik më 7.05.2019.

Ky dokument “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor”:

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 107/2018 është miratuar më 20.12.2018, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.197, më datë 15 Janar 2019, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

- përmban përcaktimet finale të AKEP për detyrimet ndaj tre operatorëve celularë të Shqipërisë për rregullimin e tarifave me shumicë dhe me pakicë të aplikuara nga këta operatorë për shërbimet roaming me vendet e tjera të BP, përfshirë rregullimin e tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime, si dhe afatet përkatëse për zbatimin e modelit Roam Like At Home (RLAH) gradualisht duke filluar nga 1 Korrik 2019. Tarifatat e përcaktuara dhe afatet e aplikimit të tyre, përfshirë modelet RLAH+ dhe RLAH, janë sipas marrëveshjes RRA WB6 të nënshkruar më 4 Prill 2019.
- ka marrë në konsideratë Rregulloret e BE-së dhe dokumentet e BEREC për rregullimin e tarifave roaming dhe implementimin e tyre, përfshirë modelin Roam Like At Home (RLAH), nëpërmjet të cilit hiqen tarifatat me pakicë të aplikuara për romingun ndërkombëtar në vendet e BE-së.
- ka marrë në konsideratë kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular dhe tarifatat aktuale me shumicë dhe me pakicë të aplikuara për shërbimet roaming me vendet e BP;
- është përgatitur si dokument përfundimtar pas procesit të këshillimit publik të kryer më 7.05.2019-7.06.2019, në përputhje me nenin 58 të Ligjit 9918 me qëllim tërheqjen e komenteve të palëve të interesuara për rregullimin e propozuar në këshillim publik si dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet në Aneks 1.

Ky dokument është një dokument rregullator shumë i rëndësishëm për zbatimin e marrëveshjes së roamingut në vendet e BP dhe përfitimet e qytetarëve të BP nga përdorimi i shërbimeve të rrjeteve celulare nëpërmjet heqjes së tarifave me pakicë të roamingut midis vendeve të BP. Me miratimin e këtij dokumenti, AKEP do të marrë vendimet përkatëse për rregullimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime, për operatorët celularë në Shqipëri:

- Rregullimin e tarifave me shumicë të roamingut që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, kur pajtimtarët e këtyre të fundit janë në roaming në Shqipëri;
- Rregullimin e tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, për ato thirrje që janë të lidhura me romingun ndërkombëtar midis vendeve të BP;
- Rregullimin e tarifave me pakicë që operatorët celularë të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre, kur këta janë në roaming në vendet e BP.

## 2. Rregullimi i tarifave të Roaming në vendet e BE-së

---

Marrëveshja e roamingut të Ballkanit perëndimor (RRA WB6) në pjesën hyrëse të saj ka referenca me kuadrin rregullator të BE-së për aplikimin e modelit RLAH, si dhe parashikon që zbatimi i këtij modeli në rajonin e BP të fillojë nga data 1 Korrik 2021, duke përfshirë një periudhë tranzitore për aplikimin e modelit RLAH+ duke filluar nga data 1 Korrik 2019.

Për sa më sipër, ky kapitull përmban informacion mbi rregullimin e roamingut në vendet e BE-së si dhe për dokumentat e KE dhe BEREC që kanë lidhje me rregullimin e roamingut në vendet e BE-së, përfshirë modelin RLAH, si dhe për përcaktimet kryesore të rëna dakort për marrëveshjen rajonale të roamingut për WB6.

### 1. Rregullimi i roaming ndërkombëtar midis vendeve anëtare të BE-së

Komisioni Evropian ka filluar rregullimin e roamingut ndërkombëtar midis vendeve anëtare të BE-së në vitin 2007 nëpërmjet miratimit të Rregullores Nr. 717/2007 (e njohur ndryshe si Roaming I Regulation), datë 17 Qershor 2007. Nëpërmjet kësaj Rregulloreje KE përcaktoi tarifa maksimale me shumicë dhe me pakicë dhe reduktime të tyre për roamingun ndërkombëtar midis vendeve anëtare për thirrjet zanore. Më pas Komisioni ka vijuar reduktimin e tarifave roaming duke shtuar dhe shërbimet nën-rregullim (SMS dhe data (Internet) nëpërmjet Rregullores Nr. 544/2009 (Roaming II Regulation) dhe Rregullores Nr.531/2012 (Roaming III Regulation). Komisioni ka amenduar Rregulloren 531/2012, nëpërmjet Rregullores 2015/2120 (Telecom Single Market Regulation-TSM Regulation) dhe Rregullores 2017/920 (Rregullat për tregjet me shumicë të roamingut). Nëpërmjet Rregullores Telecom Single Market (TSM Regulation), Komisioni vendosi për fillimin e aplikimit të Roam Like At Home duke filluar nga data 15 Qershor 2017, duke përfshirë dhe një fazë tranzitore për RLAH+, ku operatorët celularë mund të aplikojnë për periudhën tranzitore (deri në 14.06.2017) tarifa shtesë (surcharge) për roaming në vendet e BE-së mbi ato të aplikuar brenda vendit (domestic price), duke vënë kufizime për surcharge (sa niveli i tarifave perkatese me shumicë), si dhe tavanë të tjera për tarifat totale retail të roamingut sipas llojit të shërbimit (thirrje, SMS dhe data). Nëpërmjet RLAH qytetarët në vendet anëtare të BE-së nuk kanë më tarifa/kosto shtesë me pakicë në faturat që kanë me operatorët vendas kur vizitojnë vende të tjera anëtare të BE-së. Për të mundësuar RLAH, Komisioni ka miratuar gjithashtu reduktime të mëtejshme të tarifave me shumicë të aplikuara midis operatorëve si dhe masa për përdorim të drejtë të shërbimeve me pakicë (Retail fair use policy) në RLAH (Rregullore 2016/2286), që përmban rregulla për të shmangur roamingun e perhershëm apo abuziv nga përdoruesit fundorë. Aktet legislative të BE-së janë shoqëruar me një sërë aktesh implementuese nga Komisioni dhe Udhëzime nga Grupi i Rregullatorëve Evropianë (BEREC).

Rregullimet e kryera nga Komisioni për roaming ndërkombëtar janë kundërshtuar nga operatorët, dhe konfirmimi më 8 Qershor 2010 nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë i vlefshëmrisë së Rregullores së

Roamingut (Regulation I) konsiderohet si një nga momentet kryesore të procesit në vendet e BE-së, proces i cili ka sjellë përfitime shumë të mëdha për qytetarët e BE-së.

Me poshte, bazuar në informacion nga Cullen International, paraqiten ne menyre me te detajuar hapat kryesore te BE per rregullimin e roamingut midis vendeve anetare.

#### HAPESIRA INFORMUESE 2.1: HAPAT KRYESORE TE RREGULLIMIT TE ROAMINGUT NE VENDET E BE-SE (2007-2022)

##### **Wholesale Roaming Regulation**

**Publication** in the Official Journal of the EU (17 May 2017) and entry into force (20 May 2017)

**Confirmation** by Coreper I (8 February 2017) and European Parliament lead Industry (ITRE) committee (28 February 2017) (**Flash**), Parliament plenary (April 6, 2017) (**Flash**) and the Council (25 April 2017) (**Flash**)

Informal **trilogue agreement** (**Flash**): 1 February 2017

##### **Roam Like At Home (RLAH) fair use policy**

Adoption of the Commission **Implementing Regulation** (**Report**): 15 December 2016

##### **Application and implementation**

20th BEREC **international roaming data report** covering April 2017 - September 2017 (**Flash**): 9 March 2018

Commission **Implementing Regulation** setting maximum retail charge for calls received at 0.91 €cent/min: adopted 14 December 2017

**Report** on the transparency and comparability of international mobile roaming tariffs: 7 December 2017

19th BEREC **roaming data report** October 2016 - March 2017: 5 October 2017 (**Flash**)

Commission **tender** for a study assessing the cost of providing Wholesale roaming services: 26 August 2017

Abolition of international mobile roaming retail charges (Cullen **Q&A**): 15 June 2017

BEREC **Wholesale roaming guidelines** (**Flash**): 9 June 2017

BEREC **guidelines** on the implementation of the retail roaming fair use policy, including an **Excel file** regarding the sustainability mechanism: 27 March 2017

BEREC **guidelines** on the separate sale of mobile roaming services: 5 July 2013

Commission **Implementing Regulation** setting maximum retail charge for calls received at 1.08 €cent/min: adopted 16 December 2016

Roaming provisions of the TSM Regulation apply (Cullen **Q&A**): 30 April 2016

##### **Roaming III Regulation**

**Published** in Official Journal: 30 June 2012

Entry into force: 1 July 2012

Parliament-Council compromise (**Flash**): 27 March 2012

##### **Roaming II Regulation**

**Fourth edition of the ERG guidelines** on the implementation of the Roaming II Regulation: 1 July 2009

**Published** in Official Journal: 29 June 2009. Entry into force: 30 June 2009

##### **Roaming I Regulation**

European Court of Justice **confirms** the validity of the Roaming I Regulation (**Flash**): 8 June 2010

**Published** in Official Journal: 29 June 2007. Entry into force: 30 June 2007.

*Burimi: Cullen International*

Tabela e mëposhteme paraqet ecurine e elementeve kryesore te tarifave me shumice dhe me pakice te roamingut ne vendet e EU/EEA sipas rregulloreve te BE-së.

**TABELA 2.1: ECURIA E TARIFAVE ME SHUMICE DHE PAKICE TE ROAMINGUT NE VENDET E BE-SE (2007-2022)**

	Maximum average wholesale roaming tariffs within EU/EEA				Maximum retail tariffs for roaming within EU/EEA				
	Voice Calls (€/min)	SMS (€/SMS)	Data(€/MB)		Voice Calls (€/min)		SMS sent (€/SMS)	Data(€/MB)	
					Outgoing	Received			
EU Roaming I Regulation 2007	July 1, 2007	0.30			Eurotariff	0.49	0.24		
	Aug 30, 2008	0.28			Eurotariff	0.46	0.22		
EU Roaming II Regulation 2009	Aug 30, 2009	0.25	0.04	1.00	Eurotariff	0.43	0.19	0.11	
	July 1, 1 2010	0.22	0.04	0.80	Eurotariff	0.39	0.15	0.11	
EU Roaming III Regulation 2012	July 1, 2011	0.18	0.04	0.50	Eurotariff	0.35	0.11	0.11	
	July 1, 2012	0.14	0.03	0.25	Eurotariff	0.29	0.08	0.09	
	July 1, 2013	0.10	0.02	0.15	Eurotariff	0.24	0.07	0.08	
	July 1, 2014	0.05	0.02	0.05	Eurotariff	0.19	0.05	0.06	
TSM Regulation 2015	April 30, 2016	0.05	0.02	0.05	RLAH+	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.19	Average MTR in EU	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.20
	June 14, 2017	0.05	0.02	0.05	RLAH+	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.19	Average MTR in EU	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Wholesale ≤ 0.20
		Voice Calls (€/min)	SMS (€/SMS)	(€/GB)					
	June 15, 2017	0.032	0.01	7.7	RLAH	Domestic Retail			
	January 1, 2018	0.032	0.01	6.0	RLAH	Domestic Retail			
	January 1, 2019	0.032	0.01	4.5	RLAH	Domestic Retail			
	January 1, 2020	0.032	0.01	3.5	RLAH	Domestic Retail			
	January 1, 2021	0.032	0.01	3.0	RLAH	Domestic Retail			
	January 1, 2022	0.032	0.01	2.5	RLAH	Domestic Retail			

*Burimi: Informacion nga Rregulloret e BE*

### **Masa rregullatore strukturore dhe per mbrojtjen e konsumatorit**

Rregullimi i shërbimeve të roamingut në vendet e BE-së është kryer përmes dokumentave të cituar më sipër, të cilat kanë përfshirë jo vetëm rregullimin e tarifave të shërbimeve të roamingut me shumicë dhe me pakicë, por edhe masa të tjera rregulluese strukturore (të tregut) si detyrime për akses me shumicë të roamingut për MNO dhe MVNO (direkt dhe indirekt access), local break-out (LBO) që mundësojnë një pajtimtar të përdorë aksesin broadband celular të një operatori në vendin që ben roaming dhe të tarifohet direkt nga ky operator, si dhe një sërë masash mbrojtëse për konsumatorin në lidhje me transparencën dhe njoftimin e tyre nga operatori për tarifën nën-rregullim të roamingut, mundësitë e zgjedhjes, si dhe parandalimin e faturave shokuese (bill shock) gjatë roamingut duke vendosur një limit prej 50 Euro.

Rregulloret I, II dhe III të BE-së kanë përcaktuar tarifa maksimale për shërbimet me shumicë dhe me pakicë të roamingut. Për tarifën me pakicë të shërbimeve të rregulluara të roamingut operatorët duhet të aplikojnë tarifat maksimale me pakicë sipas rregullores dhe këto tarifa njiheshin si Eurotarifa. Operatorët celularë kishin detyrim që të ofronin për pajtimtarët këto tarifa që ishin të shprehur në Euro për njësi (minutë, SMS dhe MB), por ndërkohë mund të ofronin dhe zgjedhje të tjera për

pajtimtarin. Pra operatorët celularë kishin fleksibilitet në ofrimin e tarifave apo paketave të ndryshme roaming, por kishin detyrim që krahas tyre të ofronin dhe Eurotarifën, pra tarifën e rregulluar, duke dhënë njoftimin e duhur pajtimatrit, për ta bërë zgjedhjen e tij alternative sa më të informuar.

Rregullorja (EU) 2015/2120, që amendoi Rregulloren III të roamigut, përcaktoi aplikimin e modelit RLAH në vendet e BE-se duke filluar nga data 15.06.2017, duke lejuar që në periudhën 30 Prill 2016-14 Qershor 2017 të aplikohet modeli RLAH+. Nëpërmjet modelit RLAH+, operatorët celularë lejohen të aplikojnë tarifa roaming me pakicë në bazë të formulës: tarifa brenda vendit (domestic) + tarifën përkatëse më shumicë. Njëkohsisht për këtë periudhë tranzitore rregullorja ruajti nivelet maksimale të këtyre tarifave në nivelin e Korrik 2014.

Në lidhje me aplikimin e modelit RLAH nga data 15 Qershor 2017, Rregullorja 531/2012, e amenduar me Rregulloren 2015/2120, përcakton që operatorët mund të aplikojnë një "Politikë të përdorimit të drejtë" (*Fair use policy*) të shërbimeve gjatë roaming nga pajtimtarët, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jo normal të shërbimeve të Roamingut me pakicë nga pajtimtarët/klientët roaming, siç janë: përdorimi permanent i shërbimeve të Roamingut, etj. Në rast të tejkallimit të limiteve të vendosura nga Fair use policy, operatori ka të drejtë të aplikojë tarifë shtesë (surcharge) sipas modelit RLAH+.

Rregullorja parashikon që në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së modelit të tarifimit brenda vendit (domestic), kur një ofrues i Roamingut nuk është në gjendje të mbulojë kostot totale aktuale dhe të parashikuara të tij për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut sipas modelit RLAH, me të të ardhurat aktuale dhe të projektuara nga ofrimi i shërbimeve të tilla, ofruesi i Roamingut mund të kërkojë nga rregullatori për dhënien e autorizimit për të aplikuar një tarifë shtesë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga rregullatori. Kjo tarifë shtesë duhet të zbatohet vetëm në masën e nevojshme për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, duke marrë parasysh tarifën maksimale të shitjes me shumicë të tyre.

Komisioni më datë 15 Dhjetor 2016 miratoi Rregulloren Implementuese e Komisionit (EU) 2016/2286 e cila përmban rregulla të detajuara për aplikimin e politikës së përdorimit të drejtë (fair use) si dhe rregulla se kur mund të aplikohet tarifë shtesë (surcharge) në raste të vecanta.

#### **Njësitë matëse të tarifimit:**

Sipas nenit 6/e/1 të Rregullores 531/2012 të amenduar, ofruesit e roamingut do të tarifojnë thirrjet roaming të kryera (dalëse) dhe të marra (hyrëse) në bazë sekonde. Ofruesit e roamingut mund të aplikojnë një periudhë fillestare të tarifimit prej jo më shumë se 30 sekonda për thirrjet e kryera. Ofruesit e roamingut do të tarifojnë klientët e tyre për ofrimin e shërbimeve të roamingut të të dhënave të rregulluara në bazë të njësisë kilobyte, me përjashtim të mesazheve MMS, të cilat mund të tarifohen për njësi. Në një rast të tillë, tarifa me pakicë për dërgimin ose marrjen e një mesazhi MMS në roaming, nuk duhet të tejkalojë tarifën maksimale me pakicë për shërbimin data roaming.

#### **Paketa të tjera tarifore roaming v tarifa roaming nën-rregullim**

Sipas nenit 6/e/1 të Rregullores 531/2012 të amenduar: gjatë periudhës tranzitore (RLAH+), nuk parandalohen ofertat të cilat i mundësojnë klientëve roaming, përdorimin e sasive të caktuara të shërbimeve roaming, sipas tarifave fikse ditore ose të tjera, me kushtin që konsumi i plotë i sasisë së lejuar të cojë në tarifë për njësi për thirrjet e kryera, thirrjet e marra, mesazhet SMS të dërguara dhe shërbimet e të dhënave (data) të cilat nuk duhet të tejkalojnë çmimin përkatës brenda vendit plus tarfën shtesë maskimale të përcaktuara për periudhën tranzitore.

Sipas nenit 6/e/3:

*Ofruesit e roamingut mund të ofrojnë dhe klientët roaming mund të zgjedhin me vetdije, një tarifë roaming të ndryshme nga ato të rregulluara sipas modelit RLAH dhe RLAH+, në bazë të të cilës klientët roaming përfitojnë nga një tarifë për shërbimet roaming të ndryshme nga ato të rregulluara në mungesë të një zgjedhjeje të tillë. Ofruesi i roamingut duhet t'i kujtojë/informojë këtyre klientëve roaming për natyrën e avantazheve roaming që ata po heqin dorë për shkak të zgjedhjes së tyre.<sup>2</sup>*

*Pavarësisht nënparagrafit të parë, ofruesit e roamingut do të zbatojnë automatikisht një grup tarifash në përputhje me përcaktimet në nenet 6a dhe 6b (RLAH) dhe paragrafin 1 (RLAH+) të këtij neni për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj roamingë automatikisht.*

*Çdo klient në roaming mundet në çdo kohë të kërkojë të kalojë në ose nga një tarifë e caktuar në përputhje me nenet 6a, 6b, 6c (RLAH) dhe paragrafin 1 (RLAH+) 1 të këtij neni. Kur konsumatorët roaming me vetdije zgjedhin të kalojnë ose kthehen në një tarifë të caktuar në përputhje me nenet 6a, 6b, 6c (RLAH) dhe paragrafin 1 (RLAH+) të këtij neni, çdo kalim duhet të bëhet brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, do të jetë pa pagesë dhe nuk do të kërkojë kushte ose kufizime që kanë të bëjnë me elementet e abonimit, përveç roamingut. Ofruesit e roamingut mund të vonojnë kalimin derisa tarifa e mëparshme e roamingut të jetë efektive për një periudhë minimale të përcaktuar jo më shumë se dy muaj.*

Sipas nenit 6/e/4:

*4. Ofruesit e roamingut duhet të sigurojnë që një kontratë që përfshin çdo lloj shërbimi me pakicë të rregulluar të roamingut specifikon karakteristikat kryesore të shërbimit me pakicë të rregulluar të roamingut, duke përfshirë në veçanti:*

*(a) planin tarifor ose planet tarifore specifike dhe, për secilin plan tarifor, llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë volumin/sasinë e komunikimeve;*

*(b) çdo kufizim të imponuar në konsumin e shërbimeve me pakicë të rregulluara roaming të ofruara në nivelin e çmimit vendas të shitjes me pakicë të aplikueshëm, në veçanti informacionin sasior mbi mënyrën se si zbatohet ndonjë politikë e përdorimit të drejtë duke iu referuar çmimeve, volumeve ose parametrave të tjerë kryesore të shërbimit me pakicë të rregulluar të roamingut.*

---

<sup>2</sup> Roaming providers may offer, and roaming customers may deliberately choose, a roaming tariff other than one set in accordance with Articles 6a, 6b, 6c and paragraph 1 of this Article, by virtue of which roaming customers benefit from a different tariff for regulated roaming services than they would have been accorded in the absence of such a choice. The roaming provider shall remind those roaming customers of the nature of the roaming advantages which would thereby be lost.



*Ofruesit e roamingut publikojnë informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë.*

## **Detyrime për Transparencën**

Rregullorja 531/2012, e amenduar nëpërmjet Rregullores 2015/2120 përmban 2 nene specifike për transparencën e tarifave me pakicë për shërbimet roaming:

*Neni 14: Transparenca për tarifën me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming*

*Neni 15: Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat.*

Detyrimet e transparencës për thirrjet dhe SMS përfshijnë detyrime për njoftime për pajtimtarët në roaming për dhënie informacioni të personalizuar të tarifimit të shërbimeve në roaming, përfshirë njëftimin për politikën e përdorimit të drejtë që aplikohet ndaj klientit në roaming, si dhe tarifën shtesë që aplikohet për tejkalimin e limiteve. Informacioni për tarifën duhet të jetë në monedhën vendase. Operatori ka detyrimin që të dërgojë njoftim pajtimtarit kur arrihet niveli i përdorimit të drejtë të thirrjeve, sms (për internetin kur arrihet niveli 80%), përfshirë tarifën shtesë që do aplikohet pas përfundimit të volumit të lejuar të shërbimeve roaming. Një pikë e rëndësishme është vendosja e limesive financiare ose sasiore për roamingun e tedhenave për pajtimtarët në vlerën 50 euro në muja, ose sipas zgjedhjes së pajtimtarit.

## **Udhëzimet e BEREC**

Një rol të rëndësishëm në implementimin e rregullimit të shërbimeve roaming në vendet e BE-se kanë luajtur udhëzimet e BEREC, të cilat përmbajnë sqarime të detajuara për mënyrën e implementimit të rregullores të BE-se. BEREC ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për roamingun, që lidhen me implementimin e Rregullores (EU) No 2015/2120, dhe Rregullores Implementuese të BE 2016/2286 (FUP) si:

- BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on e-hole-sale access and separate sale of services)
- BoR (17) 56 BEREC GUIDELINES ON Regulation (EU) No 531/2012, as amended by Regulation (EU) 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail Roaming Guidelines).

Dokumentat e mësipërme të BEREC dhe Rregulloret përkatëse të BE do të shërbejnë si dokumenta referues për interpretime të rregullimit të roamingut Shqipëri-Ballkani Perëndimor në regjimet RLAH+ dhe RLAH, dhe AKEP/ARKEP do koordinojnë për transpozimin e tyre në akte rregullatore përkatëse në kohën e duhur, për të dhëna mundësinë MNO-ve për zbatimin korrekt dhe në kohë të modeleve RLAH+ dhe RLAH midis dy vendeve.

Dy dokumentat e cituar të BEREC përmbajnë udhëzime të përditësuara për aplikimin e modelit RLAH+/RLAH dhe FUP sipas përcaktimeve të rregullores përkatëse të BE, dhe AKEP konsideron se këto udhëzime të BEREC (krahas atyre të BE) duhet të jenë dokumentat kryesor që do të shërbejnë

si udhëzim dhe për zbatimin e marrëveshjes së roamingut të Ballkanit Perëndimor dhe vendimeve përkatëse të AKEP.

## 2. Rregullimi i roaming ndërkombëtar midis vendeve të rajonit WB6

Rregullimi i roamingut ndërkombëtar në vendet e BE-së është kryer nëpërmjet rregullimit në nivel komunitar nga institucionet e BE-së dhe ka sjellë përfitime të mëdha për qytetarët e vendeve anëtare të BE-së në përdorimin e shërbimeve celulare, sidomos rregullimi i fundit RLAH. Megjithatë këto rregullime aktualisht mund të aplikohen vetëm midis vendeve që kanë status të vendit anëtar të BE-së. Edhe vendet që aspirojnë për t'u bërë anëtare të BE-së nuk mund të përfshihen në këtë rregullim deri sa të marrin statusin Vend Anëtar. Megjithatë, marrëveshjet bilaterale, multilaterale dhe rajonale konsiderohen tashmë edhe nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve (ITU) si një instrument shumë i mirë për të reduktuar/eliminuar tarifat e roamingut ndërkombëtar.

Katër vende të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Mali i Zi, Serbia, B&H dhe Maqedonia, në vitin 2014 kanë nënshkruar një Marrëveshje Rajonale për Roamingun ndërkombëtar (Regional Roaming Agreement-RRA), e cila përcakton se tarifat roaming midis këtyre vendeve (tarifat me shumicë midis operatorëve celulare dhe tarifat me pakicë për t'u aplikuar për pajtimtarët e shërbimeve celulare gjatë roamingut në këto vende do të rregullohen sipas çmimeve të aplikuara midis vendeve të BE bazuar në Rregulloren (BE) Nr. 531/2012 të Paramentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 Qershor 2012. Rregullimi nga secili vend i tarifave roaming sipas RRA është kryer duke aplikuar reduktim të përshkallëzuar (glide path) të tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut ndërkombëtar, sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme.

TABELA 2.2: TARIFAT MAKSIMALE MESATARE ME SHUMICE PER ROAMING (RRA1: 2015-2017)

<i>Period of application</i>	<i>Calls</i>	<i>SMS</i>	<i>Data (MB)</i>
<b>30.06.2015-30.06.2016</b>	0.14	0.03	0.25
<b>1.07.2016-30.06.2017</b>	0.10	0.02	0.15
<b>1.07.2017-</b>	0.05	0.02	0.05

*Burimi: RRA*

TABELA 2.3: TARIFAT MAKSIMALE MESATARE ME PAKICE PER ROAMING (RRA1: 2015-2017)

<i>Period of application</i>	<i>Outgoing Calls</i>	<i>Incoming Calls</i>	<i>SMS</i>	<i>Data (MB)</i>
<b>30.06.2015-30.06.2016</b>	0.29	0.08	0.09	0.70
<b>1.07.2016-30.06.2017</b>	0.24	0.07	0.08	0.45
<b>1.07.2017-</b>	0.19	0.05	0.06	0.20

*Burimi: RRA*

## Marrveshja rajonale WB6 per Roamingun

Bashkëpunimi rajonal për roamingun ndërkombëtar është bërë pjesë Inisiativës së Ballkanit Perëndimor duke marrë dhe mbështetjen e Komsionit Evropian, i cili po asiston vendet e rajonit në këtë drejtim, nëpërmjet RCC (Regional Cooperation Council), organizëm që ka nxitur bashkëpunimin në këtë kuadër duke kryer një sërë takimesh të përbashkëta rajonale dhe studime për këtë çështje. Gjate vitit 2018 dhe fillimit të vitit 2019 nepermjet RCC dhe me asistencë të KE janë kryer një sere takimesh me pjesmarrje të Autoriteteve Rregullatore (NRA) dhe Ministrive të linjës të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) për finalizimin e marrveshjes roaming sipas modelit RLAH duke përfshirë një periudhë tranzicionale me RLAH+ sipas modelit të BE-së.

Marrveshja u nënshkrua nga ministrinë përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të BP në Beograd më datë 4 Prill 2019, dhe përcaktimet kryesore të kësaj marrveshjeje janë:

- Duke filluar nga 1.07.2021 midis vendeve të WB6 do të fillojë të aplikohet modeli RLAH, pra tarifatat me pakicë roaming në vendet BP do të jenë sa tarifatat përkatëse brenda vendit;
- Në periudhën tranzitore 1.07.2019-30.06.2021 do të aplikohet modeli RLAH+, ku operatortët celularë mund të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifatat brenda vendit. Tarifa shtesë nuk duhet të jetë më e lartë se 0.05 Euro/minutë për thirrje, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB dhe 0.015 Euro/MB 1.07.2020-30.06.2021. Tarifa totale (brenda vendit+surcharge) nuk duhet të jetë më e lartë se 0.19 euro/minutë, 0.06 Euro/SMS dhe 0.18 euro/MB;
- Niveli maksimal mesatar i tarifave me shumicë që një operator celular në rolin e rrjetit të vizituar do të tarifojë për shërbimet e rregullara të roamingut do të jenë 0.05 Euro/minutë për thirrje dalëse, 0.02 Euro/SMS dhe 0.025 Euro/MB. Tarifa me shumicë për internetin do reduktohet në 0.015 Euro/MB më 1.07.2020 dhe më pas çdo vit do reduktohet gradualisht për të arritur në 0.0025 Euro/MB më 1 Janar 2026. Tarifa maksimale për terminimin e thirrjeve të lidhura me roamingun në vendet e BP do të jetë 0.04 Euro/Minutë më 1 Korrik 2019, 0.025 Euro/minutë më 1 Korrik 2020, dhe 0.016 Euro/minutë nga 1 Korrik 2021 e në vijim.
- Deri më 1.07.2019 palët nënshkruese duhet të miratojnë çdo ndryshim të ligjeve dhe/ose akteve nënligjore për komunikimet elektronike, të nevojshme për arritjen e objektivave të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe harmonizimin e nivelit të politikës relevante të mbrojtjes së konsumatorit me standardet që mbizotërojnë brenda BE-së.
- ndryshimet në ligjet dhe/ose aktet nënligjore të nevojshme për të siguruar që zbatimi i rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë, rregullat për zbatimin e mekanizmit të derogimit të qëndrueshmërisë dhe kërkesat e transparencës, të cilat korrespondojnë me të njëjtat rregulla të zbatueshme në Bashkimin Evropian, është uniform në të gjithë nënshkruesit dhe do të miratohen nga palët nënshkruese jo më vonë se 31 Dhjetor 2020.

# 3. Roamingu nderkombetar Shqiperi-BP 2016-2018

## 1. Volumi i trafikut te roamingut

Tabelat e mëposhtëme paraqesin volumin e trafikut celular për thirrje, SMS dhe data (internet) të pajtimtarëve celularë të Shqipërisë të gjeneruar gjatë roamingut në vendet e BP si dhe trafikun e gjeneruar nga pajtimtarët e vendeve të BP gjatë roamingut në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se sasia e përdorimit të shërbimeve roaming të qytetarëve të Shqipërisë në vendet e BP në vitin 2017 ishte 9-10% sasisë toatle të roamingut (në të gjitha vendet e botës) për thirrje dhe data dhe 26% për SMS. Ndërsa sasia e trafikut të gjeneruar nga pajtimtarët e vendeve të BP gjatë roamingut në Shqipëri në 2017 ishte 11-16% për thirrje dhe SMS dhe 43% për data e totalit të trafikut roaming. Një peshë të rëndësishme në përdorimin e roaming në Shqipëri e zënë pajtimtarët e rrjeveve celularë të Kosovës, trafiku i gjeneruar prej të cilëve në vitin 2017 ishte 62%-79% për thirrje dhe SMS dhe 99% për data i totalit të gjeneruar nga të gjitha vendet e BP.

**TABELA 3.1: TRAFIKU I PAJTIMTARËVE CELULARË TË SHQIPERISË GJATË ROAMINGUT NË VENDET E BP (2017)**

	Voice Calls (inbound+outbound) minutes	SMS (inbound+Outbound)	Data traffic (GB)
Bosnja&Hercegovina	55,870	52,950	269
Kosova	1,004,486	2,904,074	2,550
Montenegro	816,839	997,343	4,181
Serbia	188,225	156,288	1,042
North Macedonia	689,790	1,414,173	2,483
<b>Total WB</b>	<b>2,755,210</b>	<b>5,524,828</b>	<b>10,524</b>
<b>Total Ęorld</b>	<b>31,522,249</b>	<b>21,536,383</b>	<b>106,322</b>

*Burimi: Sipas te dhenave te operatoreve celulare.*

**TABELA 3.2: TRAFIKU PAJTIMTARËVE CELULARË TË BP GJATË ROAMINGUT NË SHQIPËRI (2017)**

	Voice Calls (inbound+outbound) minutes	SMS (inbound+Outbound)	Data traffic (GB)
Bosnja&Hercegovina	50,898	121,356	54
Kosova	1,317,715	9,480,037	80,184
Montenegro	260,030	571,310	285
Serbia	143,662	567,058	173
FRJ Macedonia	354,499	1,232,158	593
<b>Total WB</b>	<b>2,126,805</b>	<b>11,971,919</b>	<b>81,289</b>

<b>Total Ëorld</b>	19,605,331	74,936,704	188,614
--------------------	------------	------------	---------

*Burimi: Sipas te dhenave te operatoreve celulare.*

**TABELA 3.3: TRAFIKU NETO ROAMING SHQIPËRI-BP (2017)**

	<b>Voice Calls (inbound+outbound) minutes</b>	<b>SMS (inbound+Outbound)</b>	<b>Data traffic (GB)</b>
<b>Bosnja&amp;Hercegovina</b>	(4,972)	68,406	(215)
<b>Kosova</b>	313,229	6,575,963	77,635
<b>Montenegro</b>	(556,808)	(426,033)	(3,896)
<b>Serbia</b>	(44,563)	410,770	(869)
<b>FRJ Macedonia</b>	(335,291)	(182,015)	(1,890)
<b>Total WB</b>	(628,405)	6,447,091	70,765
<b>Total Ëorld</b>	(11,916,917)	53,400,321	82,292

*Burimi: Sipas te dhenave te operatoreve celulare.*

Trafiku neto roaming (trafiku i gjeneruar nga përdoruesit e BP minus trafikun e gjeneruar nga përdoruesit e Shqipërisë) është negativ me të gjitha vendet e BP për thirrje dhe SMS, përvec me Kosovën ku balanca është pozitive. Pra qytetarët e Shqipërisë përdorin më shumë shërbime celulare gjatë roamingut në Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut se qytetarët e këtyre vendeve përdorin gjatë roamingut në Shqipëri.

Te dhenat e Q4 2018 dhe Q1 2019 tregojne se numri i pajtimtarëve që përdorin shërbime roaming në BP është 100-110 mijë, ndërkohë në vendet e BE/EEA përdorin roaming rreth 200 mijë pajtimtarë, pra në raport rreth 1 me 2. Ndërkohë përdorimi mesatar i shërbimeve për përdorues (thirrje/SMS dhe internet) në vendet e BP dhe BE/EEA tregon se raporti midis tyre është rreth 1 me 3.

## **2. Të ardhurat dhe kostot e roamingut me BP**

Të ardhurat me shumicë nga roamingu të tre operatorëve celularë nga roamingu me vendet e 5 vendet e tjera të BP (të ardhurat që operatorët Shqiptarë marrin nga operatorët e vendeve të BP kur pajtimtarët e tyre vizitojnë Shqipërinë) në vitin 2016 ishin 300 mijë euro, ndërsa në vitin 2017 ishin rreth 360 mijë euro. Këto të ardhura nga vendet e BP përbëjnë 9% të të ardhurave totale me shumicë të roamingut ndërkombëtar (me të gjitha vendet e botës. Pjesën më të madhe të të ardhurave me shumicë nga operatorët e rajonit e zënë të ardhurat nga Kosova (70%).

Kostot me shumicë nga roamingu me 5 vendet e BP (kostot që operatorët Shqiptarë u paguajnë operatorëve të vendeve BP kur qytetarët Shqiptarë vizitojnë këto vende) 485 mijë euro në 2016 dhe 548 mijë euro në 2017. Këto kosto përbëjnë 9% të kostove totale me shumicë të roamingut ndërkombëtar (me të gjitha vendet e botës).

Të ardhurat neto me shumicë (diferenca të ardhura minus kosto) të operatorëve Shqiptarë me operatorët e vendeve të BP për vitin 2016 dhe 2017 ishin negative (pra  $\text{ëholesale cost} > \text{ëholesale revenue}$ ) në nivel rreth 190 mijë euro. Balanca e pagesave është negative me të gjitha vendet e rajonit të BP, përvec me Kosovën, ku Shqipëria ka të ardhura neto pozitive. Në vitin 2018 të ardhurat neto me shumicë të tre operatoreve Shqiptare nga roamingu me Kosovën ishin rreth 150 mijë euro, apo rreth 50% me shume se një vit më parë.

### 3. Tarifat aktuale te roamingut Shqipëri - BP

#### 3.1 Tarifat me shumicë

Tarifat me shumicë të aplikuara midis operatorëve celularë në Shqipëri dhe vendet e rajonit për romingun ndërkombëtare në disa raste janë objekt i skontove të mëdha në varësi të sasisë së trafikut të shëmbyer dhe/ose sezonit. Këto skonto janë më të mëdha sidomos me Kosovën (që është vendi më të cilin ka shumë trafik roaming) ku Altelecom prej shume vitesh ka nënshkruar marrveshje favorizuese roamingu me dy operatorët celularë në Kosovë duke ofruar tarifa shumë të lira roamingu për përdoruesit fundorë gjatë qëndrimit në Shqipëri si dhe anasjelltas. Altelecom ka dhe lidhje direkte interkoneksioni me operatorët në Kosovë dhe këto lidhje kanë filluar të përdoren dhe nga operatorët e tjere celulare.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion të përmbledhur për të ardhurat dhe kostot mesatare për njësi me shumicë të aplikuar midis operatorëve të Shqipërisë dhe operatorëve celularë të vendeve të BP. Vlerat e tabelës së mëposhtme janë llogaritur nga AKEP bazuar në informacionin e dhënë nga operatorët celularë, duke pjestuar të ardhurat/kostot me shumicë me sasinë e trafikut përkatës roaming.

**TABELA 3.3: TË ARDHURAT (IN) DHE KOSTOT (OUT) MESATARE PËR NJESI TË SHËRBIMEVE ME SHUMICË TË ROAMINGUT (2017/2018)**

Country	Voice In	SMS IN	Data IN (MB)	Voice OUT	SMS OUT	Data OUT (MB)
<b>Kosova</b>	<b>0.0657</b>	<b>0.0010</b>	<b>0.0019</b>	<b>0.1303</b>	<b>0.0015</b>	<b>0.0088</b>
<b>Maqedonia e Veriut</b>	0.0574	0.0031	0.0102	0.1380	0.0018	0.0106
<b>Mali i Zi</b>	0.0684	0.0077	0.0344	0.1098	0.0073	0.0213
<b>Serbia</b>	0.1347	0.0032	0.0051	0.1612	0.0089	0.0117
<b>Bosnja &amp; Hercegovina</b>	0.2746	0.0476	0.0131	0.1312	0.0399	0.0876
<b>Total Evropë</b>	0.0681	0.0017	0.0133	0.1506	0.0058	0.0144

*Burimi: Llogaritje të AKEP sipas të dhënave të operatoreve. Të dhënat janë mesatare e ponderuar për tre operatore se bashku.*

#### 3.2 Tarifat me pakicë

Operatorët celularë në Shqipëri për shërbimet roaming ofrojnë paketa/oferta të ndryshme për përdoruesit me parapagim dhe paspagim, të cilat përshkruhen shkurtimisht më poshtë. Tabela e mëposhtme paraqet tarifën standarde me pakicë të aplikuar nga tre operatorët për roaming në vendet e BP, nëse pajtimetri nuk ka aktivizuar një paketë/ofertë ose pas mbarimit të sasive të përfshira në pagesën fikse të ofertës/paketës roaming. Tabela përmban informacion për tarifën në roaming në rrjetin e preferuar, për roaming në rrjet tjetër tarifën janë më të larta.

**TABELA 3.4: TARI FAT ST AN D AR D E M E P A K I C Ë T E R O A M I N G U T T Ë M N O - V E N E B P.**

Operatori	Mín dalëse (Lek/Min)	Mín hyrëse (Lek/Min)	SMS (Lek/SMS)	Internet (Lek/MB)
Vodafone Albania	215	175	65	365
Telekom Albania	140	100	20	60
Albtelecom	25	25	10	20

*Burimi: faqet ëeb te operatoreve celulare.*

Sic mund të vihet re Vodafone Albania aplikon tarifën më të lartë standarde (për njësi: minute, SMS dhe MB) për roaming në BP. Ndërsa Albtelecom aplikon tarifën më të ulët për njësi, madje edhe më të ulët se tarifën për njësi të aplikuar brenda vendit.

Përveç tarifave të mësipërme për njësi dhe që aplikohen për përdoruesit pay-as-go dhe për konsum jashtë pakete/oferte, tre operatorët celularë ofrojnë një sërë paketash/ofertash për përdoruesit me parapagim dhe paspagim për roaming në vendet e BP dhe më gjerë. Disa prej këtyre paketave/ofertave të tre MNO-ve për roaming që përshijnë dhe vendet e BP janë të pasqyruara në tabelat në vijim.

**TABELA 3.5: O F E R T A T M E P A G E S E F I K S E T E R O A M I N G U T T Ë V O D A F O N E A L B A N I A P E R R O A M I N G N E B P.**

	1-Ditore Europe	4-Ditore Europe	10-Ditore Europe	300 MB Europe	1GB Europe
Tarifa	300	500	1200	300	1000
Internet (MB)	50	100	200	300	1GB
Minuta Hyrese	10	30	80		
Minuta dalese drejt te gjitha destinacioneve	10	10	20		
Minuta dalese drejt Vodafone Albania	10	30	80		
SMS dalese	10	30	80		

*Shënime:*

- Kohëzgjatja fillestare për konsumimin e minutave brenda paketës është 30 sekonda. Pastaj tarifimi bëhet për çdo sekondë (30+1).
- Interneti tarifohet për çdo 10 Kb.
- Pasi të konsumohet paketa aplikohen çmimet standarde roaming.
- Njoftim me SMS në momentin që konsumohen 80% të minutave ose MB të përfshira në paketë, si edhe për konsumimin e të gjitha njësive të përfshira në paketë. Gjithashtu, njoftim 24 orë para përfundimit të vlefshmërisë së paketës dhe në momentin e përfundimit të vlefshmërisë së paketës

**TABELA 3.6: O F E R T A T M E P A G E S E F I K S E T E R O A M I N G U T T Ë T E L E K O M A L B A N I A P E R R O A M I N G N E B P.**

	Roaming Ditore	Roaming 3 Ditore	Roaming 3 Ditore Mix	Roaming javore	Roaming Ditore (data)	Roaming Ditore (data)
Tarifa	400	700	1100	1500	200	600
Minuta Hyrese	10	100	100	200		
Minuta dalese drejt tegjitha destinacioneve	10	25	30	50		
SMS dalese	10	100	100	200		
Internet	-	-	100	-	50	200

*Sbënime:*

**TABELA 3.7: OFERTAT ME PAGESE FIKSE TE ROAMINGUT TË ALBTELECOM ALBANIA PER ROAMING NE BP.**

Paketat	Roaming PromoZone 1	Roaming PromoZone 4	Roaming PromoZone 10	Roaming PromoZone Internet	Roaming PromoZone Extra	Roaming Rajoni
Çmimi	<b>ALL 90</b>	<b>ALL 290</b>	<b>ALL 990</b>	<b>ALL 990</b>	<b>ALL 1,590</b>	<b>ALL 990*</b>
Minuta Dalëse	10 *	30 *	100 *	-	50 **	200*
Minuta Hyrëse	10	30	100	-	50	50
SMS Dalëse	10	30	100	-	50	
MB Internet	10	30	100	200	100	200
Vlefshmëria	24 Orë	4 Ditë	10 Ditë	10 Ditë	4 Ditë	10 Ditë

*Sbënime:*

- Roaming Rajonal nga vendet e BP përfshijn vetëm Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Për të kontrolluar balancën dërgo një SMS me tekst Balance drejt numrit 136.
- Për t'u regjistruar në një nga Paketat Roaming dërgo një SMS në numrin 136 me tekst sipas paketës së përzgjedhur; përdor menunë Eagle Star në telefonin tënd; ose vizito një nga dyqanet ALBtelecom.
- Nuk mund të aktivizohen 2 paketa roaming njëkohësisht dhe pse mund të jenë 2 paketa të ndryshme. Përjashtim bën vetëm paketa Roaming PromoZone Internet e cila mund të aktivizohet së bashku me një nga Paketat e tjera Roaming.
- Paketat Roaming mund të përdoren vetëm me operatorët e përfshirë në PromoZone 1.
- SMS-të dalëse janë të vlefshme drejt të gjitha destinacioneve.
- Skema e tarifimit për thirrjet hyrëse dhe dalëse është 60+1 sekonda, ndërsa për Internetin është 10 Kb + 10 Kb.



# 4. Rregullimi i Tarifave të Roaming-ut Shqiperi-Ballkani Perëndimor

---

## 1. Baza Ligjore dhe objekti i rregullimit

Qëllimi i këtij dokumenti është këshilimi publik për rregullimin e tarifave (dhe apekteve të tjera) të shërbimeve të roamingut midis RSH dhe vendeve të Ballkanit perëndimor sipas “Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor” të nënshkruar në Beograd më 4 Prill 2019 (më poshtë Marrëveshja RRA WB6) midis ministrive përgjegjëse për komunikimet elektronike të gjashtë vendeve të BP.

Rregullimi i tarifave të roamingut në vendet e BE-së është kryer dhe kryhet nëpërmjet Rregulloreve të BE-së, të cilat janë të aplikueshme në mënyrë të drejtëperdrejtë në vendet anëtare të BE-se, pa qenë nevoja e akteve të tjera ligjore apo nën-ligjore të vendeve anëtare për rregullimin e këtyre tarifave. Ndërkohë zbatimi i marrëveshjes RRA duhet të kryhet nëpërmjet akteve të nxjerra nga AKEP dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera të BP.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin nr. 107/2018 “Për një shtesë në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”,<sup>3</sup> ka miratuar që në nenin 55, pika 2, të shtohet parashikimi që AKEP, përveç tarifave të shërbimeve të përfshira në skemën e shërbimit universal dhe operatorëve me FNT, ka të drejtë të rregullojë edhe tarifën e shërbimeve roaming ndërkombëtare sipas marrëveshjeve reciproke ndërkombëtare të nënshkruara apo miratuara për zbatim reciprok.

Me ndryshimin e miratuar në nenin 55, pika 2 e ligjit 9918 bëhet si vijon (është shtuar pika “c”):  
*“AKEP-i ka të drejtë të zbatojë rregullimin e tarifave të shërbimeve të roamingut nëpërmjet një vendimi për rregullimin e tarifave përveç shërbimeve:*

- a) shërbimet e përfshira në skemën e shërbimit universal, të ofruara nga ofruesi i shërbimit universal, sipas përcaktimeve në nenin 57 të këtij ligji;
- b) shërbimet e ofruara nga sipërmarrësi me fuqi të ndjeshme në treg në tregun përkatës.
- c) **shërbimet e roaming-ut mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe, të nënshkruara apo të miratuara për zbatim reciprok të rregullimit të tarifave për këto shërbime, si dhe tarifave të terminimit ndërkombëtar të lidhura me këto shërbime..”**

Ligji 9918, në nenin 57 (Metoda e rregullimit të tarifave) përcakton ndër të tjerat se AKEP zbaton rregullimin e tarifave nëpërmjet përcaktimit të nivelit minimal ose maksimal të tarifave, korigjimit të ecurisë së tarifave, si dhe në rregullimin e tarifave AKEP vlerëson edhe të dhënat më të fundit për:

---

<sup>3</sup> Ligji nr. 107/2018 është miratuar më 20.12.2018, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.197, më datë 15 Janar 2019, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

- a) praktikën më të mirë të vendeve të BE-së;
- b) tarifatat mesatare të vendeve të BE-së;
- c) tarifatat e vendeve të rajonit me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë;
- ç) raportet ndërmjet tarifave të shumicës dhe pakicës;
- d) normën e fitimit të arsyeshëm, të realizuar nga sipërmarrësit e tjerë të komunikimeve elektronike në vendet e BE-së dhe në vendet me zhvillim të ngjashëm me Republikën e Shqipërisë.

Ndërkohë sipas nenit 58 të ligjit 9918, AKEP duhet të kryejë këshillim publik me palët e interesuara përpara marrjes së vendimit për rregullimin e tarifave, dhe sipas nenit 110 periudha e këshillimit nuk mund të jetë më pak se 30 ditë.

Për sa më sipër si bazë ligjore për rregullimin e tarifave roaming Shqipëri-WB6 shërben neni 55, pika 2/c e në vijim e ligjit 9918 dhe “*Marrëveshje për reduktimin e çmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor*” të nënshkruar në Beograd më 4 Prill 2019. Zbatimi i marrëveshjes do jetë reciprok dhe autoritete regullatore të vendeve të tjera do vendsojnë detyrimet për operatorët e tyre celulare sipas legjislacionit të vendit përkatës.

Bazuar në Marrëveshjen e Roamingut RRA WB6, neni 55, pika 2/c e Ligjit 9918, tarifatat e mëposhtëme do jenë objekt rregullimi nga AKEP:

- 1) Tarifatat me shumicë të roamingut që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, kur pajtimtarët e këtyre të fundit janë në roaming në Shqipëri;
- 2) Tarifatat me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP, për thirrje që janë të lidhura me roamingun ndërkombëtar midis vendeve të BP;
- 3) Tarifatat me pakicë që operatorët celularë të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre, kur këta të fundit janë në roaming në vendet e BP.

Metoda e rregullimit të tarifave me shumicë dhe me pakicë të roamingut të cilësuar më sipër do të jenë sipas përcaktimit të nivelit maksimal të tyre sipas Nenit 57, pika 1/a dhe 1/b duke marrë në konsideratë elementët e përcaktuar në nenin 57, pika 2, si dhe pikën 3 të nenit 57 të ligjit 9918.

Një rol të rëndësishëm në rregullimin e tarifave të shërbimeve roaming do të përbëjnë dhe kushtet shoqëruese/detyrimet e operatorëve celularë të Shqipërisë për operatorët celularë të vendeve të BP si dhe detyrime në lidhje me transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorit në përdorimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të BP.

## **2. Elementët kryesorë të rregullimit të roamingut Shqipëri-BP**

### **Rregullimi i tarifave me shumicë**

Objektivi kryesor i marrveshjes është heqja e tarifave roaming me pakicë midis vendeve të BP duke filluar nga 1 Korrik 2021, që do të thotë aplikimi i modelit RLAH sikundër ka filluar të aplikohet në BE prej 15 Qershor 2017. Në periudhën tranzitore 1 Korrik 2019 deri më 30 Qershor 2021 RRA WB6 përcakton që të aplikohet modeli RLAH+.

Marrëveshja RRA WB6 përmban tarifën me shumicë që do jenë dhe baza dhe për modelin RLAH+, të cilat janë përmbledhur në tabelat e mëposhtme.

**Tabela 4.1: Tarifat mesatare maksimale me shumicë për shërbimet e rregulluara të roamingut Shqipëri-BP**

Modeli Tarifimit te Roamingut ne Retail	Data e fillimit	Thirrjet e dalese (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/MB)
		(1)	(2)	(3)
RLAH+	1 Korrik 2019	0.050	0.02	0.0250
	01 Korrik 2020	0.050	0.02	0.0150
RLAH	1 Korrik 2021	0.032	0.01	0.0077
	1 Janar 2022	0.032	0.01	0.0060
	1 Janar 2023	0.032	0.01	0.0045
	1 Janar 2024	0.032	0.01	0.0035
	1 Janar 2025	0.032	0.01	0.0030
	1 Janar 2026-	0.032	0.01	0.0025

*Shënim: Tarifat në euro, pa TVSH.*

**Tabela 4.2: Tarifat maksimale me shumicë për terminimin e thirrjeve të rregulluara të roamingut Shqipëri-BP**

	1 Korrik 2019	1 Korrik 2020	1 Korrik 2021
<b>Tarifa Maksimale</b>	0.040	0.025	0.016

*Shënim: Tarifat në euro/minutë, pa TVSH*

Marrëveshja RRA WB6 përcakton që tarifat maksimale me shumicë të Roamingut dhe shërbimeve të terminimit ndërkombëtar të lidhura me roamingun midis operatorëve celularë të BP të mos jenë më të larta se ato të specifikuar në tabelat e mësipërme 4.1 dhe 4.2. Në këtë marrëveshje si dhe në rregulloret e BE, përdoret termi “Average Eholesale” për shërbime me shumicë të roamingut të përfshira në tabelën 4.1. Tarifa mesatare përlogaritet në bazë të raportit të ardhura/trafik për një periudhë 12 mujore apo sipas periudhës perkatese në tabele nëse është me e shkurter se 12 muaj. Kjo krijon fleksibilitet për MNO-të por edhe kompleksitet për mbikqyrjen e zbatimit të tarifave maksimale. Operatorët celularë të BP duhet të kryejnë axhustimet e duhura për tarifat me shumicë të aplikuara të siguruara përputhshmërinë me tarifat maksimale përkatëse për thirrje, SMS dhe data.

Bazuar në udhëzimet e BEREC, BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on ehole-sale access and separate sale of ser-vices), mbajtja e tarifave me shumicë në nivel të lartë gjatë vitit me synimin e uljes së tyre në fund të vitit për ta cuar tarifën mestare vjetore në përputhshmëri me tavanet e përcaktuara, mund të ketë një efekt negativ tek operatorët e tjerë dhe përfitimet e konsumatorëve. Për këtë arsye BEREC e konsideron këtë startegji si praktikë komerciale të papranueshme, pavarësisht se Rregulloret e KE nuk e ndalojnë atë në mënyrë të qartë.<sup>4</sup>

### **Njësitë e matjes**

Operatorët e rrjeteve celulare duhet të tarifojnë për thirrjet e rregulluara në bazë sekonde dhe nuk janë të lejuar të aplikojnë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 30 sekonda. Tarifimi për SMS dhe MMS është në bazë të njësive, ndërsa për të dhënat në Kilobyte. Këto detyrime të vendosura nga Rregulloret e BE, përfshijnë tarifat me shumicë dhe tarifat shtesë me pakicë (surcharge) sipas modelit RLAH+.

### **Rregullimi i tarifave me pakicë**

#### **RLAH+**

Në periudhën 1 Korrik 2019 deri më 30 Qershor 2021, operatorët celularë në RSH mund të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse me pakicë brenda vendit, sipas rregullit RLAH+, kur përdoruesit e tyre janë në roaming në vendet e BP. Zbatimi i rregullave të RLAH dhe RLAH+ nga operatorët e RSH për tarifat me pakicë të pajtimtarëve të tyre për shërbimet e roamingut në BP do të kryhet sipas përcaktimeve të aktit që do miratohet në përfundim të këshillimit publik si dhe

---

<sup>4</sup> 59. Maintaining eholesale charges at their existing level throughout the year eith the intention of making a reduction at a later stage of the same year to bring the annual average charge into line eith the Regulation could have an adverse effect on the other operators and could prevent them from offering more competitive or innovative tariffs to consumers. BEREC therefore considers this to be an unacceptable commercial practice, notëithstanding that it is not explicitly prohibited by the Regulation.

akteve të tjera (udhëzime/sqarime) të nxjerra nga AKEP në bashkëpunim me rregullatorët e tjerë të BP për këtë qëllim.

Gjatë periudhës tranzitore nga data 1 Korrik 2019 deri më 30 Qershor 2021, operatorët e rrjeteve celulare në RSH mund të aplikojnë për pajtimtarët e tyre që janë në roaming në BP një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse me pakicë brenda vendit (domestic price) për përdorimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut në vendet e BP. Çfarëdo tarife shtesë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të Roamingut nga operatorët celulare të RSH nuk duhet të tejkalojnë tarifën maksimale me shumicë të specifikuar në Tabelën 4.1, më sipër, sipas periudhave përkatëse: për thirrjet dalëse vlerat e kolonës (1), për SMS të dërguar vlerat e kolonës (2), për data vlerat e kolonës (3) dhe për thirrjet hyrëse vlerat e kolonës Tabelës 4.2

Shuma e çmimit të aplikuar me pakicë për shërbimet e rregulluara të roamingut në vendet e BP, e cila përfshin tarifën brenda vendit në RSH dhe tarifën shtesë (surcharge) për shërbimet e rregulluara të Roamingut nuk duhet të tejkalojë vlerat si vijon (pa TVSH), **0.19€/min për thirrjet dalëse, 0.06€ për SMS e dërguar dhe 0.18 € për MB për përdorur**, duke realizuar njëkëhësisht të dy kushtet sipas tabelës në vijim.

**Tabela 4.3: Tarifat maksimale me pakicë të operatorëve të RSH për roamingun në vendet e BP sipas modelit RLAH+**

Periudha	Thirrjet e rregulluara roaming Dalëse (€/min)	Thirrjet e rregulluara roaming Hyrëse (€/min)	SMS e rregulluara roaming të dërguar (€/SMS)	Transmetimi i të dhënave (€/MB)
1 Korrik 2019-30 Qershor 2020	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.05), por ≤ 0.19	0.040	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.02), por ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.025)por ≤ 0.180
1 Korrik 2020-30 Qershor 2021	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.05), por ≤ 0.19	0.025	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.02), por ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Ehololesale (0.015), por ≤ 0.180

*Shënim: Vlerat në euro pa TVSH*

Ofruesit e shërbimeve të rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të aplikojnë tarifë shtesë për shërbimin e rregulluar të SMS-ve të marra në roaming dhe voicemail të marrë në roaming në RK. Ky përcaktim është pavarësisht tarifave të aplikueshme për dëgjimin e këtyre mesazheve zanore.

**RLAH**

Duke filluar nga data 01 Korrik 2021, ofruesit e rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të aplikojnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të Roamingut (thirrjet dalëse dhe të marra, SMS dhe të dhëna/Data), përveç çmimit të shitjes me pakicë brenda vendit për pajtimatrët e tyre, të cilët janë në Roaming në vendet e BP.

Ofruesit e rrjeteve celulare në RSH mund të aplikojnë një "*Politikë të përdorimit të drejtë*" (*Fair use policy*) për shfrytëzimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut me pakicë në raport me çmimet e shitjes me pakicë të aplikuara brenda vendit, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose Jo normal të shërbimeve të Roamingut me pakicë nga pajtimatrët, siç janë: përdorimi permanent i shërbimeve të Roamingut, modifikimi i CLI etj.

Në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së modelit të tarifimit RLAH në nivel kombëtar, kur një ofrues i Roamingut (MNO) nuk është në gjendje të mbulojë kostot totale aktuale dhe të parashikuara të tij për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut në BP, me të ardhurat totale aktuale dhe të projektuara të tij nga ofrimi e shërbimeve të tilla, ofruesi i Roamingut mund të kërkojë nga AKEP për dhënien e autorizimit për të aplikuar një tarifë shtesë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AKEP. Kjo tarifë shtesë do të zbatohet vetëm në masën e nevojshme për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, duke marrë parasysh tarifat maksimale të shitjes me shumicë në periudhën përkatëse.

Çfarëdo tarife shtesë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të Roamingut në modelin RLAH nga ofruesit e rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të tejkalojë tarifat maksimale me shumicë të specifikuara në tabelen 4.1/1(2) me sipër, sipas periudhës përkatëse.

### **Kursi i këmbimit**

Tarifat me shumicë dhe me pakicë në tabelat e mësipërme janë dhënë në Euro. Në lidhje me shërbimet me shumicë operatorët mund të përdorin tarifat në Euro, ndërsa për tarifat me pakicë, AKEP propozon që të përdoret Kursi mesatar i Këmbimit Lek/Euro i tremujorit të parë të vitit përkatës, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë në raportet periodike tremujore ose llogaritjeve në bazë të të dhënave në faqen eeb të BSH, si më poshtë:

- Për fazën e parë të rregullimit 15.06.2019-30.06.2020 të përdoret kursi i mesatar i këmbimit Lek/Euro i tremujorit të parë 2019: 1 Euro=125 Lek.
- Për fazën e parë të rregullimit 1.07.2020-30.06.2021 të përdoret kursi i mesatar i këmbimit Lek/Euro i tremujorit të parë 2020, dhe kështu për fazat në vijim.

### **Akte të tjera plotesuese**

Sic është cituar në kapitullin 2, rregullimi i roamingut në vendet e BE-së, përfshirë implementimin e RLAH është kryer nëpërmjet Rregulloreve të BE-së dhe udhëzimeve përkatëse të BEREC, të cilat përfshijnë detyrime jo vetëm për tarifën roming me shumicë dhe pakicë, por edhe detyrime për aksesin me shumicë roaming, transparencën për pajtimtarët si dhe përcaktime për FUP. Me qëllim plotësimin e kuadrit rregullator për implementimin e RLAH+ dhe RLAH me BP, AKEP parashikon sa më poshtë:

1. Deri me 1.07.2019 AKEP do të miratojë cdo akt tjetër të nevojshëm për arritjen e objektivave të Marrëveshjes RRA WB6 dhe rregullimeve për fazën tranzitore të RLAH+.
2. Deri më 31.12.2020 AKEP do të miratojë akte nënligjore të nevojshme për të siguruar zbatimin e rregullave mbi politikën e përdorimit të drejtë (FUP), rregullat për zbatimin e mekanizmit të derogimit të qëndrueshmërisë dhe kërkesat e transparencës.

AKEP do të bashkëpunojë me rregullatorët e vendeve të BP që rregullat/aktet e tjera të jenë të koordinuara dhe uniforme si dhe të njëjta me rregullat e zbatueshme në Bashkimin Evropian, duke marrë në konsideratë kontekstin lokal në BP.

Akti i BE që do të përshtatet nga AKEP me rregulla për implementimin e RLAH midis vendeve të BP (që do të fillojë më 1.07.2021) është Rregullorja Implementuese e BE 2016/2286 e 15 Dhjetor 2016 *“On laying down detailed rules on the application of fair use policy and on the methodology for assessing the sustainability of the abolition of retail roaming surcharges and on the application to be submitted by a roaming provider for the purposes of that assessment”*. Kjo rregullore e BE do përshtatet në akt nënligjor për rregulla për përcaktimin e FUP dhe apliki

Aktet e BEREC të cilat do të përshtaten në kontekstin e roamingut në BP janë:

- BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on whole-sale access and separate sale of services)
- BoR (17) 56 BEREC GUIDELINES ON Regulation (EU) No 531/2012, as amended by Regulation (EU) 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail Roaming Guidelines).

Dokumentat e mësipërme të BEREC dhe Rregulloret përkatëse të BE do të shërbejnë si dokumenta referues për interpretime të rregullimit të roamingut Shqipëri-BP në regjimet RLAH+ dhe RLAH, dhe AKEP/NRA-të e BP do koordinojnë për transpozimin e tyre në akte rregullatore përkatëse në kohën e duhuar, për ti dhënë mundësinë MNO-ve për zbatimin korrekt dhe në kohë të modeleve RLAH+ dhe RLAH midis vendeve të BP.

### **3. Detyrimet për MNO-të e Shqipërisë për rregullimin e Roamingut me vendet e BP**

Me poshte eshte përcaktimet e AKEP per rregullimin e tarifave te roamingut dhe aspekte te tjera te lidhura me roamingun me vendet e Ballkanit Perëndimor, pas procesit të këshillimit publik të kryer më 7.05.2019-7.06.2019. Përcaktimet bazohen në Marrëveshjen e nënshkruar më datë 4 Prill 2019 midis ministrive përgjegjëse për komunikimet elektronike të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia) si dhe në dokumentat e BE-së për rregullimin e roamingut, Rregullore (BE) 531/2012 e amenduar nëpërmjet Rregullore (BE) 2120/2015 dhe Rregullore (BE) 920/2017, duke përfshirë përcaktimet kryesore të kësaj rregulloreje në lidhje me RLAH/RLAH+, dhe detyrimet shoqëruese për aksesin me shumicë roaming dhe transparencën.

Percaktimet e mëposhtëme do jene pjese e vendimeve individuale te AKEP per tre operatorët celulare.

#### **1. Objekti dhe fusha e veprimit**

1. Objekt i këtij rregullimi është përcaktimi i modaliteteve dhe kushteve për zbatimin e *“Marrëveshje për reduktimin e cmimeve të shërbimeve roaming në rrjetet publike të komunikimeve të lëvizshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor”* të nënshkruar në Beograd më 4 Prill 2019 (më poshtë Marrëveshja RRA WB6). Ky akt përcakton rregullat për të garantuar që përdoruesit e rrjeteve publike celulare në RSH nuk paguajnë tarifa më të larta për shërbimet celulare gjatë roamingut në vendet e BP në krahasim me tarifatat konkurruese që paguajnë për shërbimet celulare kur janë në RSH, duke arritur ndërkohë një nivel të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, dhe nxitje të konkurrencës dhe transparencës në treg. Implementimi i marrëveshjes RRA WB6 i shërben realizimit të objektivit të integritetit ekonomik rajonal dhe angazhimeve të RSH dhe vendeve të tjera të rajonit BP6 të përfshira në Planin Disaveçar të Veprimit të Zonës Rajonale Ekonomike (MAP REA)

Akti përcakton kushte për aksesin me shumicë në rrjetet publike të komunikimeve celulare me qëllim ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut. Ai gjithashtu përcakton rregulla tranzitore për tarifatat që mund të aplikohen nga operatorët e rrjeteve celulare të RSH për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut për thirrjet zanore dhe SMS-të e origjinura dhe terminuara midis RSH dhe vendeve të BP si dhe për shërbimet e komunikimit me të dhëna të përdorura nga klientët roaming gjatë kohës që përdorin roaming në një rrjet publik celular në RSH dhe vendet e BP. Rregullat janë të aplikueshme si për tarifatat me shumicë dhe ato me pakicë për shërbimet roaming dhe të lidhura me to, për roamingun midis RSH dhe vendeve të BP.

2. Përcaktimet në këtë akt përfshijnë gjithashtu rregulla që synojnë rritjen e transparencës së tarifave dhe përmirësime në informacionin për tarifatat për përdoruesit e shërbimeve roaming.
3. Rregullat janë të detyrueshme për tu zbatuar nga sipërmarrësit e rrjeteve publike celulare të autorizuar në RSH sipas ligjit 9918. Rregulla reciproke do të aplikohen paralelisht dhe në vendet e tjera të rajonit të BP.
4. Bazuar në Marrëveshjen Rajonale të Roamingut RRA WB6 dhe neni 55, pika 2/c e Ligjit 9918, tarifatat e mëposhtëme të aplikuar nga MNO e Shqipërisë për roaming në rajonin e Ballkanit



Perëndimor (këtu e në vijim BP) janë objekt rregullimi nga AKEP sipas përcaktimeve të këtij Akti:

- a. Tarifat me shumicë të roamingut që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të tjera të BP, kur pajtimtarët e këtyre të fundit janë në roaming në Shqipëri;
  - b. Tarifat me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare që operatorët celularë të RSH aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të tjera të BP, për thirrje që janë të lidhura me roamingun ndërkombëtar midis vendeve;
  - c. Tarifat me pakicë që operatorët celularë të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre, kur këta të fundit janë në roaming në vendet e tjera të BP.
5. Objekti i rregullimit të tarifave të shërbimeve roaming përfshin dhe kushtet shoqëruese/detyrimet e operatorëve celularë të RSH në lidhje me aksesin me shumicë për MNO të vendeve të tjera të BP si dhe transparencën dhe mbrojtjen e pajtimtarëve të shërbimeve celulare të MNO-ve të RSH për përdorimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera të BP.

## **2. Detyrime për Aksesin me shumicë roaming**

1. Operatorët e rrjeteve celulare në Republikën e Shqipërisë (RSH) duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses në nivel me shumicë nga operatorët celulare të vendeve të BP për roaming në RSH.
2. Aksesin me shumicë roaming do të përfshijë aksesin në të gjithë elementët e rrjetit dhe në facilitetet shoqëruese, shërbimet, softuerët dhe sistemet e informacionit përkatës, të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të rregulluara roaming për pajtimtarët e operatorëve celularë të vendeve të rajonit BP gjatë roamingut në RSH.
3. MNO-të e RSH duhet t'u japin operatorëve celularë të vendeve të BP një draft kontratë sipas përcaktimeve të kësaj pike, për akses roaming me shumicë jo më vonë se një muaj nga kërkesa fillestare për akses. Aksesin me shumicë roaming duhet të jepet brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më vonë se 3 muaj nga nënshkrimi i kontratës. MNO që marrin kërkesë për akses me shumicë roaming dhe kërkuesit e aksesit duhet të negociojnë në mirëbesim (good faith).

**Pavarësisht përcaktimeve në këtë pikë dhe kohës së nevojshme për amendimin e marrëveshjeve ekzistuese roaming, MNO-të e RSH kanë detyrim të aplikojnë në mënyrë reciproke tarifat me shumicë të roamingut me operatorët celularë të vendeve të BP sipas termave dhe afateve të përcaktuara në këtë akt.**

## **3. Rregullimi i tarifave me shumicë të roamingut dhe terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.**

1. Tarifat mesatare maksimale me shumicë të Roamingut që operatorët e rrjeteve celulare në Republikën e Shqipërisë, në rolin e operatorit të rrjetit të vizituar, mund të aplikojnë ndaj

operatorëve të rrjeteve celulare nga vendet e BP për ofrimin e shërbimit të rregulluar të thirrjeve të origjinuara në rrjetin e vizituar, përfshirë midis të tjerave kostot e origjinimit, tranzitimit dhe terminimit, shërbimit të rregulluar të SMS-ve të origjinuar në rrjetin e vizituar, të shërbimit të rregulluar të roamingut të të dhënave nuk duhet të jenë më të larta se ato të specifikuara në tabelën në vijim.

**Tabela 1: Tarifat mesatare maksimale me shumicë për shërbimet e rregulluara të roamingut Shqipëri-BP**

Modeli Tarifimit te Roamingut ne Retail	Data e fillimit	Thirrjet e dalese (€/min)	SMS të dërguar (€/SMS)	Transferim i të dhënave (€/MB)
		(1)	(2)	(3)
<b>RLAH+</b>	<b>1 Korrik 2019</b>	0.050	0.02	0.0250
	<b>01 Korrik 2020</b>	0.050	0.02	0.0150
<b>RLAH</b>	<b>1 Korrik 2021</b>	0.032	0.01	0.0077
	<b>1 Janar 2022</b>	0.032	0.01	0.0060
	<b>1 Janar 2023</b>	0.032	0.01	0.0045
	<b>1 Janar 2024</b>	0.032	0.01	0.0035
	<b>1 Janar 2025</b>	0.032	0.01	0.0030
	<b>1 Janar 2026-</b>	0.032	0.01	0.0025

*Shënim: Tarifat në euro, pa TVSH.*

- Tarifat mesatare maksimale të referuara në pikën 1 më sipër janë të aplikueshme midis cdo operatori celular të RSH dhe cdo operatori celular të vendeve të BP, dhe do të llogariten përgjatë një periudhe 12-mujore ose ndonjë periudhe më të shkurtër sipas fazave përkatëse të aplikimit të tarifave në tabelën e mësipërme.
- Tarifa mesatare me shumicë për thirrjet e rregulluara roaming e referuar në Kolonën (1) të Tabelës së mësipërme për operatorin celular të RSH në rolin e operatorit të rrjetit të vizituar do të llogaritet duke pjestuar të ardhurat totale me shumicë të marra nga operatori i rrjetit të vizituar gjatë periudhës përkatëse për ofrimin e thirrjeve të rregulluara roaming me shumicë me numrin total të minutave të këtyre thirrjeve roaming të përdorura për ofrimin me shumicë të thirrjeve roaming brenda vendeve të BP gjatë periudhës përkatëse, të agreguara në bazë sekonde.

4. Tarifa mesatare me shumicë për SMS e rregulluara roaming e referuar në Kolonën (2) të Tabelës së mësipërme për operatorin celular të RSH në rolin e rrjeti të vizituar do të llogaritet duke pjestuar të ardhurat totale me shumicë për orgjiminin dhe transmetimin e SMS-ve të rregulluara roaming brenda vendeve të BP gjatë periudhës përkatëse me numrin total të këtyre SMS-ve të origjinuara dhe transmetuara për llogari të operatorit celular nga vendet e BP gjatë periudhës përkatëse.

Operatori celular i RSH në rolin e operatorit të rrjetit vizitues nuk duhet të tarifojë operatorët e vendeve të BP për terminimin e SMS-ve të rregulluara roaming të marra nga pajtëmtarët e këtyre operatorëve gjatë roamingut në rrjetin e tij.

5. Tarifa mesatare me shumicë për transmetimin e të dhënave të rregulluara roaming e referuar në Kolonën (3) të Tabelës së mësipërme për operatorin celular të RSH në rolin e rrjeti të vizituar do të llogaritet duke pjestuar të ardhurat totale me shumicë për ofrimin e shërbimeve të rregulluara roaming për të dhënat gjatë periudhës përkatëse me numrin total të megabyte të të dhënave të konsumuara për ofrimin e këtyre shërbimeve për llogari të operatorit celular nga vendet e BP gjatë periudhës përkatëse, të agreguara në bazë kilobyte.
6. Operatorët e rrjeteve celulare të RSH në rolin e rrjetit të vizituar duhet të tarifojnë për thirrjet e rregulluara në bazë sekonde dhe nuk janë të lejuar të aplikojnë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 30 sekonda. Tarifimi për SMS dhe MMS është në bazë të njësisive, ndërsa për të dhënat në Kilobyte.
7. Asnjë prej operatorëve të përfshirë në roamingun Shqipëri-vendet e BP nuk duhet të ndryshojë karakteristikat teknike të SMS-ve në roaming nga karakteristikat teknike të SMS-ve të ofruara në tregun vendas.
8. Tarifat maksimale me shumicë të terminimit që operatorët e rrjeteve celulare në Republikën e Shqipërisë mund të aplikojnë për operatorët celularë të vendeve të BP për thirrjet e rregulluara roaming të origjinuara dhe terminuara në vendet e BP nuk duhet të jenë më të larta se vlerat e dhëna në Tabelën 2.

**Tabela 2: Tarifat maksimale me shumicë për terminimin e thirrjeve të rregulluara të roamingut Shqipëri-BP**

	1 Korrik 2019	1 Korrik 2020	1 Korrik 2021
<b>Tarifa Maksimale</b>	0.040	0.025	0.016

*Shënim: Tarifat në euro/minutë, pa TVSH*

Operatorët e rrjeteve celulare të RSH në rolin e rrjetit të vizituar duhet të tarifojnë për terminimin e këtyre thirrjeve në bazë sekonde dhe nuk janë të lejuar të aplikojnë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 1 sekondë.

#### 4. Rregullimi i tarifave më pakicë të roamingut

1. Duke filluar nga data 1 Korrik 2021, tarifat me pakicë që operatorët e rrjeteve celulare të RSH aplikojnë për pajtimtarët e tyre për shërbimet e roamingut në vendet e BP duhet të jenë të njëjta me tarifat e aplikuar në RSH, sipas rregullit Roam Like At Home (RLAH).
2. Në periudhën 1 Korrik 2019 deri më 30 Qershor 2021, operatorët celulare në RSH mund të aplikojnë një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse me pakicë brenda vendit, sipas rregullit RLAH+.
3. Zbatimi i rregullave të RLAH dhe RLAH+ nga operatorët e RSH për tarifat me pakicë të pajtimtarëve të tyre për shërbimet e roamingut në BP do të kryhet sipas përcaktimeve të këtij akti dhe akteve të tjera të nxjerra nga AKEP në koordinim me autoritetet rregullatore të rajonit BP për këtë qëllim.
4. Gjatë periudhës tranzitore të referuar në pikën 2 më sipër, përkatësisht nga data 1 Korrik 2019 deri më datë 30 Qershor 2021, operatorët e rrjeteve celulare në RSH mund të aplikojnë për pajtimtarët e tyre që janë në roaming në vendet e BP një tarifë shtesë (surcharge) mbi tarifën përkatëse me pakicë brenda vendit (domestic price) për përdorimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut në vendet e BP. Çfarëdo tarife shtesë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të Roamingut nga operatorët celulare të RSH nuk duhet të tejkalojë tarifat maksimale me shumicë të specifikuar në Tabelën 1, paragraf 3.1 sipas periudhave përkatëse, për thirrjet e rregulluara roaming dalëse vlerat e kolonës (1), për SMS e rregulluara roaming të dërguara vlerat e kolonës (2), për përdorimin e internetit (data) vlerat e kolonës (3), dhe për thirrjet hyrëse vlerat e Tabelës 2, paragraf 3.8.

Tarifa totale me pakicë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të roamingut në vendet e BP, e cila përfshin tarifën brenda vendit në RSH dhe tarifën shtesë për shërbimet e rregulluara të Roamingut të specifikuar në paragrafin më sipër nuk duhet të tejkalojë vlerat si vijon (pa TVSH), 0.19€/min për thirrjet e rregulluara roaming të kryera, 0.06€ për SMS e rregulluara roaming të dërguara dhe 0.18 € për megabyte të përdorur, duke realizuar njëkohësisht të dy kushtet sipas tabelës në vijim.

**Tabela 3: Tarifatat maksimale me pakicë të operatorëve të RSH për roamingun në vendet e BP sipas modelit RLAH+**

Periudha	Thirrjet e rregulluara roaming dalëse (€/min)	Thirrjet e rregulluara roaming Hyrëse (€/min)	SMS e rregulluara roaming të dërguar (€/SMS)	Transmetimi i të dhënave (€/MB)
1 Korrik 2019-30 Qershor 2020	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.05), por ≤ 0.19	0.040	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.02), por ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.025)por ≤ 180
1 Korrik 2020-30 Qershor 2021	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.05), por ≤ 0.19	0.025	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.02), por ≤ 0.06	Domestic Retail + Roaming Ëholesale (0.015), por ≤ 180

*Shënim: Vlerat në euro pa TVSH*

Ofruesit e shërbimeve të rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të aplikojnë tarifë shtesë për shërbimin e rregulluar të SMS-ve të marra në roaming dhe voicemail të marrë gjatë roaming në vendet e BP. Ky përcaktim është pavarësisht tarifave të aplikueshme për dëgjimin e këtyre mesazheve.

Operatorët e rrjeteve celulare të RSH duhet të tarifojnë pajtimtarët e tyre në bazë sekonde për thirrjet e rregulluara roaming të kryera dhe të marra në vendet e BP. Operatorët ofrues të roamingut nuk janë të lejuar të aplikojnë call set up fee apo kohe fillestare minimale tarifimi më të gjatë se 30 sekonda. Tarifimi për pajtimtarët për shërbimet e rregulluara të të dhënave gjatë roamingut në vendet e BP do të jetë në bazë kilobyte, përveç MMS-ve që mund të tarifohen për njësi. Në të tilla raste tarifa me pakicë e aplikuar për transmetimin apo marrjen e një MMS në roaming në BP nuk duhet të jetë më e lartë se tarifa maksimale me pakicë për shërbimet e rregulluara roaming të të dhënave të përcaktuara në tabelën e mësipërme.

Tavanet e tabëlës më sipër për tarifatat shtesë me pakicë dhe tarifatat Totale me pakicë për roaming të shprehur në euro, duhet të konvertohen në LEK duke përdorur Kursin Mesatar të Këmbimit Lek/Euro i tremujorit të parë të vitit përkatës, sipas publikimit të Bankës së Shqipërisë në raportet periodike tremujore ose llogaritjeve në bazë të të dhënave në faqen ëeb të BSH, për periudhën 1 Janar-31 Mars të vitit përkatës. (për fazën e parë kursit mesatar i këmbimit i llogaritur nga AKEP është 1 Euro=125 ALL)

- Me efekt nga data 01 Korrik 2021, operatorët e rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të aplikojnë asnjë tarifë shtesë për shërbimet e rregulluara të Roamingut (thirrjet dalëse dhe të marra, SMS

dhe të dhëna/Data), përveç çmimit të shitjes me pakicë brenda vendit për pajtimtarët e tyre, të cilët janë në Roaming në rajonin e BP.

6. Ofruesit e rrjeteve celulare në RSH mund të aplikojnë një "*Politikë të përdorimit të drejtë*" (*Fair use policy*) për shfrytëzimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut me pakicë në raport me çmimet e shitjes me pakicë të aplikuar brenda vendit, me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose Jo normal të shërbimeve të Roamingut me pakicë nga pajtimtarët, siç janë: përdorimi permanent i shërbimeve të Roamingut, modifikimi i CLI etj.
7. Në rrethana specifike dhe të jashtëzakonshme, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së modelit të tarifimit RLAH në nivel kombëtar, kur një ofrues i Roamingut (MNO) nuk është në gjendje të mbulojë kostot totale aktuale dhe të parashikuara të tij për ofrimin e shërbimeve të rregulluara të Roamingut me vendet e BP, me të ardhurat totale aktuale dhe të projektuara të tij nga ofrimi e shërbimeve të tilla, ofruesi i Roamingut mund të kërkojë nga AKEP për dhënien e autorizimit për të aplikuar një tarifë shtesë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga AKEP. Kjo tarifë shtesë do të zbatohet vetëm në masën e nevojshme për të mbuluar kostot e ofrimit të shërbimeve të rregulluara roaming me pakicë, duke marrë parasysh tarifat maksimale të shitjes me shumicë në periudhën përkatëse.
8. Çfarëdo tarife shtesë e aplikuar për shërbimet e rregulluara të Roamingut në modelin RLAH sipas pikës 7 më sipër nga ofruesit e rrjeteve celulare në RSH nuk duhet të tejkalojë tarifat maksimale me shumicë të specifikuar në Tabela 1 paragrafin 3.1, dhe Tabela 2 paragrafi 3.8 më sipër, sipas periudhës përkatëse.
9. Gjatë periudhës tranzitore (RLAH+), nuk ndalohen ofertat të cilat i mundësojnë klientëve roaming, përdorimin e sasive të caktuara të shërbimeve roaming, sipas tarifave fikse ditore ose të tjera, me kushtin që konsumi i plotë i sasisë së lejuar të cojë në tarifë për njësi për thirrjet e kryera, thirrjet e marra, mesazhet SMS të dërguara dhe shërbimet e të dhënave (data) të cilat nuk duhet të tejkalojnë çmimin përkatës brenda vendit plus tarifën shtesë maksimale të përcaktuara për periudhën tranzitore.
10. Ofruesit e roamingut mund të ofrojnë dhe klientët roaming mund të zgjedhin me vetdije, një tarifë roaming të ndryshme nga ato të rregulluara sipas modelit RLAH dhe RLAH+, në bazë të të cilës klientët roaming përfitojnë nga një tarifë për shërbimet roaming të ndryshme nga ato të rregulluara në mungesë të një zgjedhjeje të tillë. Ofruesi i roamingut duhet t'i kujtojë/informojnë këtyre klientëve roaming për natyrën e avantazheve roaming që ata po heqin dorë për shkak të zgjedhjes së tyre.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Roaming providers may offer, and roaming customers may deliberately choose, a roaming tariff other than one set in accordance with Articles 6a, 6b, 6c and paragraph 1 of this Article, by virtue of which roaming customers benefit from a different tariff for regulated roaming services than they would have been accorded in the absence of such a choice. The roaming provider shall remind those roaming customers of the nature of the roaming advantages which would thereby be lost.

Pavarësisht nënparagrafit të parë, ofruesit e roamingut do të zbatojnë automatikisht një grup tarifash në përputhje me përcaktimet për RLAH dhe paragrafin për RLAH+ të këtij neni për të gjithë klientët ekzistues dhe të rinj roaming automatikisht.

Çdo klient në roaming mundet në çdo kohë të kërkojë të kalojë në ose nga një tarifë e caktuar në përputhje me përcaktimet për RLAH dhe paragrafin për RLAH+ të këtij neni. Kur konsumatorët roaming me vetdije zgjedhin të kalojnë ose kthehen në një tarifë të caktuar në përputhje me nenet (RLAH) dhe paragrafin (RLAH+) të këtij neni, çdo kalim duhet të bëhet brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, do të jetë pa pagesë dhe nuk do të kërkojë kushte ose kufizime që kanë të bëjnë me elementet e abonimit, përveç roamingut. Ofruesit e roamingut mund të vonojnë kalimin derisa tarifa e mëparshme e roamingut të jetë efektive për një periudhë minimale të përcaktuar jo më shumë se dy muaj.

11. Ofruesit e roamingut duhet të sigurojnë që një kontratë që përfshin çdo lloj shërbimi me pakicë të rregulluar të roamingut specifikon karakteristikat kryesore të shërbimit me pakicë të rregulluar të roamingut, duke përfshirë në veçanti:
  - (a) planin tarifor ose planet tarifore specifike dhe, për secilin plan tarifor, llojet e shërbimeve të ofruara, duke përfshirë volumin/sasinë e komunikimeve;
  - (b) çdo kufizim të imponuar në konsumin e shërbimeve me pakicë të rregulluara roaming të ofruara në nivelin e çmimit vendas të shitjes me pakicë të aplikueshëm, në veçanti informacionin sasior mbi mënyrën se si zbatohet ndonjë politikë e përdorimit të drejtë duke iu referuar çmimeve, volumeve ose parametrevë të tjerë kryesore të shërbimit me pakicë të rregulluar të roamingut.

Ofruesit e roamingut publikojnë informacionin e përmendur në nënparagrafin e parë.

## **5. Transparenca për tarifën me pakicë për thirrjet dhe SMS në roaming**

1. Për të njoftuar klientët roaming për faktin se ata do të jenë objekt i tarifave të roamingut kur bëjnë ose marrin një telefonatë ose kur dërgojnë një mesazh SMS, operatori celular, përveç kur klienti ka njoftuar operatorin se ai nuk e kërkon këtë shërbim, i ofron klientit, automatikisht me anë të një Shërbimi Mesazhi, pa vonesa të panevojshme dhe pa pagesë, kur ai hyn në një nga vendet e BP, përveç RSH, informacion bazë të personalizuar tarifor për çmime e roamingut (përfshirë TVSH) që aplikohen për atë pajtimtar për thirrjet telefonike dalëse dhe hyrëse dhe për dërgimin e mesazheve SMS kur ai ndodhet në vendet e BP.

Informacioni bazë i personalizuar për tarifën do të shprehet në monedhën LEK dhe duhet të përfshijë informacion mbi:

- (a) çdo politikë të përdorimit të drejtë që aplikohet ndaj pajtimtarit kur ai bën roaming në BP si dhe tarifën shtesë që zbatohet për tejkalim të limiteve sipas kësaj politike të përdorimit të drejtë; dhe
- (b) çdo tarifë shtesë që zbatohet në përputhje me RLAH+ (pika 4/7 dhe 8).

Operatori gjithashtu do të përfshijë në informacion numrin falas të përmendur në paragrafin 2 për marrjen e informacionit më të detajuar dhe informacion mbi mundësinë e aksesit në shërbimet e emergjencës duke telefonuar pa pagesë numrin unik European të emergjencave 112.

Pajtimtari duhet të ketë mundësinë që pas çdo mesazhi të cituar më sipër të njoftojë pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë MNO, se ai nuk kërkon Shërbimin e Mesazhit automatik. Një pajtimtar që ka njoftuar se nuk kërkon Shërbimin e Mesazhit automatik ka të drejtë në çdo kohë dhe pa pagesë të kërkojë nga MNO që të ofrojë përsëri shërbimin.

MNO duhet t'u ofrojë pajtimtarëve të verbër ose me shikim të pjesshëm informacionin bazë tarifor të personalizuar të përmendur në nënparagrafin e parë automatikisht, me thirrje zanore, pa pagesë, nëse pajtimtari e kërkon këtë shërbim.

Nënparagrafi i parë, i dytë, i katërt dhe i pestë, i kësaj pike me përjashtim të referencës për politikën e përdorimit të drejtë dhe tarifave shtesë që zbatohen në përputhje me n-pikaën 4/7 dhe 8, do të zbatohen gjithashtu për shërbimet e roamingut për thirrjet zanore dhe SMS të përdorura nga pajtimtarët gjatë roamingut edhe në në shtete të tjera përveç rajonit të BP.

2. Përveç përcaktimeve të paragrafit 1, pajtimtarët kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin informacion tarifor më të detajuar dhe të personalizuar për tarifave e roamingut që aplikohen në rrjetin e vizituar në BP për thirrjet zanore dhe SMS dhe informacione mbi masat e transparencës të zbatueshme në bazë të këtyre Rregullave, me anë të një thirrje zanore ose me SMS. Ky informacion duhet të merret nëpërmjet një thirrje telefonike ose SMS pa pagesë drejt një numri të përcaktuar nga MNO për këtë qëllim. Detyrimet e parashikuara në paragrafin 1 nuk do të zbatohen për pajisjet që nuk mbështesin funksionalitetin SMS.

2a. MNO duhet të dërgojë një njoftim për pajtimtarin roaming kur sasia e përdorimit të drejtë të thirrjeve zanore ose SMS roaming të rregulluara, është konsumuar plotësisht ose kur arrihet niveli prag i përdorimit i aplikuar në përputhje me Pikën 4/7-8. Ky njoftim duhet të tregojë tarifën shtesë që do të aplikohet për konsumin e çdo njësie shtesë të shërbimeve të rregulluara të roamingut të thirrjeve zanore ose SMS-ve. Çdo pajtimtar ka të drejtë të kërkojë nga MNO që të ndërpresë dërgimin e njoftimeve të tilla dhe do të ketë të drejtë, në çdo kohë dhe falas, të kërkojë nga MNO të ofrojë përsëri shërbimin.

3. MNO duhet t'u sigurojë të gjithë konsumatorëve informacion të plotë mbi tarifave e aplikueshme në roaming, në kohën e nënshkrimit të kontratës apo fillimit të përdorimit të shërbimeve celulare. MNO gjithashtu do t'u sigurojë pajtimtarëve të tij roaming me përditësime mbi tarifave e roamingut në fuqi, pa vonesa të panevojshme dhe sa herë që ka një ndryshim në këto tarifa.

Pas kësaj MNO do të dërgojë në intervale të arsyeshme kohore një kujtesë pajtimtarëve që kanë zgjedhur një plan të ndryshëm tarifor nga tarifave e rregulluara të roamingut me BP.



4. MNO duhet t'i vërë në dispozicion pajtimtarëve të tij informacionin se si të shmangin roamingun e padëshiruar në rajonet kufitare. MNO duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të mbrojtur pajtimtarët e tij nga pagesa e tarifave për roaming e padëshiruar ndërsa ndodhen në Shqipëri.

## **6. Transparenca dhe mekanizma mbrojtës për shërbimet me pakicë roaming për të dhënat.**

1. MNO duhet të sigurojnë që pajtimtarët e tyre roaming, para dhe pas nënshkrimit të një kontrate, të jenë të informuar në mënyrë adekuate për tarifën që zbatohet për përdorimin e shërbimeve të rregulluara të roamingut të të dhënave, në mënyrë që lehtësojnë kuptimin e pajtimtarëve për pasojat financiare të përdorimit të tillë dhe t'i lejojnë ata të monitorojnë dhe kontrollojnë shpenzimet e tyre në shërbimet e roamingut të të dhënave të rregulluara në përputhje me paragrafët 2 dhe 3.

Kur është e përshtatshme, MNO informojnë pajtimtarët e tyre, para nënshkrimit të një kontrate dhe në mënyrë të rregullt pas kësaj, të rrezikut të lidhjes në internet dhe shkarkimit të të dhënave në mënyrë automatike dhe të pakontrolluar. Gjithashtu, ofruesit e roamingut duhet t'i njoftojnë klientët e tyre, pa pagesë dhe në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, si t'i ndërpresin këto lidhje automatike të roamingut të të dhënave për të shmangur konsumin e pakontrolluar të shërbimeve roaming të të dhënave.

2. Një mesazh automatik nga ofruesi i roamingut duhet të informojë klientin roaming që ky i fundit është duke përdorur shërbimet e rregulluara të roamingut të të dhënave dhe të ofrojë informacion bazë të personalizuar tarifor (në monedhën vendase-LEK) për tarifën e aplikueshme për ofrimin e shërbimeve të roamingut të të dhënave të rregulluara për atë klient roaming në BP, përveç kur klienti ka njoftuar ofruesin e roamingut se ai nuk e kërkon këtë informacion.

Ky informacion bazë tarifor i personalizuar duhet të përfshijë informacion mbi:

- (a) çdo politikë të përdorimit të drejtë që aplikohet ndaj klientit roaming në roaming në BP dhe tarifën shtesë që zbatohet në tejkallim të çdo limiti sipas kësaj politike të përdorimit të drejtë; dhe
- (b) çdo shtesë që zbatohet në përputhje me RLAH+.

Informacioni do të dërgohet në pajisjen celulare të klientit roaming, për shembull me një mesazh SMS, një e-mail ose një dritare pop-up në pajisjen celulare, sa herë që klienti roaming hyn në një nga vendet e BP dhe inicion për herë të parë një shërbim roaming të të dhënave në BP. Ai do të ofrohet pa pagesë në momentin që klienti roaming inicion një shërbim roaming të rregulluar të të dhënave, me një mjet të përshtatshëm për të lehtësuar pranimin dhe kuptimin e lehtë të tij.

Një klient i cili ka njoftuar ofruesin e tij të roamingut se ai nuk kërkon informacionin tarifor automatik, ka të drejtë në çdo kohë dhe pa pagesë për të kërkuar nga ofruesi i roamingut që ta ofrojë përsëri këtë shërbim.

- 2a. Ofruesi i roamingut duhet të dërgojë një njoftim kur vëllimi i përdorimit të drejtë të shërbimit të rregulluar të roamingut të të dhënave është konsumuar plotësisht ose çdo prag përdorimi i aplikuar në përputhje me RLAH+ është arritur. Ky njoftim duhet të tregojë tarifën

shtesë që do të aplikohet për çdo konsum shtesë të shërbimeve roaming të të dhënave të rregulluara nga klienti roaming. Çdo klient ka të drejtë të kërkojë nga ofruesi i roamingut që të ndërpresë dërgimin e njoftimeve të tilla dhe do të ketë të drejtë, në çdo kohë dhe falas, të kërkojë nga ofruesi i roamingut të ofrojë përsëri shërbimin.

3. Çdo ofrues i roamingut do t'u japë të gjithë klientëve të tyre roaming mundësinë të zgjedhin me vetdije dhe pa pagesë për një facilitet që siguron informacionin në kohën e duhur mbi konsumin e akumuluar të shprehur në sasi ose në monedhën LEK për shërbimet e roamingut të të dhënave të rregulluara dhe të cilat garantojnë që pa miratimin e shprehur të klientit, shpenzimet e akumuluar për shërbimet e roamingut të të dhënave të rregulluara gjatë një periudhe të caktuar përdorimi, duke përjashtuar MMS faturuar në bazë njësie, nuk tejkalon një limit të specifikuar financiar.

Për këtë qëllim, ofruesi i roamingut do të vë në dispozicion një ose më shumë kufizime maksimale financiare për periudha të caktuara të përdorimit, me kusht që klienti të informohet paraprakisht për shumat përkatëse të vëllimit. Një nga këto kufizime (kufiri financiar i parazgjedhur/default) duhet të jetë jo më i madh se 5000 LEK (outstanding charges) për çdo periudhë faturimi mujor (pa TVSH).

Në mënyrë alternative, ofruesi i roamingut mund të vendosë kufijtë e shprehur në vëllim, me kusht që klienti të informohet paraprakisht për shumat përkatëse financiare. Një nga këto kufizime (kufiri i vëllimit të paracaktuar/default) do të ketë një shumë financiare përkatëse që nuk i kalon 5000 LEK (outstanding charges) për çdo periudhë faturimi mujor (pa TVSH).

Përveç kësaj, ofruesi i roamingut mund t'u ofrojë klientëve të tij roaming kufizime të tjera maksimale mujore të ndryshme nga sa më sipër, dhe që mund të jenë më të larta ose më të ulëta se niveli 5000 LEK.

Kufijtë e parazgjedhur të përmendur në nënparagrafin e dytë dhe të tretë do të zbatohen për të gjithë klientët që nuk kanë zgjedhur një limit tjetër.

Çdo ofrues i roamingut duhet gjithashtu të sigurojë që një njoftim i duhur t'i dërgohet pajisjes mobile të klientit roaming, për shembull me një mesazh SMS, një e-mail ose një dritare pop-up në kompjuter, kur shërbimet e roamingut të të dhënave kanë arritur 80% të kufirit financiar ose sasi të rënë dakord. Çdo klient ka të drejtë të kërkojë nga ofruesi i roamingut që të ndërpresë dërgimin e njoftimeve të tilla dhe do të ketë të drejtë, në çdo kohë dhe pa pagesë, të kërkojë nga ofruesi që ta ofrojë përsëri shërbimin.

Kur arrihet kufiri financiar ose sasi, pajisjes së lëvizshme të klientit roaming do t'i dërgohet një njoftim. Ky njoftim duhet të tregojë procedurën që duhet ndjekur nëse klienti dëshiron të vazhdojë të përdorë këto shërbime dhe koston e lidhur me çdo njësi shtesë që do të konsumohet. Nëse klienti roaming nuk përgjigjet siç kërkohet në njoftimin e marrë, ofruesi i roamingut menjëherë pushon të ofrojë dhe të tarifojë klientin roaming për shërbimet e rregulluara të roamingut të të dhënave, përveç dhe derisa klienti roaming të kërkojë vazhdimin ose rinisjen e ofrimit të këtyre shërbimeve.

Kurdo që një klient roaming kërkon të zgjedhë ose të heqë një limit financiar ose sasi, ndryshimi do të bëhet brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, ai duhet të jetë pa pagesë dhe nuk do të sjellë kushte ose kufizime që u përkasin elementeve të tjerë të pajtimit.

4. Paragrafët 2 dhe 3 nuk do të zbatohen për pajisjet makine për makine (machine-to-machine) që përdorin komunikimin e të dhënave celulare.
5. Ofruesit e roamingut duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të mbrojtur klientët e tyre nga pagesa e tarifave për roaming për shërbimet e roamingut të padëshiruar, ndërsa ndodhen në Shqipëri. Kjo përfshin informimin e klientëve se si të shmanget roamingu i padëshiruar në rajonet kufitare.
6. Ky nen, me përjashtim të paragrafit 5 të nënparagrafit të dytë të paragrafit 2 dhe të paragrafit 2a, dhe objekt i nënparagrafit të dytë dhe të tretë të këtij paragrafi, do të zbatohet gjithashtu për shërbimet e roamingut të të dhënave të përdorura nga klientët roaming që udhëtojnë në vende të tjera përveç BP dhe ofrohet nga një ofrues i roamingut.

Kur pajtimtari zgjedh facilitetin e përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 3, kërkesat e parashikuara në paragrafin 3 nuk do të zbatohen nëse operatori i rrjetit të vizituar në vendin e vizituar jashtë BP, nuk lejon ofruesin e roamingut të monitorojë përdorimin e shërbimeve të klientit të tij në kohë reale.

Në një rast të tillë, pajtimtari do të njoftohet me një mesazh SMS kur hyjnë në një vend të tillë, pa vonesa të panevojshme dhe pa pagesë, që informacioni mbi konsumin e akumuluar dhe garancia që klientit të mos kalojë kufirin e specifikuar financiar nuk janë të disponueshme gjatë roamingut në këtë shtet.

## **7. Detyrimi për njoftim dhe dhënie informacioni për AKEP**

3. Operatorët e rrjeteve celulare duhet të njoftojnë 30 ditë përpara AKEP për ndryshimet e tarifave më pakicë për shërbimet roaming në BP si dhe zbatojnë detyrimet e njoftimit të pajtimtarit për këto ndryshime.
4. Operatorët e rrjeteve celulare duhet të depozitojnë në AKEP informacionn e kërkuar nga AKEP për të monitoruar zbatimin e përcaktimeve t'për RLAH+ dhe RLAH sipas kërkesave të AKEP.
5. AKEP ka të drejtë të zgjidhë mosmarrveshjet midis operatorëve celularë të BP dhe RSH, për mosmarrveshje të lidhur me aksesin në rrjetin e operatorëve celularë në RSH, përfshirë tarifatat dhe cdo element tjetër të lidhur me zbatimin e përcaktimeve për rregullin RLAH dhe RLAH+.

# 5. Efektet e ndryshimeve të roamingut Shqipëri-BP

---

Bazuar në përcaktimet e marrvëshjes RRA WB6, informacionin për tarifatat me shumicë dhe me pakicë aktualë të roamingut me BP rezulton se:

- Një ndër shërbimet kryesore të roamingut aktualisht është data roaming, dhe tarifatat me shumicë roaming sipas RRA WB6 janë në nivelin maksimal (me ndonjë përjashtim) apo mbi nivelin mesatar aktualisht të aplikuar midis të gjithë operatorëve MNO të RSH dhe BP, pra pa impakt negativ përkeqsues për operatorët për të ardhurat me shumicë, ceteris paribus;
- Tarifatat e MTR ndërkombëtar që do jenë nën rregullim janë vetëm ato të lidhura me roamingun midis vendeve të BP, pra me impakt të vogël në të ardhurat me shumicë nga terminimi i thirrjeve ndërkombëtare. Gjithashtu, operatorët MNO në marrvëshjet e tyre mund të parashikojnë kushte për parandalimin e perdorimit të paligjishmëm si modifikim CLI etj, dhe AKEP do bashkëpunojnë me MNO-të për gjetjen e zgjidhjeve optimale për adresimin e probleme të mundshme me modifikimin e CLI.
- MNO-të e RSH ofrojnë aktualisht tarifa me pakicë roaming me vendet e tjera të BP të favorshme për pajtimtarët edhe në kushte komerciale, pra në mungesë të rregullimit të tyre. Madje Albtelecom ka filluar të implementojë model të ngjashëm me RLAH për roamingun me Kosovën në baza komerciale bazuar në marrvëshjet favorizuese me operatorët e RK të lidhura ndër vite. Gjithashtu operatorët lejohen të ofrojnë paketat alternative për perdoret e tyre në roaming me BP, dhe në shumë raste këto paketa mund të mos kenë nevojë për ndryshim për përputshmëri me RLAH+ apo RLAH. Ato që mund të kërkojnë ndryshim janë tarifatat standarte roaming për thirrje, SMS dhe data që konsumohen jashtë paketave, të cilat do të duhet të reduktohen për të arritur në nivelin brenda vendit (RLAH) apo dhe RLAH+ sipas tavaneve përkatëse të tarifave me pakicë roaming.

Megjithëse, impakti financiar tek operatorët pritet të jetë i ndryshëm, aplikimi i RLAH në BE ka rezultuar me përfitime të mëdha për përdoret celularë, dhe aplikimi i këtij modeli për Shqipërinë dhe BP, pritet të sjellë rritje të mëtejshme të përfitimeve të qytetarëve Shqipërisë dhe të rajonit të BP nga implementimi i mërvëshjes.

## **Efektet në tarifatat me pakicë**

Në lidhje me efektet në tarifatat me pakicë dhe mënyrën se si duhet të aplikohet nga operatorët regjimi RLAH dhe RLAH+ me BP, AKEP do të nxjerrë udhëzime të vecanta të cilat do të bazohen në dokumentat e mëposhtëme të BEREC:

- BoR (16) 34 BEREC Guidelines on Regulation (EU) No. 531/2012 as amended by Regulation (EU) No. 2120/2015 (Excluding Articles 3, 4 and 5 on ëhole-sale access and separate sale of services)

- BoR (17) 56 BEREC GUIDELINES ON Regulation (EU) No 531/2012, as amended by Regulation (EU) 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail Roaming Guidelines)

Dokumenti i BEREC BoR (16) 34 jep udhëzime për mënyrën e implementimit të rregullave të roamingut sipas regjimit RLAH, duke përfshirë dhe fazën tranzitore RLAH+, dhe përfshin çështje të shërbimeve me pakicë dhe me shumicë të roamingut, përveç detyrimeve për aksesin me shumicë dhe shitjen e vecantë të roamingut.

Dokumenti i BEREC BoR(17) 56 përfshin udhëzime dhe për Fair Use policy sipas Rregullores Implementuese të BE 2016/2286. Ky dokument i BEREC jep në mënyrë të detajuar raste dhe shëmbuj të aplikimit të FUP sipas përcaktimeve të rregullores implementuese të BE-së.

**Ndër këto udhëzime/sqarime kryesore të përshtatur për Roamingun Shqipëri-BP (kryesisht për fazën tranzitore RLAH+ sipas BoR (16) 34) janë dhënë më poshtë.**

## Udhëzime për zbatimin e modelit RLAH+ me BP

### Objekti dhe fusha e veprimit

*“Thirrje roaming të rregulluara”* përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO të RSH apo operatorëve celularë të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në RSH, të cilat janë thirrje dalese apo thirrje hyrese drejt apo nga BP dhe/ose RSH.

*“SMS roaming të rregulluara”* përfshin SMS dërguara ose të marra nga pajtimtari i MNO i RSH apo operatorëve celularë të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në MNO në RSH, të cilat janë SMS dalese apo hyrese drejt apo nga BP dhe/ose RSH.

*“Shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming”* përfshin shërbimin e romaingut që mundëson përdorimin e aksesit në Internet të pajtimtarit të MNO të RSH apo operatorit celulare të BP gjatë roamingut në operatorin e rrjetit të vizituar në BP ose në MNO në RSH. Shërbim i rregulluar i të dhënave nuk përfshin transmetimin apo marrjen e thirrjeve të rrgulluara roaming apo SMS-vem por përfshin trasmetimin dhe marrjen e mesazheve MMS.

1. Thirrje të rregulluara roaming përfshin thirrjet e kryera/marra nga pajtimtari i MNO të RSH gjatë roamingut në operatorin e rrjetit vizitues në BP, të cilat janë thirrje dalese drejt apo thirrje hyrese nga RSH dhe/ose BP, pjesë e marrëveshjes së roamingut. Pra në këto thirrje nuk përfshihen p.sh thirrjet e një pajtimtari të MNO të RSH drejt vendeve të BP kur ai ndodhet në Shqipëri (pasi nuk është në roaming në këtë rast), apo thirrjet e pajtimtarit kur është në roaming në një vend të BP që kanë destinacion apo janë origjinuar nga një shtet tjetër i ndryshëm nga BP. I njëjti sqarim vlen dhe për SMS-të. Ndërsa shërbimi i rregulluar i të dhënave në roaming përfshin përdorimin e Internetit të pajtimtarit të MNO të RSH në roaming në një rrjet MNO të vizituar në vendet e tjeat të BP, pavarësisht teknologjisë së përdorur 2G, 3G apo 4G etj.

Thirrjet e rregulluara roaming përfshijnë vetëm thirrjet e origjinuara dhe terminuar në rrjetet celulare në Shqipëri dhe BP. Përfshirja e thirrjeve drejt rrjeteve fikse në këtë periudhë pa rregulluar më parë tarifën e terminimit të këtyre thirrjeve do të përbënte ofrim me humbje të këtyre thirrjeve për operatorët celularë. AKEP dhe autoritetet rregullatove te vendve te tjera te BP do të trajtojnë këtë çështje në një kohë të mëvonshme.

### Tarifat vendase me pakicë si bazë për tarifatat me pakicë roaming në BP

2. Baza për tarifatat roaming në modelet RLAH dhe RLAH+ do jene tarifatat dhe sistemi tarifor i aplikuar për konsumin e shërbimeve brenda vendit. Në rastin e tarifave për njësi të thirrjeve, SMS-ve dhe Internetit, gjate fazës tranzitore RLAH+ operatorët kanë të drejtë të aplikojnë një tarifë shtesë (ekstra) mbi tarifën përkatëse brenda vendit, por kjo tarifë ekstra nuk duhet të jetë më e madhe se tarifatat përkatëse maksimale me shumicë sipas periudhës përkatëse. Njëkohësisht tarifa totale roaming retail, tarifa brenda vendit (domestic retail) + Tarifën Ekstra, nuk duhet të tejkalojë tavanet e përcaktuara 0.19 Euro/min, 0.06 Euro/SMS dhe 0.18 euro/MB (pa TVSH). Tabela e

mëposhtëme paraqet tarifatat ekstra (shitesat) maksimale mbi tarifatat vendase dhe tavanet për tarifatat totale roaming retail sipas RLAH+.

**TABELA 5.1: TAVANET PËR TARIFAT STANDARDE ME PAKICË TE ROAMINGUT ME BP RLAH+ 1.07.2019-30.06.2020**

Periudha	Thirrjet e dalëse (Lek/min)	Thirrjet Hyrëse (Lek/min)	SMS të dërguar (LEK/SMS)	Transmetimi i të dhënave (Lek/MB)
1.07.2019-30.06.2020	Domestic Retail + 7.50	6.00	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail + 3.75
1.07.2020-30.06.2021	Domestic Retail + 7.50	3.75	Domestic Retail + 3.00	Domestic Retail + 2.25
<b>Tavani (1.07.2019-30.06.2020)</b>	28.50	6.00/3.75	9.00	27.00

*Shënim: Vlerat në Lek me TVSH, Kursi i këmbimit i përdorur 1 Euro=125 Lek*

- Tabelat e mëposhtëme paraqesin tarifatat aktuale standarte të roamingut me BP, tarifatat aktuale brenda vendit dhe tarifatat e reja maksimale retail për roamingun në fazën tranzitore RLAH+.

**TABELA 5.2: NDRYSHIM I TARIFAT STANDARDE TE ROAMINGUT ME BP (RLAH+)**

**Tarifatat aktuale standarte (pay as you go) te roamingut me BP (Prill 2019)**

Operatori	Min dalëse	Min hyrëse	SMS	Internet
	(Lek/Min)	(Lek/Min)	(Lek/SMS)	(Lek/MB)
Vodafone Albania	215	175	65	365
Telekom Albania	140	100	20	60
Albtelecom	25	25	10	20

**Tarifatat aktuale standarde brenda vendit (brenda vendit-Domestic retail)**

Operatori	Min dalëse	Min hyrëse	SMS	Internet
	(Lek/Min)	(Lek/Min)	(Lek/SMS)	(Lek/MB)
Vodafone Albania	39/29	0	13	99.94
Telekom Albania	39	0	12	99.94
Albtelecom	29	0	18	10.24

**Tarifat maksimale me pakicë (pay as you go/out of bundle) roaming sipas RLAH+ me BP**

Operatori	Min dalëse	Min hyrëse	SMS	Internet
	(Lek/Min)	(Lek/Min)	(Lek/SMS)	(Lek/MB)
Vodafone Albania	28.50	6.00	9.00	27.00
Telekom Albania	28.50	6.00	9.00	27.00
Albtelecom	28.50	6.00	9.00	27.00

3. Për përdoruesit me kontratë dhe me parapagim që përdorin paketa tarifore brenda vendit që përfshijnë njësi si minuta, SMS, apo MB, aplikimi i RLAH nënkupton që pajtimtari mund të konsumojë njësitë e përfshira në paketë sikur të ishte në Shqipëri dhe njësitë e konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Pas mbarimit të njërive të paketës pajtimtari tarifohet me tarifat përkatëse për njësi sikur të ishte brenda vendit. Për shërbimin e Internetit operatori ka të drejtë të aplikojë FUP (më poshtë). Gjatë regjimit RLAH+ operatori ka të drejtë të aplikojë një Tarifë ekstra, duke tarfuar njësitë e në konsumuara në roaming me tarifë ekstra maksimale sa tarifat përkatëse me shumicë dhe këto njësi të konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Psh. Për fazën e parë të RLAH+, për cdo pajtimtar që ka një paketë (bundle) me minuta, SMS dhe Internet të përfshira në pagesën fikse, operatori ka të drejtë të që gjatë fazës tranzitore RLAH+ të aplikojë tarifë shtesë për njësitë e përfshira në paketë dhe të konsumuara në roaming në BP tarifa shtesë maksimale prej **7.5 lek/minutë për thirrje dalje, 6 lek/Minutë thirrje hyrëse, 3 Lek/SMS të dërguar dhe 3.75 Lek/MB** (të gjitha këto tarifa me TVSH). Për shembullin e dhënë në tabelë, konsumatori do të duhet të paguajë 2430 Lek shtesë për konsumin në roaming gjatë fazës tranzitore RLAH+ për 50 minuta dalje, 25 minuta hyrëse, 10 SMS të dërguara dhe 500 MB të konsumuar në roaming në BP, mbi tarifën fikse që ka paguar për ofertën/pajtimin mujor. Në rast të përdoruesve me parapagim që kanë aktivizuar ofertë, ata duhet të kenë kredite në llogarinë e tyre, dhe tarifa shtesë i zbritet nga këto kredite sipas shpenzimeve të matura me tarifat e cituara.

**TABELA 5.3: SHEMBULL I APLIKIMIT TË RLAH+ PËR BUNDLE**

	Minuta Dalese	Minuta Hyrëse	SMS	Internet (MB)
<b>Sasite e përfshira në paketë</b>	1000	pa limit	500	1000
<b>Sasite e konsumuara në Roaming</b>	50	25	10	500
<b>Tarifa maksimale shtesë RLAH+</b>	7.50	6.00	3.00	3.75
<b>Kosto Shtesë (Lek me TVSH)</b>	375	150	30	1875
<b>Sasite e mbetura</b>	950	pa limit	490	500

*Shënim: Tarifat/Shpenzimet në Lek me TVSH*



## **Tarifa fikse periodike roamingu me BP**

4. Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa tarifore roaming me një tarifë fikse ditore ose çdo tarifë tjetër fikse roaming periodike dhe që përmbajnë një volum të caktuar të shërbimeve roaming të rregulluara në BP. Këto paketa duhet të jenë si një opsion/alternative për klientët e tyre gjatë periudhës tranzitore përveç tarifave të rregulluara roaming. Kjo do të thotë që këto tarifa periodike fikse roaming nuk mund të jenë opsioni i vetëm tarifor i disponueshëm për pajtimtarët roaming.
5. Një tarifë fikse periodike roaming ne përputhje me përcaktimet për RLAH+, mund të mos konsiderohet si tarifë alternative, me kushtin që konsumi i plotë i njësive të përfshira në paketë (pagesën fikse) rezulton në një tarifë për njësi të shërbimeve të rregulluara në roaming (thirrje, SMS dhe data), e cila nuk tejkalon shumën e tarifës vendase dhe me pakicë me tarifën shtesë maksimale sipas përcaktimeve të RLAH+. Për të bërë këtë vlerësim duhet të kryhen llogaritjet përkatëse nëse tarifa fikse është në përputhje me rregullat për RLAH+ Psh. Një paketë që përmabn (Guideline 17 i dokumnetit të BEREC 2016).

Për shembull, nga 1 Korrik 2019 deri më 30 qershor 2020, një paketë tarifore roaming periodike fikse që përfshin 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB mund të tarifohet me një tarifë ekstra maksimale prej 513 Lek (25 minuta \* 7.5 Lek + 25 minuta thirrje të marra \* 6 Lek + 25 SMS \* 3 Lek + 25 MB \* 3.75 Lek) mbi tarifën e paketës brenda vendit. Për tarifën e paketave bundle, kjo do të thotë një tarifë fikse roaming ditore deri në 513 Lek për sasitë e cituara apo më të mëdha do të ishte në përputhje me fazën e parë të RLAH+ me BP. Për tarifën vendase të matur për njësi, një tarifë fikse periodike roaming prej 513 lekë plus çmimin brend vendit retail për 25 minuta thirrje dalëse, 25 minuta thirrje hyrëse, 25 mesazhe SMS dhe 25 MB konsiderohet në përputhje me RLAH+.

Gjithsesi AKEP konsideron këto si paketa alternative të rregulluara që duhet të ofrohen paralelisht me tarifën dhe sistemin tarifor RLAH+, dhe konsumatori të zgjedhë me vullnet të lire paketën e preferuar.

## **Paketa tarifore alternative**

6. Tarifa apo paketa tarifore roaming alternative janë ato tarifa/paketa që ofrohen paralelisht me tarifën e rregulluara roaming me BP. Operatorët kanë të drejtë që të ofrojnë paketa alternative roaming me BP, por tarifën dhe tarifimin default/automatik do jetë sipas përcaktimeve të cituara më sipër (RLAH dhe RLAH+). Nëse pajtimtari dëshiron një paketë alternative roaming ai duhet të informohet nga operatori për mundësinë që ka për të konsumuar sipas RLAH apo RLAH+. Pra zgjedhja e pajtimtarit duhet të jetë me vetdije në kushte që ka informacion të plote për tarifën sipas RLAH dhe RLAH+. Në fazën RLAH+ këta pajtimtarë mund të vijojnë të përdorin tarifën alternative, me kushtin që ata të informohen në mënyrën e duhur për tarifën e rregulluara roaming me BP në kohën që hyjnë në një vend të BP. Informimi për tarifën e rregulluara roaming me BP mund të kryhet me SMS, në faturën mujore, duke përshkruar natyrën e shërbimeve dhe tarifave të rregulluara roaming që pajtimtari ka hequr dorë nga përdorimi për roaming në BP. Në raste se

pajtimatri dëshiron të transferohet nga tarifa aletarnative në atë të rregulluar veprohet sipas përcaktimeve të Vendimeve të AKEP për roamingun me BP.

### **Step charging**

7. Njësiti e konsumuara të thirrjeve gjatë roamingut në BP duhet të tarifohen për sekondë. Operatori ka të drejtë të aplikojë kohë minimale tarifimi jo më të gjatë se 30 sekonda, dhe më pas në njësi sekonde. Tarifimi për SMS duhet të jetë për njësi SMS (1 SMS=140 karaktere). Tarifimi i të dhenave në roaming duhet të jetë në kb. Ky mekanizm tarifimi është i implementueshëm, pasi operatori në RSH merr informacionin nga file TAP nga operatori i rrjetit të vizituar në BP, i cili ka këto detyrime për tarifim të shërbimeve ëholesale. Ky informacion tarifimi në ëholesale i operatorit më pas përdoret dhe procesohet nga operatori vendas për tarifimin retail të pajtimtarit, duke mos ndryshuar mënyrë e tarifimit dhe matjes të njesive të konsumura në roaming, pavarësisht se si është mekanizmi i tarifimit për konsumin brenda vendit.

### **Mundësitë teknike në sistemet e faturimit**

Gjatë procesit të këshillimit publik dhe takimeve të AKEP me operatorët celularë për roamingun rajonal, operatorët celularë janë shprehur ata nuk kanë mundësitë teknike në sistemet e tyre të faturimit për të bërë implemetimin e plotë të RLAH+ nga data 1 Korrik 2019 për pajtimtarët (me paspagim dhe me parapagim) që përdorin paketa apo bundle: aplikimi i tarifës ekstra për njësitë e konsumuara në roaming në BP dhe zbritja e këtyrë njesive nga paketa brenda vendit. Ky shqetësim është ngritur dhe nga operatorët celularë në vendet e tjera të BP.

Në diskutimet e Grupit Koordinues të rregullatorëve për roamingun në BP për marrëveshjen RRA WB6, në takimin në Podgoricë më 31 Maj 2019 u ra dakort që duke filluar nga 1 Korrik 2019 por jo më vonë se deri më 31 Dhjetor 2019, operatorët celularë që nuk kanë këtë mundësi teknike të aplikojnë tarifën ekstra mbi tarifën mesatare për njësi të thirrjeve, SMS dhe MB brenda vendit. Tarifa mesatare për njësi mund të llogaritet nga raporti i të ardhurave retail për thirrje/SMS/MB me sasistë përkatëse për vitin 2018.

AKEP, me hyrjen në fuqi të vendimeve përkatëse për Operatorët, do të nxjerrë rregulla/udhëzues sqarues për implemetimin e plotë të RLAH+ në sistemet e billingut për përdoruesit e paketave/bundle me parapagim dhe paspagim, për mbulimin e periudhës nga data 1 Korrik - deri më 31.12.2019( si afat maksimal i fundit).

### **Udhëzime për FUP për RLAH**

Detaje/udhëzime për aplikimin e RLAH për FUP do të jepen gjatë vitiit 2020 nga AKEP pas miratimit të aktit përkatës që transponon Rregulloren implementuese të BE 2016/2286 për FUP dhe udhëzimeve të BEREC.

# Aneks 1: Komentet e Këshillimit Publik dhe Qëndrimi i AKEP

---

AKEP më datë 7.05.2019 publikoi dokumentin “Rregullimi i tarifave të roamingut ndërkombëtar Shqipëri-Ballkani Perëndimor-Këshillim Publik”. Periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 7.06.2019, dhe në adresë të AKEP kanë depozituar komente palët e interesuara si më poshtë:

- Telekom Albania me shkresën Nr.Prot.2795, datë 31.05.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/8 Prot, datë 3.06.2019);
- Vodafone Albania me shkresën Ref. LEA/042/EK, datë 7.06.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/9 Prot, datë 7.06.2019);
- Albtelecom me shkresën Nr. 4126 Prot., datë 6.06.2019 (Ref.AKEP: Nr.903/10 Prot, datë 7.06.2019);

AKEP falenderon palët e interesuara për komentet e dhëna, dhe më poshtë paraqiten komentet kryesore të tyre, si dhe qëndrimi i AKEP për komentet e depozituara, sipas pyetjeve të këshillimit publik.

## **Komentet sipas pyetjeve**

1. Cfare mendoni për nivelin e tarifave me shumice të roamingut për data të marrëveshjes RRA WB6 në raport me nivelin aktual të tyre dhe ato të aplikuara në BE në modelin RLAH dhe RLAH?

## **Telekom Albania**

Me operatorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor Telekom Albania aplikon tarifa komerciale, përfshirë këtu dhe Kosovën, siç janë evidentuar dhe nga AKEP në seksionin 3 “Tarifat aktuale të roamingut Shqipëri – BP”, paragrafi 3.1 “Tarifat me shumicë”. Këto tarifa komerciale me shumicë të shërbimeve të roamingut të aplikuara midis operatorëve kanë shkuar në përfitim të konsumatorit gjatë përdorimit të shërbimeve të Roamingut në vendet e rajonit dhe në vendet në Kosovë ku trafiku i shkëmbyer zë peshën më të madhe krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor (cit.fq.15 të dokumentit për keshillim publik: gjatë vitit 2017 trafiku i gjeneruar në Shqipëri nga pajtimtaret nga Kosova ishte 67-79% për thirrje dhe SMS dhe 99% data i totalit të gjeneruar nga të gjitha vendet e BP).

Niveli i tarifave me shumicë të roamingut për data sipas marrëveshjes RRA WB6 gjatë periudhës tranzitore RLAH+ (1.07.2019-30.06.2020 me 0.0250€/MB; 1.07.2020-30.06.2021 me 0.0150€/MB) është më i ulët sesa ai që është aplikuar në vendet e BE-së gjatë fazës tranzitore RLAH+ (0.05€/MB).

Gjithashtu, tarifat me shumicë të roamingut për data për Kosovën (të miratuara në dokumentin final “Rregullimi i Tarifave të Shërbimeve Roaming Ndërkombëtar Shqipëri-Kosovë” sipas Vendimit të AKEP Nr.15, datë 11.05.2019) nuk janë në linjë me tarifat përkatëse sipas marrëveshjes RRA WB6 për periudhën tranzitore RLAH+ dhe të propozuara në këtë dokument të keshillimit publik, duke qenë disa here më të ulëta sesa këto tarifa. Dhe kjo kur Kosova është gjithashtu pjesë e marrëveshjes së Roamingut RRA të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo gjeneron një situatë konfuze dhe komplekse duke qenë se Kosova është pjesë e të dyja marrëveshjeve të Roamingut dhe në këtë mënyrë nuk do të kemi tarifa uniforme të roamingut në të gjithë rajonin.

Këto shqetësime bashkë me problematiken e prefiksit ndërkombëtar të operatorit IPKO të Kosovës dhe Mobitel të Sllovenisë të cilët kanë të njëjtin kod tarifimi, Telekom Albania i ka ngritur dhe në komentet e dërguara në keshillimin publik për reduktimin e tarifave të roamingut ndërkombëtar me Kosovën, gjë e cila nuk është adresuar akoma nga AKEP në vendimet finale Nr.15, 16, 17 dhe 18 datë 11.05.2019, dhe pse në vendimin nr.15, në pjesën e komenteve të operatorëve AKEP citon se këto çështje janë ende në proces adresimi.

Telekom Albania propozon që tarifat e propozuara me shumicë të roamingut për data të mos jenë më të ulëta se ato të që janë aplikuar gjatë fazës tranzitore RLAH+ si dhe për RLAH në BE, duke qenë se çmimet e shumicës prekin direkt çmimet e përdoruesit fundor. Gjithashtu, TA gjykon që tarifat e roamingut me shumicë për data si për BP ashtu dhe për Kosovën të jenë në të njëjtën linjë, duke qenë se Kosova është pale në të dyja marrëveshjet e roamingut.

## **Albtelecom**

Përsa i takon nivelit të propozuar të tarifave me shumicë të roamingut për të gjitha shërbimet (voice, SMS dhe data) me operatorët e vendeve të BP, duke i krahasuar me tarifatat aktuale që Albtelecom ofron dhe i ofrohen nga këta operatorë, vërehet një diferencë e konsiderueshme, e cila varion nga tarifatat preferenciale deri tek ato standarte (standard IOT – Inter Operator Tariff) të cilat vazhdojnë të aplikohen ende. Albtelecom vazhdimisht ka ndërmarrë hapa për negociata dhe ulje të tarifave standarte me shumicë roaming duke ju drejtuar operatorëve respektive, por nuk ka arritur finalizimin e tyre më së shumti për arsye komerciale apo refuzime për shkak të marrëdhënieve ekzistuese me dy operatorët e tjerë në Shqipëri.

Duke patur parasysh ndryshimin e madh të tarifave ekzistuese me shumicë me ato të propozuara por edhe të tarifave me shumicë roaming të aplikuara në BE, gjykojmë që tarifa me shumicë për shërbimin data është me vend.

Në raport me tarifatat me shumicë roaming për data krahasuar me nivelin e BE për modelin RLAH+ dhe RLAH, jemi të mendimit që tarifatat e propozuara janë të drejta duke konsideruar që tarifatat me shumicë roaming për data nga disa operatorë vazhdojnë të ofrohen në nivelin e 9 – 10 Euro për MB. Reduktimi i përshkallëzuar i tarifave me shumicë roaming për data është në nivel tregu.

Shqetësimi i Albtelecom, siç jemi shprehur edhe në komentet për konsultimin publik (VKD Nr.07, dt 15.03.2019) “Rregullimi i tarifave të shërbimeve roaming ndërkombëtar Shqipëri - Kosovë”, por edhe në shkresën e përbashkët nga të tre operatorët vendas adresuar AKEP dhe MIE “Request for accommodating the difficulties arising from the tight implementation deadlines of the Agreement “On the Price Reduction of the Roaming Services in Public Mobile Communication Networks in the WB Region hereinafter referring to as the “WB6 Roaming Agreement”” më datë 10.05.2019, mbetet aplikimi i tarifës së rregulluar për terminim ndërkombëtar për thirrjet roaming. Risku për sjellje abuzive është shumë i lartë dhe përbën një shqetësim të madh për operatorët dhe lidhet direkt me të ardhurat nga trafiku i terminimit ndërkombëtar, kjo bazuar edhe në eksperiencat e deritanishme në tregun e trafikut ndërkombëtar në përgjithësi.

Për sa më sipër, Albtelecom sugjeron që aplikimi i tarifave të rregulluara për shërbimin voice të shtyhet në datë 01.07.2020, për shkak se afati i implementimit të Marrëveshjes Rajonale Roaming midis BP është shumë i shkurtër si në nivel komercial apo dhe teknik (i pamundur) duke patur parasysh që implementimi i shërbimit voice në roaming lidhet direkt me terminimin ndërkombëtar.

Gjithësesi, Albtelecom risjell në vëmendje rëndësinë e vendosjes së mekanizmave mbrojtës në nivel Ëholesale dhe Retail roaming për të parandaluar sjelljet abuzive/fraud gjatë përdorimit të shërbimeve roaming, si: permanent roaming, Machine-to-Machine, IRFS, SIM-box, si dhe politika të përdorimit të drejtë por edhe procedurave të qarta për ndjekje të çdo rasti abuziv nëpërmjet akteve apo udhëzimeve përkatëse.

## **Qëndrimi i AKEP**

Për sa i përket ndryshimit të tarifës ëholesale për data të RRA WB6 me tarifën e aplikuar në BE në RLAH+, vendet e BP (rregulatorë dhe ministritë) ranë dakort në negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes për aplikimin niveleve më të reduktuara për këtë tarifë për shkak se dhe operatorët në mënyrë komerciale, sic përmendet dhe komente, aplikojnë aktualisht në shumë raste tarifa më të lira ëholesale se 50 Euro/GB. Gjithashtu tarifat ëholesale data 25 dhe 15 euro GB përbëjnë një reduktim më të përshkallëzuar drejt nivelit 7.7 euro kur fillon RLAH sesa kalimi direkt nga 50 në 7.7 euro/GB. Gjithashtu kjo u ra dakort për të rritur përfitimet e përdoruesve për shërbimin data.

Për sa i përket për prefiksin e IPKO, rregullatori i Kosovës ka deklaruar se procesi i ndërrimit ka përfunduar më datë 1 Qershor 2019 dhe nuk paraqet më problem për zbatimin e marrëveshjes dhe detyrimeve për roamingun edhe për IPKO.

Për sa i përket shtyrjes së afatit për rregullimin e shërbimeve të thirrjeve dhe MTR ndërkombëtare të thirrjeve të lidhura me roaming në BP, AKEP sqaron se:

- ky nivel dhe glide path është i njejtë me nivelin e përcaktuar në RRA WB6 të nënshkruar në 4 Prill 2019;
- niveli është shumë më i lartë se MTR mesatar në vendet e BE që aplikohet për këto thirrje sipas rregulloresve të BE;
- është shumë më i lartë se niveli aktual i MTR kombëtar në Shqipëri.
- propozimi për aplikim të MTR të rregulluar vetëm për thirrjet ndërkombëtare të lidhura me roamingun është dhënë nga vetë operatorët celularë, madje kjo zgjidhje u propozua dhe pranua edhe për RRA WB6.

2. Cfarë mendoni për detyrimet e propozuara nga AKEP për aksesin në nivel me shumicë për roamingun me BP?

### **Telekom Albania**

Lidhur me propozimet e AKEP për detyrimet për akses në nivel me shumicë për roaming në vendet e Ballkanit Perëndimor, në vijë të përgjithshme, Telekom Albania gjykon që këto masa duhet të mbështeten mbi disa parime baze:

- Proporcionaliteti i përcaktimit të detyrimeve;

- Nevoja per te garantuar mbulimin e plote te kostove;
- Nevoja per te garantuar qe keto detyrime te jene ne linje me objektivin e Marreveshjes per te ofruar sherbime te rregulluara te roamingut perdoruesve fundore.

Propozimet per percaktimin e ketyre detyrimeve nuk duhet te kufizohen vetem ne nje perskrim te detyrimeve te operatoreve te rrjeteve celulare te ofrojne akses, por duhet gjithashtu te percaktojne dhe detyrimet qe duhet te plotesojne kerkuesit e aksesit. Rrjedhimisht ne keto propozime duhet të parashikohen rregulla për t'i dhënë MNO-ve mundësi për të mbrojtur veten, p.sh. kundër skenarëve të mashtrimit ose rrezikut të borxheve të këqija të shkaktuara nga klientët fundorë, rishites ose kërkuesit e aksesit.

Per te siguruar nje bashkepunim te mire ndermjet ofruesve dher kerkuesve per akses ne nivel shumice te roamingut, ne udhezimet dhe rregullat qe duhet te percaktohen nga ana e autoriteteve rregullatore perkatese, duhet te merren ne konsiderate marreveshjet ekzistuese te roamingut si dhe proceset dhe kerkesat e lidhura me to. Nje aspekt tjetër qe duhet te merret parasysh lidhet me marrëdhënien e njëanshme te roamingut ndermjet kerkuesit te aksesit dhe ofruesit te aksesit, pasi ne kete lloj situatë MNO hostues perballen me nje rrezik me te larte te mospagimit nga operatori vizitor, duke qene se nuk mund te balancoje trafikun e tij te roamingut me trafikun e operatorit vizitor.

Per rrjedhoje, operatorët e rrjeteve duhet te kene te drejten e refuzimit te dhenies se aksesit nese kerkuesi i aksesit nuk permbush per shkaqe teknike ose komerciale kushtet e kontrates. Disa raste qe mund te krijohen mund te jene si me poshte:

- Mos-permbushja e standarteve teknike te percaktuara ne kontraten perkatese. Psh: nje kerkues aksesi qe kerkon akses direkt ne nivel shumice per roaming duhet te paraqese nje MCC/MNC per te mundesuar rrjetit te vizituar te identifikojë pajtimtarët vizitues te kerkuesit te aksesit;
- Refuzimi ose pamundësia per te ofruar kompensim per kostot e lidhjes (set-up costs): pasi MNO nuk është në gjendje të kthejë cdo trafik në drejtim të kerkuesit te aksesit, duhet të merret në konsideratë natyra e njëanshme e marrëdhënies roaming (p.sh. MNO te mbajne të gjitha kostot për testim). Tarifa e vendosjes duhet të mbulojë vendosjen e lidhjes, testimin dhe nisjen e shërbimeve bazë të roamingut;
- Pezullimi ne raste frodi: pasi numri i lojtarëve pritet të rritet ndjeshëm, kjo do të kufizojë mundësitë e MNO-ve për të vlerësuar rreziqet komerciale dhe për të parandaluar frodin (p.sh. nga kontrolli i trafikut). Kjo situatë mund të çojë në një rrezik më të lartë të frodit. Prandaj, MNO - ja hostuese duhet të ketë të drejtën të pezullojë shërbimet roaming për klientët roaming të operatorit në rast të sjelljes fraudolente.

Pra, eshte e rendesishme qe detyrimet e propozuara per aksesin ne nivel shumice te roamingut duhet te marrin parasysh problematikat e permendura me siper si dhe te perfshijne vetem ato elemente te rrjetit qe jane te lidhura direkt me ofrimin e sherbimeve me shumice te rregulluara te roamingut te kesaj marreveshje. Kostoja per dhenien e aksesit per keto elemente duhet te mbulohet

nga niveli maksimal i tarifave me shumice te roamingut, ndersa cdo element tjeter shtese ose opsional qe nuk jane te lidhura direkt me sherbimet me shumice nen rregullim te roamingut me vendet e BP duhet te negociohen komercialisht midis operatoreve perkates te ketyre vendeve, mbi tarifa te arsyeshme dhe te drejta.

### **Albelecom**

Në lidhje më detyrimin për akses në nivel shumice për roaming propozuar midis operatorëve të Shqipërisë dhe operatorëve të tjerë të BP, mendojmë që ky detyrim është paraprakisht i ezauruar pasi është në interes të çdo operatori të ofrojë shërbim roaming më vendet fqinje apo vendeve më rëndësi të veçantë.

Albtelecom ofron akses në shërbimin roaming për të gjithë operatorët e BP. Gjithashtu, Albtelecom si operator i tretë në tregun shqiptar, e çmon rëndësinë e ofrimit të aksesit në krijimin e marrëdhënieve roaming për të ofruar shërbim roaming në radhë të parë pajtimtarëve të rrjetit të vet por edhe për të ofruar këtë shërbim pajtimtarëve të rrjeteve vizitorë.

Duke patur parasysh që:

- tarifavat roaming me shumicë dhe kushtet e ofrimit të tyre do të jenë objekt rregullimi;
- marrëdhënia roaming është tashmë e standartizuar dhe rregulluar nga GSM Association duke mbuluar të gjitha aspektet e këtij shërbimi;

Albtelecom thekson se ofrimi i aksesit roaming në këtë fazë është përmbushur. Gjithashtu, në varësi të kërkesave për akses roaming në të ardhmen, Albtelecom do të vijojë me ofrimin e tij sipas standarteve të GSMA dhe në përputhje me parashikimet e marrëveshjes roaming rajonale të nënshkruar midis vendeve të BP dhe akteve/rregulloreve përkatëse që mund të dalin në zbatim të kësaj marrëveshje.

### **Vodafone Albania**

Në funksion të ofrimit të shërbimeve telefonike për një hapësirë sa më të gjerë edhe jashtë Shqipërisë, aktualisht, Vodafone Albania ka marrëveshje për shërbimet roaming me të gjithë operatorët e pesë vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor. Në këto kushte, ajo që momentalisht diktohet nga rregullimi i tarifave të roaming-ut është amendimi i këtyre marrëveshjeve dhe jo ofrimi i aksesit nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të reja. Gjithsesi në kuadër të ofrimit të një shërbimi roaming cilësor dhe gjithpërfshirës, Vodafone Albania ka në zbatim politika dhe procedura të një formati standard për lidhjen e marrëveshjeve të reja roaming kur kjo është e nevojshme.

### **Qëndrimi i AKEP**



AKEP gjykon që të vendosë vetëm detyrimet e propozuara në këshillim publik për aksesin eholesale për roaming, dhe këto detyrime janë vetëm një pjesë e voëel e detprime të vendosura nga BE për vendet anëtare (neni 3 i Rregullores 2015 të BE). Detyrimet për akses janë vetëm për roaming, dhe nuk përbëjnë barrë të rëndë për operatorët.

Ne lidhje me ceshtjet e SIM box apo aktivitete te tjera abuzive te thirrjeve nderkombetare, operatoret jane te lire te vendosin ne negociata kushte per shmangien e mashtrimeve. Ky fenomen ka ekzistuar dhe ne Shqiperi (pra ne mungese te rregullimit te roamingut dhe MTR te lidhura me to), dhe AKEP ka asituar operatoret celulare per te shmangur apo reduktuar keto aktivitete, perfshire procedurat per keto raste gjate vitit 2018.

Edhe vendet e BE-se ndeshen me tarifa terminimi jashte rregullimit per thirrjet nga jashte vendeve te BE, por rregullat e BE jane zbatuar nga te gjithë operatorët, perfshire kompanite mema apo me lidhje me operatorët celulare te Shqiperise. AKEP ka ngritur ne takimet per perгатijen e RRA WB6 shqetesimet e operatoreve celulare per problemet e mundshme nga SIM box si dhe do vijojë te bashkepunoje ngushtesisht me NRA e BP, KE dhe BEREC per zbatimin e marrveshjes RRA WB6 dhe minimizimin apo eliminimin e ketyre problemeve.

3. Cfare mendoni per detyrimet për transparence të operatorëve për roamingun me BP dhe masat mbrojtëse për përdoruesit?

### **Telekom Albania**

Percaktimi i masave mbrojtëse dhe detyrimet për transparence nga ana e operatoreve për roamingun me vendet e Ballkanit Perendimor jane te nevojshme ne implementimin e RLAH midis Shqiperise dhe BP.

Keto detyrime Telekom Albania i permbush edhe sot, sic jane: informacioni i detajuar jepet ne Bon Voyage SMS, ne links pa pagese, ne ëebsite dhe duke telefonuar falas kujdesin e klientit. Klienti gjithashtu informohet ne nivelet 80% dhe 100% te konsumimit te volumit te paketes, apo te konsumit te trafikut jashte paketes.

Lidhur me masat për transparence aktualisht Telekom Albania i ofron keto masa si për cdo shërbim edhe për shërbimin Roaming që ofron për klientët me parapagese dhe me kontrate. Tarifat roaming, opsionet tarifore roaming, detaje të shërbimeve të vlefshme në roaming janë të publikuara gjithashtu në faqen zyrtare të kompanisë si dhe në kontratën e firmosur nga abonenti.

Per vendet e Ballkanit Perendimor klienti do te informohet ne vecanti per:

- rrjetin /shtetin menjehere me SMS informuese,
- opsionet e tarifimit dhe do te keshillohet per per te bere zgjedhjen e duhur (do te kete informacion te detajuar per tarifat per njesi dhe paketat)
- njesite e konsumuara ne roaming ne nivelin 80% dhe 100% te tyre
- per te evituar bill shock do te informohet kur te arrije nivelin e konsumit 5000 Lek/muaj
- do te marre informacion dhe mbeshtetje duke telefonuar falas kujdesin e klientit.

### Albelecom

Nga ana e Albtelecom trasparenca për tarifat e aplikuara në roaming është parim bazë dhe ju ofrohet pa dallim të gjithë pajtimtarëve të Albtelecom. Sipas dokumentit për këshillim publik, paragrafi 2, faqe 35, kërkohet që: “Pajtimtari të ketë mundësinë që pas çdo mesazhi të cituar më sipër të njoftojë pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë MNO-në, se ai nuk kërkon shërbimin e mesazhit automatik”.

Aktualisht, Albtelecom ofron këtë shërbim për pajtimtarët e tij pa pagesë dhe në çdo rast që pajtimtari është roaming nëpër botë. Në rast se pajtimtari kërkon mosaktivizimin e shërbimit të mesazhit automatik, Albtelecom, bazuar në sistemet në dispozicion, e ka të pamundur ofrimin e kesaj mundësie (ç’aktivizimin e marrjes së mesazhit automatik). Për të mundësuar këtë alternative, Albtelecom kërkon investime në sisteme dhe kohë implementimi shtesë.

Bazuar në eksperiencën e Albtelecom dhe problematikave që hasen në abonentë të caktuar gjatë përdorimit të shërbimit Roaming, mendojmë dhe sugjerojmë që klienti duhet të jetë në mënyrë kostante i informuar për tarifat dhe shpenzimet e tij gjatë qëndrimit në roaming.

Madje, për të qenë sa më pranë klientit dhe transparent me të, Albtelecom vazhdimisht shton kanalet e komunikimit me pajtimtarët e tij (Aplikacioni “Profili Im”, SMS, USSD, Customer Center, IVR, etj).

Albtelecom gjykon si masë jo proporcionale vendosjen e këtij detyrimi, në një kohë që detyrime të kësaj natyre që megjithëse nuk janë aq thelbësore kërkojnë investime shtesë për operatorin dhe që sidoqoftë nuk mund të arrihen në kohë, çka mund të çënojë, realizimin e objektivit për implementimin korrekt të modelit RLAH+ dhe RLAH me vendet e BP. Për më tepër, në gjykimin tonë, mos vendosja e një detyrimi të tillë, nuk kufizon pajtimtarin nga ndonjë benefit apo vlerë të shtuar në lidhje me shërbimet roaming, madje përkundrazi njoftime të tilla të natyrës informuese vetëm sa shtojnë transparencën për abonentin dhe nuk çënojnë të drejtën e tij për tu informuar.

Koha mjaft e ngushtë për implementimin e marrëveshjes rajonale të roaming RRA WB6 (këtu e më poshtë referuar si “Marrëveshja”) të nënshkruar vetëm 1 muaj më parë (4 Prill 2019), shoqëruar me vendosjen e një sërë detyrimesh jo proporcionale për transparencën, për rrethanat aktuale dhe termat kohorë të vendosjes së këtyre detyrimeve (ndërkohë që konsumatorit nuk do t’i mungojë asnjë vlerë e shtuar apo përfitim nga realizimi i RLAH+ me BP), jo vetëm që nuk t’i shërbente por përkundrazi vetëm do të çënonte zbatimin korrekt dhe përfitimet konkrete të pajtimtarëve nga aplikimi i tarifave të regulluara roaming me pakicë.

Albtelecom gjykon si jo-proporcionale qasjen e AKEP në propozimet e tij që mbingarkojnë operatorët me një sërë detyrimesh të tjera, (në mënyrë specifike për elementët e detyrimit për transparencën) në një kohë që Albtelecom nga ana e tij, siç jemi shprehur edhe më lart, ofron një sërë rrugësh alternative për të informuar abonentin dhe për të qene plotësisht transparent me të. Ky gjykim i yni, vjen në rrethanat kur vetë AKEP pranon se akoma nuk janë transpozuar aktet e BEREC BoR (16)34 e BoR (17) 56 të cilat do të shërbejnë si dokumenta referues për t'i dhënë mundësinë MNO-ve për zbatimin korrekt dhe në kohë të modeleve RLAH+ dhe RLAH.

Në mungesë të transpozimit tani për tani të këtyre akteve, çka do t'i kishte dhënë mundësinë operatorëve për tu njohur paraprakisht, për të vlerësuar impaktet nga vendosja e një sërë detyrimeve dhe për të patur kushtet dhe mundësitë e duhura për të implementuar zgjidhjet përkatëse për zbatimin e këtyre detyrimeve, dhe për më tepër kur bëhet fjale për implementim të detyrimeve në 6 vende njëherazi, Albtelecom gjykon të papërshtatshëm imponimin, sidomos në këtë fazë, të detyrimeve të tilla si: "Pajtimtari të ketë mundësinë që pas çdo mesazhi të cituar më sipër të njoftojë pa pagesë dhe në mënyrë të lehtë MNO-në, se ai nuk kërkon shërbimin e mesazhit automatik".

### **Vodafone Albania**

Vodafone Albania gjykon të nevojshme masat mbrojtëse si dhe detyrimet për transparencë nga ana e operatorëve për roamingun me vendet e Ballkanit Perëndimor. Edhe sot pajtimtari ka dijeni për tarifën roaming dhe mund të shfrytëzojë gjithë këshillat për përdorimin e shërbimeve roaming të cilat janë të publikuara në faqen eeb, njëkohësisht informohet për konsumin e volumit brenda paketave të blera (për plotësimin 80% apo 100%) nëpërmjet SMS.

### **Qëndrimi i AKEP**

Operatorët vihet re se pranojnë detyrimet për transparencë, madje një pjesë e rëndësishme e tyre aplikohen tashme nga operatorët. Sic është sqaruar në dokument, detyrimet për transparencë në paragrafet 5 dhe 6 janë vendosur sipas rregullores së BE të vitit 2015. Propozimi për FUP dhe dokumenti i BEREC për FUP janë për modelin RLAH dhe jo për RLAH+. Gjithsesi elemente shtesë të sqarimeve për paqartësitë e operatorëve do të jepen nga AKEP në takime dhe me komunikim me shkrim.

4. A mendoni se limiti financiar 5000 Lek/muaj në roaming me BP është i arsyeshëm për të shmangur Bill Shock?

### **Telekom Albania**

Limiti financiar i propozuar nga AKEP prej 5000 lek/muaj ne roaming me BP eshte nje limit qe aktualisht aplikohet nga ana jone. Telekom Albania mendon qe eshte i arsyeshem per te shmangur Bill Shock ne rast se klienti nuk ka perzgjedhur te aktivizojë pakete ne roaming, por ka zgjedhur te vazhdoje te perdore internetin duke u tarifuar me tarifen per njesi (MB).

### **Albelecom**

Ky limit është i aplikueshëm për klientet me paspagesë dhe parapagese vetëm për shërbimin Data në roaming.

Gjithashtu, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit të Albelecom si: Profili IM, SMS, USSD, Customer Center, IVR, klienti Albelecom ka mundësi të kontrollojë balancën në kohë reale dhe të ç'aktivizojë shërbimin roaming nëse nuk do të vazhdojë ta përdorë atë.

Në lidhje me detyrimin e informimit të klientit kur kalohet limiti financiar 5000 Lek/muaj, Albelecom është dakort dhe në bazë te eksperiencës sonë ky element mirëpritet nga pajtimtari.

### **Vodafone Albania**

Në mënyrë që pajtimtari të ketë liri dhe fleksibilitet në përdorimin e shërbimit, operatorët duhet të lejohen të vendosin në dispozicion të pajtimtarit disa skema me nënkategori nivelesh të ndryshme shpenzimi. Vodafone është dakort me vendosjen e kufirit financiar të parazgjedhur si dhe me mundësinë për të aplikuar kufij shtesë (më të lartë ose më të ulët sipas preferencës së pajtimtarit) krahas opsionit prej 5,000 lekë (pa TVSH)/muaj.

Mendojmë se duhet të përcaktohet qartë tek aktet rregullatore se parashikimet lidhur me kufirin financiar aplikohen vetëm në rastin e pajtimtarëve me paspagesë dhe i referohen vetëm shërbimit të roamingut të transferimit të të dhënave.

### **Qëndrimi i AKEP**

Operatorët vihet re se pranojnë aplikimin e kufirit 5000 leke, madje dhe e aplikojnë atë, por kane propozime per specifikime si aplikim vetem per perdoreusit me kontarte dhe vetem per data. AKEP ka vendosur kete detyrim sipas Rregullores TSM 2015 te BE ne paragrafin e detyrimeve per transparence per data (te dhena) pra ky kufi eshte i palikueshem vetem per data. Nese ka nevojë te behet ndarje apo specifikime per perdorues me parapagim pao paspagim, AKEP do e perfshije kete sqarim ne udhezimet per RLAH+.

5. Cfarë mendoni se duhet të jenë elementët kryesoeë që duhet të përfshijë akti i AKEP për FUP?

## Telekom Albania

Percaktimi i detajuar i politikave te drejta (FUP) dhe i elementeve te saj perben nje aspekt te rendesishem, vecanerisht ne lidhje me trafikun e te dhenave (data) ne nivelin e tregut me pakice per shkak te rreziqeve te fraud-it te cilat impaktojne negativisht konkurrencen dhe operatoret ne tregjet perkatese kombetare

Percaktimi i FUP ne nivel retail nepermjet akteve rregullatore specifike u lejon operatoreve te balancojne ne menyre te drejte kategori te ndryshme te pajtimtareve roaming. Keto politika duhet te plotesojne disa kushte si psh:

- a. te jene transparente dhe te pershtatura per te gjitha modelet tarifore qe operatoret aplikojne;
- b. te thjeshta dhe te kuptueshme per pajtimtarin, dhe te thjeshta per t'u implementuar nga ana e operatoreve;
- c. te jene fleksibel per t'u perdorur si nje mjet konkurrues nga operatoret e rrjeteve.

Dokumenti i BEREC BoR(17)56 "Udhezuesi i BEREC mbi Rregulloren e BE Nr.531/2012, ndryshuar me Rregulloren e BE 2015/2120 dhe Rregulloren e BE per aplikimin 2016/2286 (Udhezuesi per Roamingun me pakice) eshte nje dokument qe duhet perdorur si reference per aplikimin dhe zbatimin e politikave te drejta te perdorimit (FUP) per roamingun midis Shqiperise dhe vendeve te Ballkanit Perendimor, sidomos ne lidhje me paketat tarifore ne lidhje me trafikun e internetit, qe eshte dhe ceshtja me shqetesuese qe prek ne menyre me te theksuar pajtimtaret ne situata te roamingut ne keto vende.

Ne lidhje me paragrafin 3 faqe 38 te dokumentit per keshillim publik qe citon se: *"Kurdo qe një klient roaming kërkon të zgjedhë ose të heqë një limit financiar ose sasi, ndryshimi do të bëhet brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, ai duhet të jetë pa pagesë dhe nuk do të sjellë kushte ose kufizime që u përkasin elementeve të tjerë të pajtimtimit"*, Telekom Albania nuk eshte dakort pasi politika jone per limitet financiare ne roaming eshte e mirepercaktuar dhe per tu mbrojtur nga mospagesat e faturave TAL duhet ta rezervoje kete te drejte vetem me vendimmarrjen e saj dhe jo me kerkese te prere nga klienti.

Disa nga elementet qe TA gjykon si te rendesishme per t'u perfshire ne percaktimin e FUP nga ana e AKEP jane ato te parashikuara dhe ne dokumentin perkates te BEREC "BEREC GUIDELINES ON Regulation (EU) No 531/2012, as amended by Regulation (EU) 2015/2120 and Commission Implementing Regulation (EU) 2016/2286 (Retail Roaming Guidelines)". Disa nga keto elemente jane:

- a) residenca e pajtimtarit;
- b) masat per ndalimin e rishitjes se organizuar te kartave SIM;
- c) vendosja e limiteve per paketat "open bunldes" dhe per paketat prepaid;
- d) mekanizma kontrolli te bazuar ne tregues objektivi si psh: konsumi mbizoterues dhe kriteri i prezences, inaktivitet per nje kohe te gjate i nje karte SIM i shoqeruar me perdorim

kryesisht ne roaming, abonim dhe përdorim i njëpasnjëshëm të kartave SIM të shumfishta nga i njëjti klient gjatë roamingut, etj;

Te gjithë keto elemente qe TA mendon te jene pjese per tu perfshire ne aktin e AKEP per FUP duhet te detajohen ne menyre te qarte nga ana e AKEP ne perputhje me udhezimet perkatese te BEREC ne menyre qe te shmangen situata abuzive, konfuze apo paqartesi ne implementimin e RLAH midis vendeve te Ballkanit Perendimor dhe Shqiperise.

### **Albelecom**

Së pari, implementimi i një politike të drejtë përdorimi (FUP) është i domosdoshëm gjatë fazës RLAH por edhe gjatë fazës RLAH+ në varësi të benefiteve/paketave që u ofrohen pajtimtarëve, dhe për të siguruar një përdorim të drejtë të shërbimeve. Rregullorja implementuese e miratuar nga BE 2016/2286 për FUP dhe udhëzimet e BE mund të shërbejnë për hartimin e aktit përkatës.

Albelecom gjykon që disa nga elementët kryesore që duhet të përfshihen për FUP janë si më poshtë:

- Vendosja e limiteve në bazë ditore në përdorimin e njësive të përfshira në paketat domestike (voice, SMS, data);
- Në rast të njësive pa limit të përfshira në paketat domestike, këto njësi do të jenë të limituara kur kjo paketë përdoret në roaming;
- Marrja e masave për rishitje të kartave SIM;
- Përkufizime dhe masat e duhura për të evituar permanent roaming; etj.

Megjithatë, Albelecom mendon se është i domosdoshëm konsultimi i të gjithë elementëve për FUP me palet e interesit përpara miratimit të këtij akti rregullator nga AKEP.

### **Vodafone Albania**

Vodafone sugjeron fuqishëm që të ketë mundësi të implementojë politika të përdorimit të drejtë (fair use policy) për sa i përket shërbimit të thirrjeve roaming me qëllim që të parandalojnë përdorimin abuziv ose jo normal të shërbimeve të Roamingut me pakicë nga pajtimtarët/klientët roaming. Sugjerojmë që aktet nënligjore që do të miratohen për këtë qëllim, t'i nënshtrohen fillimisht procesit të konsultimit publik me operatorët dhe të jenë në përputhje me rregulloret përkatëse të BE dhe udhëzimet e BEREC.

### **Qëndrimi i AKEP**

AKEP vlerëson komentet e operatorëve dhe do ti marrë në konsideratë në hartimin e rregullave për FUP gjatë vitit 2020.

## ***Komente të përgjithshme***

### **Telekom Albania**

Shoqeria Telekom Albania mirepret vendimin e AKEP për keshillimin publik lidhur me rregullimin e tarifave të shërbimeve të Roamingut ndërkombëtar midis Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Por duke marrë parasysh impaktin teknik dhe komercial si dhe afatet kohore për implementimin e Marreveshjes së Roamingut Rajonal me vendet e Ballkanit Perëndimor, Telekom Albania dëshiron të shpreh konsideratat dhe komentet e saj mbi çështjet e trajtuara në këtë keshillim publik sipas pyetjeve të formuluar nga AKEP, por po risjellim dhe njëherë në vëmendjen e AKEP dhe disa shqetësime që lindin, të shprehura dhe me parë gjatë keshillimit publik për Roamingun Nderkombetar me Kosoven:

- Në vendet e BE-se, procesi i implementimit të RLAH i ka filluar që në 2006 për reduktimin e tarifave të roamingut, që ka vazhduar me tej me futjen e fazes tranzitore 30.04.2016-15.06.2017 për RLAH+ për aplikimin e tarifave shtese mbi planet tarifore domestike deri më 15.06.2017 me hyrjen në fuqi të regjimit të plote të modelit RLAH. Pra, një proces që kërkoj pothuajse një dekadë për implementimin e plote të RLAH në të gjitha vendet anetare të Bashkimit Europian.
- Ndërsa koha për implementimin e Marreveshjes së Roamingut me Ballkanin Perëndimor që nga momenti i nxjerrjes së vendimit për keshillimin publik më 07.05.2019 deri në fillimin e zbatimit të saj të parashikuar më 01.07.2019, është mjaft e shkurtër, sepse operatorët do të kenë më pak se dy muaj për të adoptuar dhe bërë të zbatueshme këtë marreveshje, ndërkohë që në vendet anetare të BE-se kjo periudhë zgjati 10 vjet deri në futjen e regjimit të plote të RLAH. Vecanerisht procesi i implementimit të RLAH zgjati më shumë se një vit e gjysëm, nga Tetori 2015 nga vendimi përfundimtar deri më Qershor 2017, ditën e lancimit live.
- Me implementimin e RLAH me Ballkanin Perëndimor si dhe rregullimin e MTR-ve ndërkombetare për trafikun e lidhur me shërbimet e roaming për shkak të diferencave të mëdha të saj me tarifën e MTR-se për trafikun ndërkombetar normal, Telekom Albania vlerëson se do të gjenerohen mundësi për situata të fraud-it, që mund të shfaqen në disa forma si psh me anë të SIM box-eve ndërkombetare të cilat mund të rrugëzojnë trafikun ndërkombetar të vendeve të tjera me CLI të modifikuar duke krijuar humbje financiare të konsiderueshme për TA. Gjithashtu potencial për fraud krijohet edhe me anë të kartave SIM të roamingut të cilat do të kenë mundësi të përdorin RLAH kundrejt destinacioneve me kosto interkoneksioni më të shtrenjta. Voice Hub nëpërmjet një international carrier që do të krijohet nga një international carrier për vendet e BP do të zbusë në një farë mase ekspozimin e operatorëve në rritjen e aktivitetit të fraud-it që pritet të ndodhë për shkak të diferencave të rëndësishme ndërmjet tarifës standarte të terminimit ndërkombëtar dhe atij të rregulluar, i cili do të ndikojë direkt të ardhurat nga terminimi ndërkombetar për të gjithë operatorët por më e rëndësishmja përvojën e konsumatorëve dhe cilësinë e shërbimit.
- Një opsion tjetër i implementimit të MTR-ve ndërkombetare të rregulluara për thirrjet e origjinuara dhe të terminuara tek abonentët roaming të 6 vendeve të BP në rrjetet e njeri-

tjetrit eshte nepermjet TAP fileve te roamingut, por ne kete rast duhet te kryhen operacionet e kreditimit dhe debitimit nga MTR nominal nderkombetare te operatoreve ne vleren 0.04 Euro/min.

- Ne lidhje me situatat potenciale te permanent roaming diferenca e produkteve retail midis vendeve te Ballkanit Perendimor dhe Shqiperise stimulon marrjen e kartave roaming te operatoreve me cmime me te lira ne retail, duke krijuar perdorimin e kartave te roamingut ne vend te sherbimeve domestike te cilat mund te jene me cmime me te larta se cmimet e retail te roamingut me Ballkanin Perendimor.
- Ne kete draft eshte parashikuar gjithashtu dhe glide-path-i i MTR-ve nderkombetare per thirrjet e gjeneruara ne situaten roaming te cilat do te jene reciproke per te gjitha operoret. Ne kete proces, ashtu si dhe ne ate te roamingut me Kosoven, nuk eshte marre ne konsiderate fakti qe operoret e shkembejne kete trafik nepermjet carrierave nderkombetare te cilet nuk jane te perfshire ne kete marreveshje. Prandaj dhe realizimi i ketij glide pathi pa perfshirjen e international carrierave nderkombetare eshte tejet i komplikuar nga cdo pikepamje, dhe thuajse pamundur. Nje menyre per ta adresuar kete veshtiresi teorikisht mund te ishte lidhja direkte e interkoneksionit midis operatoreve, gje qe eshte praktikisht pothuaj e parealizueshme per shkak te kostove qe gjenerohen dhe jashte cdo operimi te trafikut nderkombetar. Gjithashtu, konsiderojme se duhen marre ne konsiderate tarifat nderkombetare te terminimit me vendet e tjera (qe nuk jane pjese rajonit te BP) qe jane me te shtrenjta. Si ne rastin e roamingut me Kosoven, dhe per Roamingun me BP, ne produktin me pakice per eliminim te fraudeve te mundshme duhet dizenuar qe ne kete RLAH te jene vetem thirrjet back to home and netëork country.
- Gjithashtu, nje tjetër aspekt qe meriton vemendje, jane dhe kostot administrative qe linden nga implementimi i RLAH me vendet e Ballkanit Perendimor, pasi ne kete dokument te keshillimit publik nuk parashikohet asnje menyre per operoret qe te mbulojne kostot shtese te cilat do te linden si me poshte, qe duhet te merren ne konsiderate:
  - Duke mbuluar zona qe nuk jane te mbuluara nese nuk do te kishte RLAH (psh: kosto te rrjetit ne zonat e turisteve, autostrada, aeroporte, stacione treni, zona kufitare, per shkak te mbingarkimit te rrjetit etj);
  - Berja, zhvillimi dhe administrimi i kontratave te roamingut me te gjitha operoret;
  - Marketing dhe zhvillimi i sherbimeve te roaming;
  - Ofrimi sherbimeve te specializuara te roamingut per pajtimtaret;
  - Trajtimi i te dhenave dhe shkembimi i faturimeve me partneret e roamingut duke perfshire edhe trafikun nderkombetar te lidhur me roamingun;
  - Menaxhimi i borxheve te keqija shtese dhe kostove te fraudit;
  - Ofrimi dhe operimi i linkeve te sinjalizimit te roamingut, GRX, IPX si dhe mbingarkesa e tyre per shkak te rritjes se trafikut pas lancimit te RLAH duke shtuar kapacitetet.
- Bazuar ne sa permendur me siper, eshte evidente se operoret celulare do te kene nevojë per investime shtese dhe te paparashikuara ne buxhetet e tyre per te permbushur te gjitha aspektet e parashikuara ne Marreveshjen e Roamingut RRA (RRA WB6), si per



implementimin e RLAH ne sistemet e billingut, kapacitetet shtese te sinjalizmit, GRX, IPX, marketingut ashtu edhe per menyren se si do te zgjidhet rrugesimi dhe matja e trafikut nderkombetar lidhur me roamingun.

- Ne anen tjeter operatoret do te perballen me nje ulje te te ardhurave ne nivel shumice dhe pakice nga roaming dhe te gjithat problematikat e mesiperme do te kene nje impakt mjaft te madh tek operatoret ne pergjithesi.
- Lidhur me RLAH +, afatet per implementimin e retail për RLAH + nuk mund të përmbushen në këtë kohë për shkak të kufizimeve të sistemit të faturimit.

Duke marre ne konsiderate problematikat me siper si dhe cfare ka shprehur ne korrespondencat e saj te meparshme me AKEP, Telekom Albania vlereson se data e implementimit te RLAH me vendet e Ballkanit Perendimor ne date 01 Korrik 2019 eshte e veshtire per tu arritur si dhe gjykon qe AKEP te ndermarre masat e kerkuara per shtyrjen e afateve per implementimin e rregullave per zerin ne 1 Korrik 2020.

Me poshte po risjellim dhe njehere ne vendendjen e AKEP ceshtjet dhe pyetjet e shtruara per sqarim dhe ne keshillimin publik qe u krye ne lidhje me roamingun nderkombetar Shqiperi-Kosove, duke qene se problematikat jane te njejta dhe ne roamingun nderkombetar Shqiperi-BP.

### **Rregullimi i MTR-ve nderkombetare te lidhura me Roaming nderkombetar Shqiperi-BP**

Ne kete dokument te AKEP eshte parashikuar dhe rregullimi i MTR nderkombetare te lidhura me Roamingun BP –Shqiperi, te cilen po e risjellim dhe njehere per trajtim ne kete seksion me vete duke qene se nuk eshte ne pyetjet e shtruara per keshillim publik, si dhe perben nje aspekt mjaft te rendesishem ne funksionimin e RLAH dhe me impakt per operatoret celulare.

#### *Thirrjet e terminuara ne roaming*

Eshte e rendesishme per t'u permendur fakti qe midis kostove te thirrjeve kombetare dhe thirrjeve te terminuara te lidhura me sherbimet e roamingut ekzistojne diferenca te konsiderueshme qe kane te bejne me kostot e rrugesimit dhe transferimit te thirrjeve ne kontekstin e roamingut krahasuar me kostot perkatese te terminimit te thirrjeve kombetare. Psh. kostot shtese evidentohen gjate transferimit te thirrjes nga vendi i origjines (Home Country) i pajtimtarit ne roaming drejt vendit qe eshte vizituar nga pajtimtari ne roaming.

Kostot qe mbuloohen nga MTR-te e lidhura me roamingun jane me te larta krahasuar me kostot e terminimit te thirrjeve kombetare, pasi ne keto kosto perfshihen:

- a. Kostot per perdorimin e rrjetit vendas;
- b. Transferimi i thirrjes nga vendi i origjines drejt vendit te vizituar gjate roamingut nepermjet nje operatori per tranzitimin nderkombetar;
- c. Terminimi i thirrjes tek rrjeti celular i operatorit prites.

Per cdo minute thirrje te marre gjate roamingut, operatoret pesojne nje humbje financiare qe eshte sa tarifa e paguar per cdo minute te tranzitimit nderkombetar te kesaj thirrje.

Ne rastin tone operatoret lokale i paguajne aktualisht TA 1.22 leke/min ose 0.008 Euro/min, ndersa TA do t'i paguaje cdo operatori te vendeve te BP 0.04 Euro/min.

Ne kete draft eshte parashikuar glide-pathi i MTR-ve nderkombetare per thirrjet e gjeneruara ne situaten roaming te cilat do te jane reciproke per te gjithë operatoret ne vendet e Ballkanit Perendimor.

Glide path i MTR-ve nderkombetare per thirrjet e gjeneruara ne Roaming merr parasysh situaten ne te cilen MTR nderkombetare te operatoreve jane shume me te larta se sa tarifa e shitjes me pakice te thirrjeve te propozuara nga ana e AKEP ne kete dokument, me qellim eliminimin e situates te shitjes nen kosto. Trafiku i zerit te gjeneruar ne roaming rrugezohet midis operatoreve neper linket e interkoneksionit nderkombetar te cilat realizohen nepermjet carrierave nderkombetare. Nje carrier nderkombetar i nje operatori celular mbledh te gjithë trafikun nderkombetar te origjinuar nga pajtimtaret e nje operatori si dhe te vizitoreve roaming te atij operatori dhe e rrugezohet ne destinacionet perkatese duke kaluar ose drejtperdrejte ne destinacionin e kerkuar (nese ka lidhje direkte) ose nepermjet carrierave te tjere nderkombetar duke shtuar tek secili kostot e tranzitimit.

Por ne kete dokument, ashtu si dhe ne ate final per roamingun Shqiperi-Kosove nuk eshte marre parasysh qe operatoret e shkembejne kete trafik nepermjet carrierave nderkombetare.

Kjo menyre e rrugezimit te trafikut nderkombetar lidhur me roamingun krijon disa problematika te rendesishme dhe te konsiderueshme te cilat duhen zgjidhur perpara se te kalohet ne kete regjim.

Menyra ekzistuese e rrugezimit te trafikut nderkombetar duhet te ndryshoje per trafikun e roamingut. Bazuar ne analizat e situates aktuale dhe te ketij regjimi te ri mund te shihen/konsiderohen disa mundesi te cilat do te trajtohen me poshte, por secila ka problematikate veta dhe secila prej tyre gjeneron kosto te konsiderueshme shtese te cilat nuk jane parashikuar ne buxhetet aktuale te operatoreve si dhe kerkon nje kohe te caktuar per implementimin e tyre.

Realizimi i ketij glide path te MTR-ve per operatoret ne Shqiperi dhe ne rajonin e Ballkanit Perendimor pa perfshirjen e operatoreve te tranzitimit nderkombetar eshte i pamundur dhe Telekom Albania e ka shprehur kete shqetesim edhe me pare ne korrespondencen e saj me AKEP.

Rregullimi i MTR-ve nderkombetare per kete trafik, rregullon vetem tarifen nderkombetare te Shqiperise dhe vendeve ne rajonin e BP pjese e kesaj marreveshje multilaterale, por kjo nuk rregullon tarifat nderkombetare me vendet e tjera qe nuk jane pjese e ketij rajoni, te cilat jane shume te shtrenjta.

Kostot qe lindin tek nje operator celulare kur realizohet nje thirrje origjinuese (dalese) ne roaming jane te ngjashme me thirrjet dalese te realizuara ne situaten normale jo roaming.

Keshtu eshte e rendesishme te theksojme llojet e ndryshme te thirrjeve te origjinuara ne roaming

- a) Thirrje kombetare – thirrje te bera tek i njeiti vend, i vendit te vizituar nga roamer-si
- b) Call back home – thirrje te bera nga vendi i vizituar tek vendi home i roamersit
- c) Thirrje te bera tek vendet e tjera.

Per kostot eshte konsideruar qe kostot e thirrjeve lokale jane konsideruar te njejta per operatoret e Shqiperise dhe vendeve te tjera te BP.

Ne termat e kostos, thirrjet e b) dhe c) jane te ngjashme

Per piken b) MTR-te jane te rregulluara sipas glidepath te propozuar

Ndersa per piken c) mund te lindin situata te tilla qe cdo operator origjinues ben vendimet e veta komerciale ne rrugesimin internacional, bazuar ne cmimet dhe cilesine e sherbimit. Psh, operatori A mund t'i ofroje pajtimtareve te tij ne roaming nivelin me te larte te cilesise se sherbimit ne thirrjet nderkombetare duke pasur kosto shtese, ndersa operatori B mund te jape cilesi me te ulet me cmime me te ulta nderkombetare. Levizja tek njeri- tjetri ne roaming shkakton kosto shtese tek operatori me cilesi me te larte sherbimi dhe me cmime me te larta, dhe penalizohet cilesia e sherbimit te pajtimtareve te operatorit A.

Telekom Albania vlereson gjithashtu se ne lidhje me nivelet percaktuara te tarifave te terminimit te lidhura me roamingun Shqiperi-BP, AKEP duhet qe te marre parasysh problematikat e renditura me sipër me ane te nje analize me te detajuar te aspekteve te tjera te lidhura me keto MTR: kostot e tranzitimit nderkombetar, tarifat nderkombetare me vendet e tjera qe nuk jane pjese e rajonit te Ballkanit Perendimor.

- Nje tjetër menyrë për të zgjidhur këtë problematikë është lidhja direkte e operatoreve me njëri-tjetrin, gjë që është e pamundur nga ana e kostove që shkakton dhe jashtë çdo operimi të trafikut nderkombetar si dhe pamundësi fizike dhe kohore të realizimit
- Një menyrë e sugjeruar është thirrja me SIP. Për këtë duhet bërë një komunikim me të gjithë operatorët e përfshirë se cfarë version SIP kanë, nëse mund ta suportojnë, a janë të përputhshme me njëra-tjetrën, a kanë kosto dhe investime shtesë etj.
- Tranzitimi i trafikut nepermjet Albtelecom, do të krijonte pabarazi midis TA dhe Albtelecom, për shkak të tarifës shtesë të tranzitimit që TA do të paguante, ose Albtelekom të mos aplikojë tarife tranzitimi për këtë lloj trafiku.
- Voice Hub nepermjet një international carrier që do të krijohen nga një international carrier për vendet e E6BC (përfshirë këtu dhe Kosovën).

Kur bëhet fjalë për shërbimet e trafikut të zërit, gjërat bëhen shumë komplekse dhe kërkojnë vendosjen e një kufiri kohor real për përshtatjen e sistemeve tona të brendshme dhe sigurimin e koordinimit midis operatorëve të 5 vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor për krijimin e një HUB të interkoneksionit për shkëmbimin e trafikut roaming ndërmjet vetëm vendeve të WB6. Ne besojmë se duke përdorur një HUB, do të zbusë në një farë

mase ekspozimin e operatorëve në rritjen e aktivitetit të fraud-it që pritet të ndodhë për shkak të diferencave të rëndësishme ndërmjet tarifës standarte të terminimit ndërkombëtar dhe atij të rregulluar, i cili do të ndikojë direkt të ardhurat nga terminimi ndërkombëtar për të gjithë operatorët por më e rëndësishmja përvojën e konsumatorëve dhe cilësinë e shërbimit.

Ne situatën aktuale për sa i përket HUB-it, asnjë nga operatorët nuk ka rënë dakort deri me tani për krijimin e një qendre të HUB-it duke bërë situatën më komplekse dhe të vështirë.

Edhe nga komunikimet me të fundit me operatorët e rajonit, është e qartë se disa operatore nuk janë pro idesë së krijimit të HUB-it.

Ne të gjitha opsionet e përshkruara më sipër, kërkohet dakortësi midis të gjithë operatorëve të BP-se, kohe fizike për implementim dhe investime shtesë në një kohe shumë të shkurtrë që e bën procesin e implementimit shumë të vështirë për tu arritur në afatin e propozuar deri me datë 1.07.2019.

Një opsion tjetër i implementimit të MTR-ve ndërkombëtare të rregulluara për thirrjet e origjinuara dhe të terminuara tek abonentët roaming të 6 vendeve të BP në rrjetet e njëri-tjetrit është nepermjet TAP fileve të roamingut, por në këtë rast duhet të kryhen operacionet e kreditimit dhe debitimit nga MTR nominal ndërkombëtare të operatorëve në vlerën 0.04 Euro/min.

Se pari kjo mënyrë nuk lejon asnjë rikoncilim me trafikun e ardhur nga ana e international carriers dhe për thirrjet e origjinuara në operatore të ndryshëm mund të evidentohen vetëm thirrjet back to home country/netëorë, por jo thirrjet e dërguara nga operatori tek rrjetat e tjera të E6B apo edhe të rest of ëorl, duke u bazuar në një sjellje të good faith të operatorëve.

Kjo sjell një kompleksitet të jashtëzakonshëm dhe mikson faturimet në interkoneksion me international carrier me kontratat e discountit të roamingut, të cilat duhet të adresohen nga ana e AKEP edhe autoritetet e taksave për të qenë të sigurtë që këto operacione nuk shkaktojnë asnjë problem nga ana e këtyre autoriteteve.

AKEP duhet ta konsiderojë si një çështje mjaft sensitive këto problematike dhe sugjerojë se si mund të zgjidhet qoftë me HUB, duke bërë presion tek rregullatorët e tjerë për të qenë të gjithë operatorët në një mendje, qoftë për opsionin e dytë për të qartësuar autoritetet e taksave.

### **Flow i thirrjeve në situatat e roamingut në vendet e BP dhe midis vendeve të BP dhe jashtë BP**

Një element tjetër i rëndësishëm që TA dëshiron të sjellë në vëmendjen e AKEP për t'u trajtuar dhe sqaruar më në saktësi lidhet me floën e thirrjeve të origjinuara dhe të terminuara midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe thirrjeve të origjinuara jashtë rajonit dhe të terminuara në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe e kundërta (të origjinuara brenda vendeve të BP dhe të terminuara jashtë rajonit).

AKEP duhet te sqaroje me saktësi të gjithë skenaret e përmendur me sipër që do të krijohen me hyrjen në fuqi të RLAH në BP, mënyrën se si do të rregullohet flota e të gjithë thirrjeve të origjinuara dhe të terminuara si brenda vendeve të BP, si midis vendeve të BP dhe jashtë tyre.

TA gjykon që kjo çështje kërkon një seksion me vete për t'u trajtuar nga ana e AKEP se si do të operohet në mënyrë që të shmangjen situatat komplekse dhe paqartësitë në marrëdhëniet midis operatoreve.

AKEP duhet të publikojë me vendimin e dhe manualin me flota e thirrjeve që janë nën rregullim

## **Problematika në lidhje me shërbimet e roaming në B2B**

- Në piken 9 faqe 33 të dokumentit për keshillim publik citohet si më poshtë:  
*“Gjatë periudhës tranzitore (RLAH+), nuk ndalohen ofertat të cilat i mundësojnë klientëve roaming, përdorimin e sasive të caktuara të shërbimeve roaming, sipas tarifave fikse ditore ose të tjera, me kushtin që konsumi i plotë i sasisë së lejuar të çojë në tarifë për njësi për thirrjet e kryera, thirrjet e marra, mesazhet SMS të dërguara dhe shërbimet e të dhënave (data) të cilat nuk duhet të tejkalojnë çmimin përkatës brenda vendit plus tarifën shtesë maksimale të përcaktuara për periudhën tranzitore.”*

Me këtë rregull sipas gjykimit tone nënkuptohet se gjatë periudhës RLAH+, klienteve të biznesit i lejohet përdorimi i Daily Pass Fee (ku klienti paguan tarifën fikse ditore për të përdorur njësitë e planit tarifor), prandaj për këtë aspekt kërkojmë nga ana e AKEP sa më poshtë:

- i. Nëse Daily Pass Fee lejohet gjatë RLAH+ çfarë ndodh pas kësaj periudhe? Në periudhën e RLAH nuk do të jete me të lejuar përdorimi i Daily Pass Fee?
  - ii. Nëse Daily Pass Fee nuk lejohet që në periudhën e RLAH+, atëherë kontratat e biznesit nuk janë të mbuluara për arsye se kushtet e kontratës e përmbajnë DPF në vendet e BP. Si rrjedhojë Telekom Albania sugjeron një nga dy opsionet sa vijojnë:
    1. Nëse kushtet e kontratës mund të ndryshohen për të gjithë klientët business me njoftim paraprak në media pa u cenuar ligjrisht?
    2. Nëse ligjrisht nuk mund të ndryshohen kushtet e kontratës me anë të njoftimit paraprak, atëherë Telekom Albania sugjeron që rregulli i heqjes së Daily Pass Fee në vendet e Ballkanit Perëndimor të bëhet vetëm për kontratat të cilat rinovohen pas datës së lancimit të RLAH+/RLAH dhe jo për klientët ekzistues që janë në një kontratë të vlefshme.
- Në lidhje me përcaktimin e matjes së njësive për tarifimin Telekom Albania kërkon edhe njëherë një sqarim të mëtejshëm dhe më specifik nga ana e AKEP se sa është tarifimi fillestar maksimal i shprehur në Kilobyte.
  - Në lidhje me përcaktimin e kursit të kembimit Telekom Albania vlerëson si më të arsyeshme që tarifën të shprehen në monedhën Shqipëtare Leke, duke evituar ndryshime në sistem në çdo vit, duke qenë se kursi i kembimit do të ndryshojë sipas tremujorit të parë të çdo viti. Kjo do të reduktojë kostot për operatorët dhe implikimin e tarifave dhe njoftimeve përkatëse.

- Per sa i perket perdorimit te politikave te drejta FUP, Telekom Albania kerkon nje qartesim lidhur me aplikimin e tyre nese ajo do te aplikohet per te gjitha njesite (minuta hyrese apo dalese, SMS dhe internet)?
- Ne paragrafin e pare faqe 42 te dokumentit per keshillim publik citohet si me poshte:  
*Në lidhje me paketat që përfshijnë njësi si minuta, SMS, apo MB, aplikimi i RLAH nënkupton që pajtimtari mund të konsumojë njësitë e përfshira në paketë sikur të ishte në Shqipëri dhe njësitë e konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Pas mbarimit të njërive të paketës pajtimtari tarifohet me tarifën përkatëse për njësi sikur të ishte brenda vendit. Për shërbimin e Internetit operatori ka të drejtë të aplikojë FUP (më poshtë). Gjatë regjimit RLAH+ operatori mund të tarifojë njësitë e konsumuara me tarifë maksimale sa tarifën përkatëse me shumicë dhe njësitë e konsumuara në roaming i zbriten nga njësitë e përfshira në paketë. Psh. Për fazën e parë të RLAH+, për çdo pajtimtar që ka një paketë (bundle) me minuta, SMS dhe Internet të përfshira në pagesën fikse, operatori ka të drejtë të që gjatë fazës tranzitore RLAH+ të aplikojë tarifa shtesë për njësitë e përfshira në pakete dhe të konsumuara në roaming në BP tarifa shtesë maksimale prej 7.5 lek/minute për thirrje dalese, 6 lek/Minute thirrje hyrese, 3 Lek/SMS të dërguar dhe 3.75 Lek/MB (të gjitha këto tarifa me TVSH). Për shembullin e dhënë në tabelë, konsumatori do të duhet të paguajë 2430 Lek shtesë për konsumin në roaming gjatë fazës tranzitore RLAH+ për 50 minuta dalëse, 25 minuta hyrëse, 10 SMS të dërguara dhe 500 MB të konsumuar në roaming në BP, mbi tarifën fikse që ka paguar për ofertën/pajtimin mujor. Në rast të përdoruesve me parapagim që kanë aktivizuar ofertë, ata duhet të kenë kredite në llogarinë e tyre, dhe tarifa shtesë i zbritet nga këto kredite sipas shpenzimeve të matura me tarifën e cituara.*

Per sa me cituar ne kete paragraf Telekom Albania shtron per disa qartesime me specifike per AKEP si me poshte:

- a. Cfare nenkupton ky paragraf? Te gjitha benefitet qe klienti perfiton nga plani tarifor apo paketat e ndryshme per konsum brenda Shqiperise, duhet te jene te vlefshme dhe per pordorim ne roaming (vendet e BP)?
  - b. Ne rast se po, tarifimi i ketyre njesive do te jete me tarifim fillestar sipas kushteve te paketes ekzistuese apo te gjitha paketat dhe planet tarifore duhet te pershtaten per tu perdorur ne roaming sipas njesive te matjes te percaktuara ne faqen 23 te dokumentit "Njesite e matjes"?
  - c. Nese pergjigje eshte po, atehere gjate fazes se RLAH operatoret bartin kosto me te medha per ofrimin e planeve tarifor dhe paketave ne raport me njesite e ofruara. Kjo do derivonte ne nje rritje artificiale te cmimeve ne tregun Shqipetar per tarifate home duke mbuluar kostot e ardhura nga cmimet eholesale.
- Nese tarifate PAYG ne Shqiperi jane me te larta sec parashikohet maksimumi per njesi ne roaming (BP) atehere operatori eshte i detyruar te ule dhe cmimet ne home? Apo mund te mbaje te pandryshuara cmimet home duke modifikuar vetem PAYG pergjat roaming ne vendet e Ballkanit Perendimor?
  - Per cdo rast tarifimi, Telekom Albania sugjeron qe nga ana e AKEP te ofrohet formula e perlllogaritjes ne menyre qe mos rrezikohet kufiri i lejuar i cmimeve tavan.

- Ne paragrafin 3 te pikes 10 faqe 34 ku citohet “...Kur konsumatorët roaming me vetdije zgjedhin të kalojnë ose kthehen në një tarifë të caktuar në përputhje me nenet (RLAH) dhe paragrafin (RLAH+) të këtij neni, çdo kalim duhet të bëhet brenda një dite pune nga marrja e kërkesës, do të jetë pa pagesë dhe nuk do të kërkojë kushte ose kufizime që kanë të bëjnë me elementet e abonimit, përveç roamingut”, Telekom Albania deshiron te theksoje se kjo nuk mund te jete e vlefshme per planet tarifore qe klienti biznes perdor ne home dhe se periodha 1 ditore duhet rishikuar ne nje mundesi ku te parashikohet dhe mbingarkesa e punes si dhe norma normale e veprimtarise ne baze te punonjesve qe operojne.

### **Problematika ne lidhje me sherbimet roaming me pakice**

Nga ceshtjet e trajtuara ne kete dokument, ka disa problematika dhe pyetje te renditura si me poshte, per te cilat Telekom Albania kerkon disa sqarime te metejshme nga ana e AKEP:

- Ne lidhje me aplikimin e step charge, step charge i dhene ne dokument duhet zbatuar ne nivel shumice, apo edhe ne nivelin e retail?
- Per pajtimtaret postpaid, programet ne home (Shqiperi), ofrojne internet falas pa limit me shpejtesi te reduktuar. Gjate periudhes tranzitore eshte e mundur qe te aplikohet per internetin tarifa maksimale per njesi?
- bonuset e dhena per perdorim ne home, nuk duhet te jene objekt i RLAH.

Se fundmi, qasja sipas “the home pricing principle” mund te krijonte mundesi per arbitrazh qe do te rezultonin ne humbje sinjifikative per operatoret celulare. Operatoret do te rrezikonin humbje te medha nese cmimet me pakice te roamingut do te binin poshte cmimeve me shumice te roamingut. Ne kete menyre, palet e treta do te kishin avantazhe per mundesi arbitrazhi si psh: duke shitur karta SIM me parapagese nga vende me cmime te uleta per abonentet ne vende me kosto me te larta per t’i perdorur si sherbime normale celulare te tyre.. Asnje nga keto situata nuk do te ishte e qendrushme pasi operatoret ne vendet me cmime te uleta do te merrnin te ardhura me pakice nen kostot me shumice qe ata duhet te mbulojne. Operatoret celulare do te duhej te rregullonin cmimet e tyre me pakice per te parandaluar te tilla mundesi arbitrazhi qe lindin. Per te shmangur rrezikun per humbje te medha nen qasjen “Home Pricing” te gjithë operatoret duhet te percaktonin cmimet e tyre me pakice te pakten te larta sa cmimet me te larta me shumice te roamingut.

Lidhur me RLAH +, dispozitat per implementimin e retail për fazën RLAH + nuk mund të përmbushen në këtë kohë për shkak të kufizimeve të sistemit të faturimit, pasi kryesisht si logjikë aplikimi i tarifave shtese tek paketat tarifore domestike nuk ka suport dhe kërkon zhvillimin e sistemeve përkatëse. Kështu, në përputhje me tarifat e roamingut me pakicë të RRA WB6, TA sugjeron dhe propozon zbatimin e RLAH + duke lancuar paketat e dedikuara për roaming me pakicë dhe Tarifat ROAMING “Pay as you GO” për 6 vendet e Ballkanit Perendimor.

Ne vend te nje shtyrje de facto te Marreveshjes, TA kerkon qe AKEP te marre masat e lkerkuara per shtyrjen e dates se fillimit te implmentimit te rregullave te reja per zerin per 1 Korrik 2020.

## **Albtelecom**

### **A. Problematika kryesore për implementimin e RLAH+ në retail bazuar në sistemet aktuale dhe afatet kohore të kërkuara.**

Nëse një nga shërbimet e përfshira në RLAH+ është mundësia për të përdorur njësitë e përfshira në paketat e kombinuara brenda vendit (domestic bundles) në roaming, Albtelecom vëren vështirësi teknike dhe komerciale si më poshtë:

- a) Për pajtimtarin Albtelecom, stepcharge i paketave brenda vendit (domestic bundle) është aktualisht i ndryshëm për trafikun e gjeneruar brenda territorit të RSH nga ai i propozuar nga AKEP për RLAH+ me BP siç evidentohet edhe në dokumentin e Këshillimit Publik “Njësitë e matjes” faqe 23. Në propozimin tuaj specifikohet aplikimi i një “step charge” të rregulluar në maksimum. 30+1 sec. Teknikisht dhe komercialisht është i pamundur aplikimi i dy “step charge policy” për të njëjtën paketë, pavarësisht vendndodhjes së pajtimtarit.
- b) Gjithashtu një problematike e hasur për aplikimin e RLAH+ për paketat/ bundle domestic ka të bëjë me kërkesën për aplikim të një surcharge mbi konsumin e paketës domestike. Teknikisht është i pamundur implementimi i tarifimit të dyfishtë (për të njëjtën event të konsumuar nga pajtimtarët të aplikohet reduktimi nga njësitë e paketës + pay as you go tariff/surcharge). Plotësimi i kësaj kërkesë kërkon investime shtesë për Albtelecom dhe kohë implementimi më të gjatë se ajo e parashikuar në dokument.

Në këto kushte Albtelecom sugjeron implementimin e RLAH+ si më poshtë:

- Aplikimi I Tarifës “Pay as you go” për pajtimtarët e Albtelecom që do të përdorin shërbimin e tij roaming në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë në zbatim me përcaktimin e AKEP për RLAH+ për tarifën maksimale me pakicë (MO= $\leq$  0.19 eur/ min, MT= $\leq$  0.04 eur/ min, SMS = $\leq$  0.06 eur/sms dhe të dhëna 0.18 eur/MB).
- Paketa të dedikuara (bundle) të ndryshme nga paketat kombëtare aktuale (domestic bundle) për përdorim vetëm në vendet e BP, preferenciale dhe në përputhje me përcaktimet e AKEP për RLAH+ për tarifën maksimale me pakicë.

Sugjerimet e Albtelecom vijnë për shkak të rrethanave aktuale dhe termave kohorë mjaft të ngushta për realizimin e objektivave të përcaktuara nga Marrëveshja e Prillit 2019 për vendet e BP.

Kështu, Albtelecom thekson se pavarësisht zhvillimeve pozitive të realizimit të modelit RLAH+ dhe RLAH në EU dhe plotësimit të kuadrit rregullator europian për shërbimet e roaming, nuk mund të mos evidentojmë faktin se implementimi i këtij modeli në EU u parapri nga një proces i gjatë i filluar që në vitin 2007, i cili filloi gradualisht me vendosjen nën rregullim të një shërbimi e me pas për shërbimet e tjera. Gjatë këtij procesi 10 vjeçar, operatorët kanë patur mundësi reale për tu njohur me modelin e parashikuar shumë kohë më parë për tu aplikuar, kanë patur mundësi reale për të vlerësuar fizibilitetin e zgjidhjeve më të mira teknike, për të zbatuar kështu përputhshmërisht Rregulloret e EU dhe Udhëzimet e BEREC. Faktori kohë i arsyeshëm i ka dhënë shteteve të EU mundësinë për të



implementuar zgjidhjet më të përshtatshme varësisht karakteristikave teknike të sistemeve të tyre e deri në finalizimin dhe implementimin e suksesshëm të modelit RLAH në vitin 2017. I gjithë ky proces i gjatë nuk ka kaluar pa kundërshtime dhe shqetësime nga operatorët, të cilat kur ka qenë rasti, janë adresuar dhe janë akomoduar përkatësisht. Por ajo që është më e rëndësishmja, është fakti se për implementimin e modelit janë dashur vite dhe jo as 3 muaj si në rastin e objektivave të vendosura me Marrëveshjen e Prillit 2019 për vendet e BP.

Gjendur në rrethanat e angazhimit të Shtetit Shqiptar në një Marrëveshje shumë palëshe, Albtelecom parashtron si më lart sugjerimet e tij të cilat nga njëra anë përmbushin plotësisht qëllimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet shteteve të BP, dhe nga ana tjetër nuk vënë operatorin përpara pamundësisë faktike për implementimin në kohë të objektivave të përcaktuar në këtë Marrëveshje.

Në nenin 1 dhe 2 të Marrëveshjes dhe në dokumentin e këshillimit publik, është përcaktuar zbatimi i modelit RLAH+ që nga 1 korriku 2019 dhe modelin RLAH nga 1 korriku 2021 sipas tarifave roaming me shumicë dhe tarifave me pakicë të rregulluara. Kështu, sugjerimi i Albtelecom për paketa të dedikuara (bundle) për përdorim në vendet e BP, preferenciale dhe në përputhje me përcaktimet e AKEP për RLAH+ për tarifën maksimale me pakicë përmbush plotësisht qëllimin e Marrëveshjes dhe nuk vjen në kundërshtim me objektin dhe frymën e Marrëveshjes për vendet e BP. Në këtë mënyrë, operatori do të mund të përmbushë afatet kohore të përcaktuara në Marrëveshje dhe po ashtu në Akte rregullatore, kurse pajtimtari do të mund të marrë përfitimet nga implementimi i modelit RLAH+ njësoj siç do të kishte përfituar nëse pajtimtari do të kishte përdorur paketën (bundle) e tij domestike, për përdorimin në Roaming të së cilës do të duhej të kishte njëherazi edhe kredit për të aplikuar surcharge-in. Madje nga eksperiencia jonë, gjykojmë se në rastin e “bundle” abonenti përkundrazi do të konfuzohej më shumë në rast se do t'i duhej të shtonte edhe kredit shtesë përveç paketës domestike sa herë që do të udhëtonte në një nga këto vende. Për më tepër, përdorimi i njërive të paketës domestike edhe në roaming do të krijonte premisa për shtimin e ankesave të abonentit të cilët ndodhur përballë një praktike të re, të ndryshme nga ajo e ndjekur në vite, mund të paragjykojnë konsumimin e njërive brenda vendit me ato jashtë vendit. Ndaj dhe sugjerimi i Albtelecom është tërësisht transparent për pajtimtarin dhe i jep mundësinë atij të jetë plotësisht i vetëdijshëm në lidhje me konsumimin e njërive brenda paketës së zgjedhur prej tij në shërbimet roaming. Nga ana tjetër, këto paketa të dedikuara do të jenë në zbatim të plotë të përcaktimeve të AKEP për RLAH+ për tarifën maksimale me pakicë ( $MO \leq 0.19$  eur/ min,  $MT \leq 0.04$  eur/ min,  $SMS \leq 0.06$  eur/sms dhe të dhëna 0.18 eur/MB). Dhe njëkohësisht, edhe për organin rregullator, AKEP, do të jetë absolutisht më e lehtë për të verifikuar tarifimin korrekt në paketa, apo për të gjykuar rast pas rasti në rast të adresimeve në AKEP të ankesave të klientëve për probleme tarifimi në Roaming, etj.

Qëllimi i nenit 2 të marrëveshjes rajonale nuk kufizon se në çfarë mënyre do të implementohet tarifa “surcharge” apo se në çfarë mënyre do t'i merret abonentit kjo tarifë, por kjo dispozitë ka përcaktuar qartë periudhën tranzitore gjatë së cilës operatori do mund të tarifojë edhe një surcharge. Kështu që, aplikimi i tarifave të përcaktuara nga marrëveshja rajonale e roamingut në kohën e përcaktuar nga kjo marrëveshje, por nëpërmjet paketave të dedikuara për vendet e BP sipas propozimit të Albtelecom nuk bie ndesh me zbatimin e Marrëveshjes së 4 Prillit 2019 dhe përmbush plotësisht qëllimin e marrëveshjes dhe njëherazi i ofron konsumatorit përfitimet e synuara nga kjo marrëveshje. Propozimet për aplikimin e paketave domestike duke i shtuar edhe detyrimin abonentit për të shtuar kredit në

mënyrë që të aplikohet surcharge-i, detyrojnë në mënyrë të panevojshme operatorin për investime shtesë, çënojnë zbatimin në kohë të modelit duke cënuar kështu përmbushjen e objektivave të Marrëveshjes Rajonale të Roaming për vendet e BP dhe duke vënë në diskutim seriozitetin e angazhimit të Shqipërisë si palë në këtë marrëveshje.

Albtelecom beson se edhe Komisioni Europian i cili po asiston nëpërmjet RCC (Regional Cooperation Council), i cili ka tashmë të maturuar eksperiencën e implementimit të modelit RLAH+ dhe RLAH në Europë në një proces që zgjati për më shumë se 10 vjet, do të mirëkuptojë plotësisht sugjerimet e Albtelecom dhe shqetësimet e ngritura prej tij (që besojmë se janë të njëjta edhe për pjesën më të madhe të operatorëve të BP), për tu adoptuar më tej në aktet rregullatore me rregullime specifike sipas kushteve dhe rrethanave të implementimit të modelit RLAH+ dhe RLAH me vendet e BP.

Për më tepër, në dokumentin e këshillimit publik, AKEP është shprehur se aktet e BEREC do të përshtaten në kontekstin e roaming në BP, çka në kuptimin tonë është e qartë se AKEP njeh dhe pranon faktin se, në rrethanat aktuale kur na ndajnë jo më shumë se rreth 1 muaj nga objektivi për implementimin fillimisht të modelit RLAH+ e më pas të RLAH për vendet e BP, nuk është i detyrueshëm dhe kusht pengues për arritjen e këtyre objektivave, fakti që të paktën për termat kohorë të RLAH+, të duhet patjetër të përafrohen dhe të adoptohen në legjislacionin vendas çdo lloj detyrimi rregullator të cilët operatorët në vendet e EU-së kanë patur kohë më se të mjaftueshme për tu njohur paraprakisht, për të vlerësuar dhe për të përgatitur paraprakisht zbatimin e tyre.

Së fundmi, Albtelecom kërkon nga AKEP që të jetë më racional dhe më proporcional në propozimet e tij në lidhje me detyrimet për t'ju vendosur operatorëve. Ku gjithashtu gjykojmë se, AKEP duhet të përcjellë dhe adresojë në takimet e përbashkëta të Grupeve të punës shqetësimet e operatorëve për të mos u ngarkuar me detyrime shtesë, përveç sa ato mund të jenë të domosdoshme (siç e kërkon edhe parimi i proporcionalitetit) për të siguruar respektimin e afateve për implementimin e modelit RLAH+ dhe RLAH në kohë sipas propozimit të Albtelecom. Sjellim në vëmendje këtu se, Marrëveshja për zbatimin e modelit RLAH+ dhe RLAH me Kosovën, edhe pse është nënshkruar që në Nëntor 2018, dhe prej asaj kohe autoritetet rregullatore përkatëse kanë bashkëpunuar ngushtë bashkë me operatorët, për të siguruar implementimin në kohë dhe duke qenë vetëm një vend, operatorët gjithësesi kanë akoma paqartësi dhe vështirësi për implementimin në kohë, sipas shqetësimeve të ngritura në komunikimet me AKEP.

Ndaj, në rastin e vendeve të BP, ku implikohen marrëdhëniet e operatorëve të 6 vendeve ndërmjet të cilëve do të zbatohet edhe parimi i reciprocitetit, dhe ndërkohë që Marrëveshja është nënshkruar vetëm një muaj më parë (Prill 2019), do të ishte më se e arsyeshme dhe e përshtatshme si për Shtetin Shqiptar palë në këtë Marrëveshje, ashtu edhe për pajtimtarët, pranimi dhe implementimi i propozimeve të Albtelecom shprehur gjithashtu më lart, për:

- Aplikimi I Tarifës “Pay as you go” për pajtimtarët e Albtelecom që do të përdorin shërbimin e tij roaming në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor do të jetë në zbatim me percaktimin e AKEP për RLAH+ për tarifata maksimale me pakicë (MO= $\leq$  0.19 eur/ min, MT= $\leq$  0.04 eur/ min, SMS = $\leq$  0.06 eur/sms dhe të dhëna 0.18 eur/MB).

- Paketa të dedikuara (bundle) të ndryshme nga paketat kombëtare aktuale (domestic bundle) për përdorim vetëm në vendet e BP, preferenciale dhe në përputhje me përcaktimet e AKEP për RLAH+ për tarifatat maksimale me pakicë.

### **B. Problematika për implementimin e tarifës së rregulluar të terminimit ndërkombëtar lidhur vetëm me shërbimin e roamingut midis/ndërmjet operatorëve celularë të vendeve të BP.**

Në vijim të komenteve parashtruar në pyetjen 1 më sipër lidhur me shqetësimin e Albtelecom mbi implementimin e tarifës së rregulluar të terminimit ndërkombëtar vetëm për thirrjet roaming midis operatorëve të vendeve të BP, Albtelecom gjykon që ky aspekt është shumë i rëndësishëm dhe kërkon vëmendjen e AKEP dhe të Autoriteteve Rregullatore Kombëtare (NRAs) të secilit nga vendet e BP për zbatimin dhe implementimin e parashikimeve të Marrëveshjes.

Një element i rëndësishëm dhe thelbësor për implementimin e Marrëveshjes midis vendeve të BP është dhe shërbimi i terminimit ndërkombëtar për thirrjet roaming, i cili duhet të ofrohet nga operatorët e BP me tarifën e rregulluar prej 0.04 Eur/min. Në kushtet aktuale, kur të gjithë operatorët e BP operojnë me tarifa terminimi ndërkombëtare (MTR) shumë herë më të larta se tarifa e rregulluar, si dhe kur trafiku i shkëmbyer ndërmjet operatorëve të BP realizohet ndërmjet palëve të treta (Carriers), risku për fraud/sjellje abuzive shumëfishohet/amplifikohet duke u lënë hapësirë/shkas abuzuesve të trafikut të tjetërsojnë origjinën/naturën e trafikut për të përfituar tarifën e rregulluar dhe për të siguruar përfitime të padrejta në dëm të operatorëve. Për më tepër, edhe në kushtet kur tarifa e terminimit ndërkombëtar nuk ka qenë nën rregullim, Albtelecom është përballur dhe vijon të jetë i prekur nga praktikatat abuzive të cilat çënojnë direkt të ardhurat nga shërbimi i terminimit ndërkombëtar.

Në këtë kontest, i cili është i njëjtë për të gjithë operatorët e vendeve të BP por edhe me synim përmbushjen e kushteve të Marrëveshjes, operatorët e BP kanë realizuar biseda telefonike të përbashkëta (Conference Call) direkt pas firmosjes së Marrëveshjes për të gjetur një zgjidhje të dakortësuar midis palëve për implementimin e tarifës së rregulluar vetëm për terminimin ndërkombëtar në roaming. Pas diskutimeve të shumta gjatë CC-ve dhe vështirësive në diskutim nepërmjet linjave telefonike për të arritur dakortësinë dhe finalizuar sa më parë këtë aspekt, duke patur parasysh dhe kohën e shkurtër për implementimin e saj, operatorët organizuan një takim të përbashkët në Beograd më datë 23 maj 2019.

Pas diskutimit dhe dhënien e alternativave të zgjidhjeve të ndryshme si: TAP Model, HUB, Clearing House, IC Billing System, zgjidhje, të cilat janë të njohura edhe për Agjensitë Rregullatore Kombëtare, këtu përfshirë dhe AKEP, nuk u arrit dalja me një qëndrim të përbashkët të palëve.

Operatorët e Malit të Zi, Bosnie-Herzegovinës, Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut përzgjedhën alternativën TAP model për implementim të tarifës së rregulluar pavarësisht implikimeve dhe pasaktësisë të informacionit që ofron ky model i cili nga ana tjetër nuk kërkon kohë implementimi.

Qëndrimi i Albtelecom, por edhe i dy operatorëve të tjerë shqiptarë: Telekom Albania dhe Vodafone Albania, ishte për alternativën e HUB, nëpërmjet të cilës do të sigurohej shkëmbimi i trafikut të

rregulluar duke i ofruar palëve saktësi dhe mundësi rekonsilimi trafiku dhe por njëkohësisht kërkon kohë të gjatë implementimi dhe koordinim midis operatorëve.

Në pamundësi të faktorit kohë dhe dy alternativave të shqyrtuara nga operatorët gjatë takimit: TAP Model dhe HUB, si alternativat më optimale për implementimin dhe zbatimin e Marrëveshjes, palët njohën avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tyre dhe kushtëzimet respektive. Alternativa e TAP model mund të përdoret vetëm përkohësisht deri në implementim të alternativës HUB për të përmbushur detyrimet e Marrëveshjes pavarësisht se kjo metodë nuk siguron/ofron informacion të saktë për shërbimin e terminimit ndërkombëtar të rregulluar roaming si dhe mënyrës se si do të zbatohet konkretisht nga operatorët për të përmbushur të gjitha detyrimet ligjore, rregullatore, fiskale, etj. Nga ana tjetër, alternativa HUB kërkon kohë për implementim dhe mund të konsiderohet si fazë e dytë por e domosdoshme.

Gjithësesi, në çdo rast palët theksuan që interkoneksioni direkt me secilin dhe ndërmjet çdo operatori do të ishte zgjidhja ideale, por kjo alternativë kërkon akoma më shumë kohë dhe angazhime nga operatorët por edhe burime njerëzore, financiare, infrastrukturë, etj. Aktualisht, Albtelecom marrëdhëniet preferenciale me operatorët e Kosovës i ka realizuar nëpërmjet interkoneksionit direkt duke bërë të mundur saktësinë e të dhënave por edhe mbrojtjen nga praktikat abuzive.

Implementimi i tarifës së rregulluar të shërbimit të terminimit ndërkombëtar lidhur vetëm me thirrjet roaming duhet të jetë në vëmendjen e NRA-ve si pjesë e pashmangshme e zbatimit të Marrëveshjes për të facilituar këtë proces, duke patur parasysh vështirësinë e dakortësisë dhe koordinimit të veprimeve midis 16 palëve/operatorëve të vendeve të BP.

Gjithashtu, vlen të përmendet që aplikimi i tarifave roaming të rregulluara për vendet e BE (glide-path) si dhe gjithë aspektet e këtij rregjimi përfshirë dhe shërbimin e terminimit ndërkombëtar lidhur me roaming, nuk ka qenë një proces i menjëhershëm, por ka kaluar në një periudhë tranzitore 10 vjeçare. Kjo periudhë tranzitore u ka dhënë mundësi operatorëve përmbushjen e detyrimeve rregullatore pa implikime ndaj tyre.

Në këtë këndvështrim, Albtelecom gjykon që ky element duhej të ishte pjesë e konsultimit publik për mënyrën e implementimit dhe zbatimit nga operatorët duke patur parasysh që ofrimi i shërbimit voice roaming mbështetet dhe është i ndërvarur nga kostot e interkoneksionit si për terminimin e thirrjeve dalëse apo dhe hyrëse në roaming por edhe afateve të pamjaftueshme kohore në dispozicion.

Albtelecom shpreson që AKEP do të marrë në konsideratë kërkesën e Albtelecom, pasi mendojmë se kjo kërkesë është e mbështetur edhe nga operatorët Telekom Albania dhe Vodafone Albania, që së bashku me NRA-të e vendeve të BP të vendosin si detyrim për operatorët respektivë, shkëmbimin e trafikut të rregulluar nëpërmjet interkoneksionit direkt ose HUB.

### **Vodafone Albania**

Duke theksuar edhe njëherë angazhimin serioz të Vodafone Albania në funksion të vënies në zbatim të reduktimit të çmimeve roaming në rajonin e Ballkanit Perëndimor si një iniciativë në përfitim të konsumatorëve gjegjë rastin të përmendim vështirësitë teknike lidhur me:

- Aplikimin e tarifës së rregulluar të terminimit të trafikut roaming midis operatorëve të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Siç është sqaruar edhe në takimet me AKEP, në kushtet aktuale kur trafiku terminohet nëpërmjet disa bartësve ndërkombëtarë (carriers), nuk mund të aplikohet kjo lloj tarife. Pra nuk është i mundur diferencimi i trafikut roaming dhe aplikimi i dy tarifave të ndryshme, njëra për trafikun roaming dhe tjetra për trafikun standard të interkoneksionit. Operatorët e WB6 kanë diskutuar në një takim të përbashkët për alternativat e mundshme të zgjidhjes dhe alternativa optimale, ajo e krijimit të një HUB ose përdorimit të një bartësi të përbashkët, kërkon kohë për dakordësim mes palëve dhe gjithashtu disa muaj kohë për implementim. Duke konsideruar që janë 16 operatorë të përfshirë nga të gjashtë vendet, kërkojmë mbështetjen e AKEP për të përcjellë përsëri tek autoritetet homologe të vendeve të tjera këtë shqetësim, si edhe sugjerimin e implementimit të krijimit të një HUB.
- Gjithashtu për sa i përket aplikimit të tarifave roaming në nivel pakice, nevojitet zhvillim në sistemet e faturimit, në mënyrë që të eliminohen kufizimet teknike, që pengojnë përdorimin në roaming të paketave të shërbimeve që ofrohen për konsum brenda vendit nëpërmjet vendosjes së një tarife shtesë (surcharge). Ajo që është e mundur të ofrohet deri në datën 1 korrik, janë paketat e dedikuara për përdorim në roaming (pagesa fikse periodike p.sh ditore) dhe ndryshimi i tarifës për shërbimet jashtë paketave (pay as you go).

Si konkluzion, në kushtet e një afati mjaft ambicioz për vënien në zbatim të gjithë parashikimeve të marrëveshjes për Reduktimin e Çmimeve të Shërbimeve Roaming në Rrjetet Publike të Komunikimit Celular në WB6 , sugjerojmë aplikimin duke filluar nga data 1 korrik 2019 të detyrimeve lidhur me shërbimet e transferimit të të dhënave dhe SMS dhe kërkojmë shtyrjen e aplikimit të tarifave roaming të rregulluara për shërbimin e thirrjeve zanore duke synuar si datë fillimi për këto të fundit datën 1 korrik 2020.

### **Qëndrimi i AKEP**

Një pjesë e komenteve të përgjithshme janë pjesë dhe e komenteve të dhënë sipas pyetjeve të këshillimit publik, për të cilat AKEP ka dhënë qëndrimin më sipër në këtë aneks.

Për sa i përket komenteve për gjetjen e zgjidhjeve teknike midis operatorëve të rajonit BP, AKEP sqaron se në vijim të takimeve të Grupit Koordinues të Rregullatorëve të rajonit, operatorët duhet të gjejnë zgjidhjet teknike në negociata midis tyre.

Për sa i përket pretendimeve për pamundësite teknike për zbatimin e RLAH+ në sistemet e faturimit për përdoruesit e paketave me parpagim dhe me paspagim, AKEP ka dhënë sqarime në kapitullin 5 të këtij versioni final të dokumentit.